



STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

“Efikasiteti i investimeve në rritjen ekonomike të Republikës së

Maqedonisë:

Analizë komparative me vendet e Ballkanit Perëndimor”

KANDIDATI:

Sara Ademi

MENTOR:

Assoc. Prof. Dr. Jeton Mazllami

**“Efikasiteti i investimeve në rritjen ekonomike të Republikës
së Maqedonisë: Analizë komparative me vendet e Ballkanit
Perëndimor”**

**„Ефикасноста на инвестициите во економскиот раст на
Република Македонија: Компаративна анализа со земјите од
Западен Балкан,,**

**“Investment efficiency in the economic growth of the Republic of
Macedonia: Comparative analysis with the Western Balkan
countries”**

Falënderime

Arritja e qëllimeve duke pasur një vetëbesim dhe këmbëngulje mund të realizohet duke pasur përkrahjen e personave më të afërt të cilët gjatë gjithë kësaj periudhe më kanë dhënë motivim duke shprehur mirënjohjet e mia të sinqerta.

Dua të shfrytëzoj këtë mundësi për të falënderuar mentorin tim Assoc. Prof. Dr. Jeton Mazllami i cili me kontributin e tij më ka dhënë mbështetje gjatë gjithë procesit të përpilimit të tezës si dhe realizimit me sukses të punimit të magistraturës.

Gjithashtu do të doja të falënderoj të gjithë profesorët dhe stafin e Fakultetit të Biznesit dhe Ekonomisë në drejtimin e Financave dhe Kontabilitetit.

Një falënderim shumë të veçantë shkon për familjen time, prindërit dhe motrat e mia që më kanë dhënë guxim, inkurajim dhe mbështetjen më të sinqertë për të arritur deri në përfundim të tezës.

Dhe, mbi të gjitha faleminderimi i takon Zotit që bëri të mundur çdo gjë që kam arritur deri më tani duke më dhënë forcë në marrjen e vendimeve për të arritur qëllimet e mia.

Abstrakt

Republika e Maqedonisë është një vend në zhvillim që përballet me shumë sfida të natyrës ekonomike, financiare, politike e juridike, gjë që e bën të nevojshme zbatimin e një sërë reformash. Një nga faktorët primarë ekonomik që kërkojnë menaxhim adekuat të tyre janë investimet. Realizimi efikas dhe efektiv i investimeve në sektorët kyç ekonomik do t'i mundësojë ekonomisë kombëtare përshejtim të rritjes ekonomike.

Synimi i punimit të magjistraturës është ofrimi i një analize të mirëfilltë të investimeve në përgjithësi dhe efikasitetin e tyre në PBB të Republikës së Maqedonisë duke marrë në konsideratë periudhën para, gjatë dhe pas krizës financiare. Investimet janë një nga faktorët kryesor në rritjen e produktivitetit të përgjithshëm në vend, zhvillimin e teknologjisë, zvogëlimin e normës së papunësisë si dhe përmirësimin e mirëqenies sociale që krijojnë rritje dhe zhvillim ekonomik të një vendi. Punimi gjithashtu ka për objektiv të nxjerr në pah nivelin e efikasitetit të investimeve në prizmin e krahasueshmërisë së RM me vendet e Ballkanit Perëndimor.

Nga ky studim arrijmë të konstatojmë një situatë ekonomike të brishtë të RM pas krizës financiare duke përfshirë këtu edhe disa vende të Ballkanit Perëndimor me një stagnim të rritjes së PBB dhe me probleme të natyrave ekonomike, politike dhe sociale.

Gjetjet e këtij studimi na shpiejnë te konstatimi se Republika e Maqedonisë nuk konsiderohet si vendi me efikasitet më të lartë të investimeve në Ballkanin Perëndimor. Si rezultat i shfrytëzimit jo efikas dhe joefektiv të investimeve ka stagnuar procesi i rritjes dhe zhvillimit ekonomik në vend.

Terma kyçe: efikasiteti, investimet, rritja ekonomike, kriza financiare.

Абстракт

Република Македонија е земја во развој која се соочува со многу економски, финансиски, политички и правни предизвици, што го прави неопходно да се спроведат голем број реформи. Еден од примарните економски сектори кои бараат нивно правилно управување се инвестициите. Ефикасното и ефективното спроведување на инвестиции во овие клучни економски сектори ќе овозможи националната економија да го забрза економскиот раст.

Целта на магистерската теза е да обезбеди автентична анализа на инвестициите и нивната ефикасност во БДП на Република Македонија, земајќи го во предвид периодот пред, за и по финансиската криза. Инвестициите се еден од главните фактори на севкупниот раст на продуктивноста во земјата, развојот на технологијата, намалувањето на стапката на невработеност и подобрувањето на социјалната заштита, кои создаваат раст и економски развој на една земја. Оваа истражување исто така има за цел да го потенцира нивото на инвестициска ефикасност во призмата на споредливоста на РМ со земјите од Западен Балкан.

Од оваа истражување доаѓаме до важен заклучок за една деликатна економска ситуација на РМ во периодот по финансиската криза, вклучувајќи ги и некои земји од Западен Балкан со економски, политички и социјални проблеми и стагнација на растот на БДП.

Наодите од оваа истражување не доведоа до заклучок дека Република Македонија не се смета за земја со највисока ефикасност на инвестициите во Западен Балкан. Како резултат на неефикасното и неефективното искористување на инвестициите, процесот на растот и економскиот развој во земјата стагнираа.

Клучни термини: ефикасност, инвестиции, економски раст, финансиска криза.

Abstract

The Republic of Macedonia is a country in continuous development that copes with many economic, financial, political and legal challenges, hereby a huge number of reforms are necessary to be implemented. One of the primary economic factors that require their proper management is investment. The efficient and effective implementation of investments in these key economic sectors will enable the national economy to accelerate the economic growth.

The aim of this Master Thesis is to provide a thorough analysis of investments in general and their efficiency in the GDP of the Republic of Macedonia, taking into consideration the period before, during and after the financial crisis. Investments are one of the main drivers of overall productivity growth in the country, technology development, reduction of the unemployment rate and the improvement of social welfare that create the level of growth and economic development of a country. This research paper also helps us to highlight the level of investment efficiency in the prism of RM comparability with the Western Balkan countries.

From this study we have noticed a fragile economic situation of RM in the period after the financial crisis, including some Western Balkan countries with economic, political and social problems and a stagnation of GDP growth.

The findings of this study lead us to a conclusion that the Republic of Macedonia is not considered as the country with the highest efficiency of investments in the Western Balkans. As a result of inefficient and ineffective investment utilization, the process of growth and economic development in the country has stagnated.

Key words: efficiency, investment, economic growth, financial crisis.

Përmbajtja

Qëllimi dhe identifikimi i problemit.....	13
Metodologjia e hulumtimit.....	15
Hipotezat e studimit	16
Qëllimet dhe objektivat e studimit	17
KREU 1 - Aspektet teorike të investimeve	18
1.1 Investimet si kategori ekonomike	18
1.2 Llojet e investimeve dhe financimi i tyre	21
1.3 Relacioni i investimeve dhe rritja ekonomike	24
1.4 Efikasiteti i investimeve – treguesit e efikasitetit.....	27
KREU 2 - Investimet dhe Prodhimi i Brendshëm Bruto në Republikën e Maqedonisë për periudhën (2006-2016).....	31
2.1 Analiza strukturore dhe dinamike e investimeve në mjetet themelore (IMTh)	32
2.1.1 Analiza strukturore e investimeve në mjete themelore sipas strukturës teknike.....	34
2.1.2 Analiza dinamike e investimeve në mjete themelore sipas strukturës teknike.....	36
2.1.3 Analiza strukturore e investimeve në mjete themelore sipas sektorëve institucional.....	38
2.1.4 Analiza dinamike e investimeve në mjete themelore sipas sektorëve institucional.....	39
2.2 Analiza strukturore dhe dinamike e investimeve të huaja direkte (IHD).....	41
2.2.1 Struktura e Investimeve të huaja direkte.....	42
2.2.2 Investimet e huaja direkte dhe pjesëmarrja e tyre në PBB	43
2.3 Analiza e pjesëmarrjes së veprimtarive ekonomike në PBB	45

2.3.1 Analiza strukturore e IMTh sipas veprimtarive ekonomike	48
2.3.1.1 Analiza e pjesëmarrjes së investimeve sipas veprimtarive ekonomike gjatë periudhës 2006 – 2017	50
2.3.2 Analiza dinamike e IMTh sipas veprimtarive ekonomike.....	52
2.4 Analiza e investimeve bruto dhe pjesëmarrja e tyre në PBB	54
2.4.1 Pjesëmarrja e bruto investimeve në PBB	56
KREU 3 - Efikasiteti i investimeve në Republikën e Maqedonisë dhe vendet e Ballkanit	
Perëndimor	57
3.1 Përcaktimi i variablave	57
3.2 Burimet e të dhënave	58
3.3 ICOR për Republikën e Maqedonisë.....	59
3.4 Niveli i borxhit publik dhe investimet bruto në Republikën e Maqedonisë	62
3.5 ICOR dhe vlerësimi i ekonomisë së vendeve të Ballkanit Perëndimor	65
3.5.1 Kosova	66
3.5.2 Shqipëria.....	68
3.5.3 Serbia.....	71
3.5.4 Mali i Zi	73
3.5.5 Bosnia dhe Hercegovina	76
3.5.6 Kroacia	78
3.5.7 Analiza komparative e ICOR të Maqedonisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor.....	81
3.6 Analiza dhe interpretimi i rezultateve	84
Përfundim	92
Rekomandime	96
Bibliografia	98

Lista e shkurtesave

BQRM – Banka Qendrore e Republikës së Maqedonisë

RM – Republika e Maqedonisë

BE – Bashkimi Evropian

IMTH – Investime në mjete themelore

PBB – Produkti i bruto i brendshëm

IHD – Investimet e huaja direkte

BP – Ballkani Perëndimor

ICOR – Incremental capital output ratio (Koeficienti inkremental i kapitalit)

IB – Investimet bruto

NACE Rev. 2 - Statistical classification of economic activities in the European Community
(Sistemi i Klasifikimit të Veprimtarive Ekonomike në Unionin Evropian)

MKD – valuta kombëtare e RM (denarë)

INS. – Institucion

MNE – Mali i Zi

SRB – Serbia

BiH – Bosnia dhe Hercegovina

KS – Kosova

AL – Shqipëria

HR – Kroacia

Lista e grafikeve dhe figurave

Grafiku 1. Rritja reale e PBB në RM (2006 - 2017).....	25
Grafiku 2. Investimet në mjete themelore në Maqedoni (në mil. denarë).....	33
Grafiku 3. IMTh sipas strukturës teknike para, gjatë dhe pas krizës financiare (në mil. denarë)	37
Grafiku 4. IMTh sipas sektorëve institucional para, gjatë dhe pas krizës financiare (në mil. denarë).....	41
Grafiku 5. Struktura e Investimeve të huaja direkte dhe porfolio investimeve (në mrd. euro)	43
Grafiku 6. IHD dhe pjesëmarrja e tyre në PBB.....	44
Grafiku 7. Pjesëmarrja e investimeve si % sipas veprimtarive ekonomike (2006 - 2017).....	51
Grafiku 8. Relacioni në mes bruto investimeve dhe PBB	55
Grafiku 9. Pjesëmarrja e bruto investimeve në PBB.....	56
Grafiku 10. Industria dhe PBB-ja në mil. denarë, gjatë viteve 2006 – 2016.....	87
Grafiku 11. Raporti në mes investimeve bruto dhe borxhit në Republikën e Maqedonisë (në mil. denarë).....	89
 Figura 1. Rrethi vicioz i modelit Harrod - Domar	60

Lista e tabelave

Tabela 1. Analiza strukturore e IMTh sipas strukturës teknike (në mil. denarë)	35
Tabela 2. Analiza dinamike e IMTh sipas strukturës teknike (në mil. denarë)	36
Tabela 3. Analiza strukturore e IMTh sipas sektorëve institucional (në mil. denarë)	39
Tabela 4. Analiza dinamike e IMTh sipas sektorëve institucional (në mil. denarë).....	39
Tabela 5. Pjesëmarrja e veprimtarive ekonomike (si vlerë shtesë) si % në PBB	47
Tabela 6. Analiza strukturore e IMTh sipas veprimtarive ekonomike (në mil. denarë)	48
Tabela 7. Analiza dinamike e IMTh sipas veprimtarive ekonomike (në mil. denarë).....	53
Tabela 8. ICOR për Maqedoninë	60
Tabela 9. Borxhi publik dhe investimet bruto (në mil. denarë).....	63
Tabela 10. Trendi i investimeve bruto si rezultat i rritjes së borxhit publik në RM (në mil. denarë).....	63
Tabela 11. ICOR në Kosovë	68
Tabela 12. ICOR në Shqipëri.....	70
Tabela 13. ICOR në Serbi.....	73
Tabela 14. ICOR në Mal të Zi.....	75
Tabela 15. ICOR në Bosne dhe Hercegovinë.....	78
Tabela 16. ICOR në Kroaci	80
Tabela 17. Krahasoni i ICOR në Maqedoni dhe vendet e Ballkanit Perëndimor	81
Tabela 18. Rritja reale e PBB-së dhe ICOR në Maqedoni	85
Tabela 19. Borxhi publik dhe investimet bruto në mil. denarë	88
Tabela 20. Vlerësimi i ICOR për BP	90

Qëllimi dhe identifikimi i problemit

Zhvillimi i ekonomisë së vendeve të Ballkanit Perëndimor ka kaluar nëpër periudha të ndryshme që nga kriza financiare e viteve 2007 – 2008. Padyshim që kjo ka prekur shumë çështje të karakterit ekonomik, social dhe politik, gjë e cila ka detyruar që këto vende të bëjnë vazhdimisht reforma të ndryshme të cilat do të arrinin të nxjerrin në pah rezultate pozitive në aspekt të rritjes ekonomike duke pasur parasysh vështirësitë me të cilat janë përballuar si mungesë e institucioneve përkatëse për të qenë më kompetitiv. Për të arritur këto reforma shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë kaluar nga një etapë e zhvillimit ekonomik në një tjetër nëpërmjet një cikli kompleks, ku ka qenë i nevojshëm një numër i madh i investimeve në fusha të ndryshme duke përfshirë në thellësi infrastrukturën, transportin, energjinë dhe investime tjera të cilat kushtimisht do të rezultojnë në një paradigmë të suksesshme ekonomike. Kjo paradigmë shpjen në një zhvillim të produktivitetit, i cili me automatizëm do të zvogëlojë normën e papunësisë, rritjen e PBB-së dhe rritjen e investimeve në përgjithësi dhe efikasitetin e tyre në zhvillimin ekonomik të vendeve. Për të arritur këtë efikasitet qeveria dhe institucionet përkatëse duhet të planifikojnë në mënyrë optimale sasinë e kapitalit që do të investohet (fondet që do të ndajë nga buxheti i planifikuar apo huazime eventuale) për projekte të caktuara, të cilat do të duhet të rezultojnë në një efekt pozitiv në rritjen ekonomike të vendit.

Investimet si në aspektin mikroekonomik ashtu edhe në atë makroekonomik mundësojnë shfrytëzimin e resurseve të pashfrytëzuara në drejtim të krijimit të një vlere të re shtesë. Investimet në mjete themelore si dhe në infrastrukturë janë ndërmarrje kyçe në drejtim të ndryshimeve tekniko teknologjike dhe rritjes së produktivitetit me këtë edhe në rritjen e produktit të brendshëm bruto. Investimet kapitale janë të një rëndësie të veçantë në një ekonomi kombëtare andaj mënyra se si realizohen dhe menaxhohen ato janë temë diskutimi në menaxhimin e politikave makroekonomike, prandaj sa më efikase të jenë ato aq më i theksuar do të jetë ndikimi në nivelin e lartë të rritjes ekonomike duke pasur parasysh që resurset janë të kufizuara dhe shfrytëzimi efikas i tyre do të shpijë në ndryshime pozitive në vend.

Këtu qëndron edhe problemi esencial i këtij hulumtimi i cili pa marrë parasysh faktit që duket kompleks, megjithatë studimet empirike do të nxjerrin në pah analizën e investimeve dhe lidhjen e tyre me rritjen ekonomike në një mënyrë më të lehtë. Në këtë aspekt përmes këtij studimi do të analizojmë se në çfarë niveli kanë qenë investimet dhe si ka qenë dedikimi i tyre në drejtim të produktivitetit në ekonomi. Përveç kësaj, shtrohet pyetja: a kanë qenë investimet të nevojshme dhe sa efikase janë ndaj rritjes ekonomike në vend?! Vlen të theksohet krahasimi që do të bëjmë me vendet e Ballkanit Perëndimor, e ku do të konstatojmë nivelin e efikasitetit në Maqedoni dhe në vendet e analizuara. Për të realizuar këtë studim do ju referohemi disa treguesve edhe atë: koeficienti i kapitalit mesatar, koeficienti i kapitalit marginal dhe koeficienti i kapitalit inkremental. Sipas literaturës ekonomike dhe Bankës Botërore treguesi i kapitalit inkremental që njëkohësisht do të jetë pikë referimi në këtë studim - ICOR (Incremental Capital Output Ratio) sa më i ulët të jetë shkalla e efikasitetit të investimeve është më e lartë dhe nëse treguesi është i lartë atëherë efikasiteti apo produktiviteti i kapitalit është i ulët.

Metodologjia e hulumtimit

Aplikimi i metodologjisë adekuate konform natyrës së dukurisë së analizuar do të mundësojë zhvillimin e hulumtimeve dhe analizave, qëllimet si dhe instrumentet të cilat do të shfrytëzohen gjatë marrjes së të dhënave, përpunimit dhe interpretimit të tyre në fund.

Për t'ju dhënë përgjigje hipotezave të parashtruara më poshtë do të ndërmerren këto hapa:

Gjetja e të dhënave të duhura që do të analizohen, nga burime të sakta dhe me informacione të dobishme pa ndonjë limitim të të drejtës së autorit gjë që është aspekti më i rëndësishëm në formulimin e tezës.

Në bazë të kësaj, të dhënat do të merren nga burime të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare edhe atë: Enti shtetëror i statistikave të RM-së, Ministria e Financave dhe Banka Popullore e RM-së, Banka Botërore, Eurostat si dhe nga raportime të ndryshme më relevante për hulumtimin. Gjatë analizës së të dhënave do të shfrytëzohen dy valuta kryesore: denari si valutë kombëtare për të dhënat lidhur me ekonominë e Maqedonisë dhe valuta e euros për të konstatuar rezultatet në lidhje me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor.

Analiza e të dhënave do të bëhet përmes formulave të caktuara si dhe me disa kalkulime në një program të veçantë statistikor. Nga këto përlllogaritje dhe gjetje do të arrihet përmbushja e qëllimit të tezës nga ku do të rezultojë në një konkluzion që do të nxjerr në pah sa efikase janë investimet dhe si ndikojnë në ekonominë e vendit.

Informacioni që do të analizohet duhet të sigurojë një rezultat bindës që do të jetë i lehtë për t'u interpretuar dhe transmetuar tek të tjerët. Mënyra se si do të përpunohen dhe interpretohen këto rezultate do të japin njohuri mbi atë se si duhet të veprojë qeveria duke mundësuar zvogëlimin e shpenzimeve e me këtë edhe borxhit dhe duke investuar në projekte fitimprurëse që kanë dobi për qytetarët dhe qeverinë njëkohësisht, të cilat shihen si të nevojshme për përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe politike në vend. Pjesë e kësaj analize janë edhe institucionet private në përgjithësi që japin kontributin e tyre në stimulimin e rritjes ekonomike.

Hipotezat e studimit

Duke pasur parasysh se Maqedonia është një vend në zhvillim me një klimë të favorshme për investim, kontributi i qeverisë është i vogël në raport me interesin e investorëve. Ndërkaq, investimet konsiderohen elementi kryesor i stimulimit të rritjes ekonomike dhe nivelit të zhvillimit ekonomik. Struktura dhe efikasiteti i tyre krijon një mundësi për procesin e zhvillimit të ekonomisë së vendit në rolin e bartësve primar të politikave makroekonomike. Prandaj, problemi kryesor i hulumtimit do të qëndrojë mbi efektin e investimeve në rritjen ekonomike. Respektivisht, analiza empirike do të realizohet nëpërmjet përpunimit të të dhënave dhe klasifikimit të tyre në bazë të kriterëve të caktuara gjatë periudhës që do të bëhet hulumtimi, njëkohësisht edhe me anë të një mënyrë vlerësimi të përpiluar nga vetë autori.

Në bazë të qëllimeve të hulumtimit, në këtë punim do të shtjellohen hipotezat e mëposhtme:

H₀: Rritja e efikasitetit të investimeve ndikon në rritjen e vazhdueshme ekonomike.

H₁: Rritja e efikasitetit të investimeve nuk ndikon në rritjen e vazhdueshme ekonomike.

H₀: Investimet në sektorin e industrisë (prodhimit) determinojnë rritjen ekonomike.

H₁: Investimet në sektorin e industrisë (prodhimit) nuk e determinojnë rritjen ekonomike.

H₀: Trendi i investimeve është në proporcion të drejtë me rritjen e borxhit me PBB-në.

H₁: Trendi i investimeve është në proporcion të zhdrejtë me rritjen e borxhit me PBB-në.

H₀: ICOR në RM është më i ulët krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor.

H₁: ICOR në RM nuk është më i ulët krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor.

Qëllimet dhe objektivat e studimit

Vendimarrja rreth investimeve dhe llojit të investimeve paraqet një çështje shumë të rëndësishme për politikat ekonomike të qeverisë. Një menaxhim efikas krijon një dobi jo vetëm në aspekt ekonomik dhe politik, por, edhe në aspektin social dhe mirëqenien në tërësi. Investimet në infrastrukturë ndikojnë në rritjen e produktivitetit duke mundësuar shërbime më të mira. Kjo rezulton në një ekonomi më të fuqishme dhe në rritjen e punësimeve gjë që është një aspekt shumë i rëndësishëm në ekonominë e vendit. Me këtë do të rriten edhe të ardhurat publike dhe baza e tatimeve që do të jetë në dobi edhe të qeverisë, por edhe për qytetarët duke u mundësuar perspektiva për të ardhmen në drejtim të zvogëlimit të përqindjes së papunësisë dhe reduktimit të nivelit të varfërisë. Me rritjen e numrit të punësimeve do të rritet edhe produktiviteti i cili do të ndikojë në rritjen e PBB-së.

Ekonomia e Republikës së Maqedonisë është në stadin e vendeve në zhvillim me probleme të natyrave të ndryshme vendore dhe ndërfqinjësore, me shkallë të lartë të papunësisë dhe probleme sociale, me një dukuri të ikjes së të rinjve - “trurit” jashtë vendit, me kapacitet të ulët të investimeve kapitale buxhetore në krahasim me vendet fqinje. Andaj vlerësojmë se qasja e menaxhimit me investimet në mënyrë efikase dhe efektive është imperativ i kohës në drejtim të hapjes së vendeve të lira të punës, përmirësimit të standardit jetësor dhe integritimeve në BE.

Prandaj, qëllimi kryesor qëndron në analizën e efikasitetit të realizimit të investimeve në rritjen ekonomike të Maqedonisë dhe vendeve në rajon. Njëkohësisht bazuar në raportin e investimeve ndaj PBB-së, treguesi ICOR do të mat efikasitetin e investimeve në rritjen ekonomike. Në bazë të kësaj do të analizohet:

- Efikasiteti i investimeve në PBB si pasojë e krizës financiare të pas viteve 2007-2008;
- Cili do të ishte niveli optimal i investimeve për një rritje të qëndrueshme;
- Investimet a kanë ndikuar në rritjen e vazhdueshme të borxhit publik;
- Çfarë masa duhet ndërmarrë qeveria për të përmirësuar gjendjen ekonomike dhe sociale në vend!

KREU 1 - Aspektet teorike të investimeve

1.1 Investimet si kategori ekonomike

Investimet si kategori ekonomike janë një ndër determinuesit fundamental që ndikojnë në rritjen ekonomike. Ato funksionojnë si një mjet i cili bën të mundur rritjen e fondeve të kapitalit që përfshin aspekte të ndryshme si ndërtimtari, prodhimtari, makineri apo aktivitete tjera ekonomike si punësimi dhe të ardhurat.

Zhvillimi ekonomik i vendit është i një rëndësie vitale i cili ndikon në përmirësimin e shëndetit të ekonomisë dhe investimet janë ato të cilat bëjnë të mundur krijimin e një ekonomie të qëndrueshme dhe të favorshme për shtetin. Bazuar në këtë, hartimi i projekteve të ndryshme investive, përmirësimi i infrastrukturës, industrisë dhe prodhimtarisë, edukimit, shëndetësisë si dhe projekte tjera të aktiviteteve ekonomike japin një kontribut domethënës dhe rezultate pozitive për një ekonomi nacionale.

Në përgjithësi, investimet i referohen një procesi i cili shfrytëzon resurset e tij financiare apo materiale të shprehura financiarisht për të blerë asete të cilat do të gjenerojnë të ardhura me kalimin e kohës. Nga vet etimologjia e fjalës në gjuhën latine “*investicio*” **kuptojmë shtesën e fondeve për të gjeneruar rritjen e të mirave reale në një kohë të ardhme**. Pra, kjo mundëson rritjen e fondeve të kapitalit e cila nëpërmjet shfrytëzimit të teknologjisë do të realizojë prodhimtari të lartë, punësim dhe rritjen e bruto prodhimit të brendshëm (PBB). I gjithë ky cikël nëpër të cilin kalojnë institucionet private dhe publike rezulton në një rritje ekonomike stabile në vend.

Investimet luajnë një rol mjaft esencial në ekonominë e vendit duke përfshirë dy aspekte të rëndësishme: rritja e investimeve krijon rritjen e kërkesës agregate, e cila e vërtetuar në mënyrë teorike dhe praktike ka efekt pozitiv mbi prodhimin dhe punësimin; dhe në aspektin tjetër investimet pasqyrojnë akumulim të kapitalit, që nënkupton rritjen e fondeve të makinerive, pajisjeve, objekteve ndërtimore të cilat rrisin gjasat për përmirësimin e prodhimtarisë në vend. Këtu qëndron edhe qëllimi kryesor i investimeve në mënyrë që të stimulojnë rritjen ekonomike me kontributin e sektorit privat dhe publik. Ashtu siç e

komenton ekonomisti i njohur N. Gregory Mankiw, **kursimet dhe investimet** janë dy faktorët kyç të rritjes ekonomike në afat të gjatë (Mankiw, 2009). Sipas tij kur një shtet kursen një pjesë të madhe të PBB-së së tij, më shumë resurse janë në dispozicion për investime në kapital, dhe kapitali më i lartë rrit produktivitetin dhe standardin jetësor të vendit.

Duke pasur parasysh se kapitali paraqet fondet të cilat shfrytëzohen për prodhimin e të mirave dhe shërbimeve, është e një rëndësie të cekim se investimet mundësojnë zgjerimin e këtyre fondeve të kapitalit. Në këtë aspekt investimet pasqyrohen në tre lloje:

1. Investime reale materiale ku përfshihet çdo investim në makineri, prodhimtari apo ndërtimtari.
2. Investime jomateriale në të cilat grupohen licenca, marka tregtare, patenta si pronë intelektuale.
3. Investime financiare që krijojnë rritjen e fondeve nëpërmjet investimit në letra me vlerë, obligacione, bono thesari e tjerë.

Si investimet financiare të investorëve individual, ashtu edhe ato në kapitalin real gjenerojnë fonde financiare. Megjithatë, në aspekt të ekonomisë nacionale ndryshojnë kushtet: investimet financiare nënkuptojnë transfer personal që nuk është produktiv. Ndërkaq investimet në kapitalin real kanë kuptimin e krijimit të një kapitali produktiv si objekte ndërtimore, makineri dhe aktive tjera¹.

Është e rëndësishme të bëjmë diferencën në mes termeve investim dhe financim. Shpesh herë krijohet një konfuzitet në kuptimin e këtyre dy termeve. Në këtë rast ato shërbejnë për qëllimin e përbashkët: gjenerimin e mjeteve financiare, por, janë dy aktivitete të ndryshme nga njëra tjetra.

Financimi nënkupton aktin e dhënies së fondeve financiare në institucione të ndryshme në kuptimin e mbulimit të shpenzimeve duke mos krijuar në asnjë mënyrë të ardhura shtesë në aspekt të rritjes së fondeve të kapitalit. Financime të tilla mund të konsiderohen institucione sociale, të arsimit, kulturës etj.

¹Shkëputur nga: Metodija Nestorovski: "Ekonomija na investiciite", Ekonomski Fakultet, Skopje, 2005, fq.10-11.

Investimi nga vet elaborimet e përmendura më lartë, përfshin vetëm aktin e financimit i cili do të mundësojë krijimin e të mirave reale, rritjen produktivitetit të kapitalit dhe me ç'rast, rritjen e të ardhurave që do të rezultojnë nga ai investim.

1.2 Llojet e investimeve dhe financimi i tyre

Aspektet teorike të natyrës ekonomike shprehin disa klasifikime të investimeve varësisht politikave makroekonomike, në bazë të formave konkrete të kapitalit në të cilat shndërrohen investimet; në bazë të funksioneve etj. Disa nga kategoritë si më të rëndësishme për analizat e mëtutjeshme ekonomike do t'i elaborojmë në këtë pjesë.

Në bazë të burimit të investimit dallojmë tre lloje të investimeve:

1. **Investimet publike** i referohen çdo investimi të bërë nga shteti qoftë nga qeveria lokale, qendrore apo nga ndërmarrje publike që gjeneron të ardhura kombëtare në interes të ekonomisë së vendit. Sigurimi i mallrave dhe shërbimeve, infrastrukturës, teknologjisë apo shërbime tjera në nivel kombëtar, janë detyrim kryesor i qeverisë në përmirësimin e rritjes ekonomike.
2. **Investimet private** nënkuptojnë çdo investim të kryer nga institucione private në dobi të rritjes së profitit të saj që do t'i gjenerojë të ardhura shtesë nga vlera e investuar dhe rritje të kapitalit. Investime të tilla mund të jenë investime financiare, në makineri, pajisje, teknologji etj.
3. **Investimet e huaja** nënkuptojnë kur një shoqëri nga një shtet investon në asetet e një shoqërie që i përket një vendi tjetër. Këto investime janë shumë të rëndësishme meqë rrisin sasinë e kapitalit të atij vendi dhe njëkohësisht stimulojnë rritjen ekonomike.

Ekzistojnë disa kategori tjera të investimeve, duke filluar nga:

- Bruto dhe neto investimet
- Investimet demografike dhe ekonomike
- Investimet autonome dhe induktive
- Investimet në kapitalin fiks dhe atë qarkullues
- Investimet primare dhe sekondare
- Struktura teknike e investimeve

Bruto investimet përfshijnë të gjitha investimet e realizuara në një ekonomi nacionale brenda një periudhe të caktuar kohore. Ato janë vlera totale që shpenzohen për të mira

kapitale të reja (makineri, paisje, objekte ndërtimore etj.) në një shtet dhe krijohen nga amortizimi i kapitalit fiks si burim kryesor, produktit kombëtar dhe të ardhurat nga investimet e huaja. Bruto investimet minus amortizimin japin neto investimet.

Neto investimet kanë kuptimin e atyre investimeve që ngelin pas reduktimit të amortizimit. Pra, ato janë investimet të cilat shfrytëzohen për krijimin e kapitalit të ri fiks apo qarkullues. Njëkohësisht ato japin vlerën e “pastër” të kapitalit që ngel pas amortizimit dhe kjo vlerë jep efekt pozitiv mbi rritjen ekonomike. Kalkulimi i tyre bëhet nga minusimi i bruto investimeve dhe amortizimit nga ku rezulton kapitali real në bazë të të cilit rritet vlera e fondeve të kapitalit në ekonominë nacionale brenda një periudhe të caktuar kohore që është zakonisht një vit. Për dallim nga bruto investimet, këto mund të paraqiten me vlerë negative, por, në raste të tilla kjo e cenon ekonominë e një vendi meqë supozohet që vlera e bruto investimeve të dalë më e vogël se vlera e amortizimit.

Investimet demografike dhe ekonomike – rritja e popullsisë, zakonisht në afat të gjatë ka një efekt pozitiv mbi ekonominë nacionale. Kur bëhet fjalë për demografinë kemi parasysh faktorët social, ekonomik, religjioz dhe të tjerë. Këto investime realizohen me qëllim që produkti i brendshëm bruto për kokë banori të ngelet i pandryshuar në raport me periudhën paraprake.

Investimet ekonomike janë të lidhura me ato demografike në aspekt të ndikimit në rritjen e PBB-së nga fakti që edhe rritja e popullsisë është një faktor i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Çdo rritje e numrit të popullsisë stimulon edhe rritjen e punësimit dhe rritjen e të ardhurave kombëtare.

Investimet autonome janë ato investime të cilat nuk varen nga ndryshimet në ekonomi d.m.th. nuk janë të lidhura me ndryshimin e nivelit të të ardhurave, pagave apo prodhimtarisë. Investimet e tilla realizohen për mirëqenien sociale, rregullimin e infrastrukturës dhe çdo gjë tjetër që nuk gjeneron profit, janë konstante, por, jo në të gjitha rastet. Ato ndryshojnë kur vijnë në shprehje determinues tjerë të shpenzimeve si norma e interesit, teknologjia, pritjet, çmimi i kapitalit etj². Këto investime zakonisht bëhen nga

² AmosWEB LLC

http://www.amosweb.com/cgi-bin/awb_nav.pl?s=wpd&c=dsp&k=autonomous+investment

institucione publike apo qeveria për ndërtimin e rrugëve, objekteve etj., dhe rritja apo zvogëlimi i tyre varet plotësisht nga vendimet e qeverisë.

Investimet induktive janë investime të tilla që realizohen nga sektori privat dhe që varen nga niveli i të ardhurave apo prodhimtarisë përkundër investimeve autonome. Për nga natyra e shpenzimeve të sektorit privat, këto investime bazohen në të ardhurat e përgjithshme të biznesit. Kjo nënkupton se rritja e prodhimtarisë do të rezultojë me rritjen e të ardhurave dhe sigurisht kjo stimulon profit. Profiti patjetër që do të motivojë menaxherët e bizneseve që të realizojnë investime të tilla dhe kjo e bën më të lehtë financimin e kapitalit investues.

Investimet në kapitalin fiks dhe qarkullues - Investimet në kapitalin fiks nënkuptojnë ato investime të aktiveve afatgjata të cilat amortizohen për një kohë të gjatë varësisht vlerës së tyre. Investime të tilla mund të përfshijnë: ndërtesa, objekte, toka, makineri si aktive materiale dhe prona intelektuale (licenca, marka, patenta etj.) si aktive jomateriale. Pa praninë e këtyre aktiveve fikse bizneset nuk mund të vijnë me procesin e prodhimit. Ndërsa investime në kapitalin qarkullues përfshijnë mirëmbajtjen dhe financimin e aktiveve qarkulluese afatshkurtra të tilla si inventarizimi i materialeve, prodhimi në proces apo prodhimi i gatshëm të cilët janë pjesë e veprimtarisë së përditshme të biznesit. Rëndësia e tyre qëndron në atë se kompanitë duhet të menaxhojnë inventarin duke bërë optimizimin e tij që të mos ndikojë negativisht në efikasitetin ekonomik.

Investimet primare dhe sekondare - Investimet primare nënkuptojnë ato të cilat janë të lidhura me vet sigurimin e objekteve prodhuese të tilla si fabrika, qendra tregtare dhe objekte të ngjashme të cilat shërbejnë për krijimin e kushteve për prodhim, procesit tekniko teknologjik apo qarkullimit pagesor. Investimet sekondare sigurojnë kushte për funksionimin e kapacitetit dhe i plotësojnë investimet primare për një efikasitet më të mirë. Ato përfshijnë sigurimin e lëndëve të para dhe materialeve për prodhim, investime për zgjerimin e rrjetit, sigurimin e transportit, sigurimin e forcës punëtore etj.

Struktura teknike e investimeve

Kjo kategori e investimeve tregon në çfarë fondi të kapitalit shndërrohen investimet dhe përfshin:

- Mjetet e kultivuara – plantacione, pyllëzime etj.
- Investime në objekte ndërtimore
- Investime në pajisje dhe makineri
- Investime tjera


Financimi i investimeve i referohet sigurimit të mjeteve financiare për një projekt të caktuar investiv i cili kërkon një angazhim shtesë në mënyra të ndryshme qoftë nëpërmjet emetimit të letrave me vlerë, marrjes së kredive apo gjetja e ndonjë investitori i cili do të jetë financues i atij investimi. Sigurisht që për këtë nevojitet një plan strategjik duke formuluar fazat e ardhshme që do të marrin përsipër çdo rrezik apo mundësi për të analizuar funksionimin e punëve të mëtutjeshme.

1.3 Relacioni i investimeve dhe rritja ekonomike

Rritja ekonomike është një ndër fenomenet më të rëndësishme në ekonominë nacionale duke zgjidhur problemet dhe duke mundësuar krijimin e kushteve për mirëqenien ekonomike. Duke pasur parasysh se investimet kanë një pjesëmarrje të veçantë në rritjen ekonomike, fokusi në këtë pjesë do të qëndrojë në raportin mes këtyre dy fenomeneve për të parë se deri në çfarë niveli investimet kontribuojnë në rritjen e PBB-së, respektivisht në rritjen ekonomike në mënyrë më të detajuar.

Përveç faktorëve ekonomik, ekzistojnë edhe faktorë të tjerë politik, social etj., të cilët ndikojnë në rritjen ekonomike. Paraqitja grafike më poshtë pasqyron ndryshimin e PBB-së si determinues kryesor i rritjes ekonomike nga viti 2006 deri 2017.

Grafiku 1. Rritja reale e PBB në RM (2006 - 2017)



Burimi: Raportet vjetore 2006 – 2017, BQRM, dizajnimi i autorit

Në bazë të të dhënave zyrtare nga Banka Qendrore e RM-së vërehet që nga viti 2007 PBB-ja ka filluar të zvogëlohet veçanërisht pas krizës financiare duke zbritur në -0.4%. Përderisa në vitin 2007 ka rezultuar vlera negative, në vitin 2010 është rritur në 3.4% ku më pas ka pësuar ndryshim në aspekt negativ në vitin 2012 me -0.5%. Pas vitit 2013 vërehet rritje e butë derisa në vitin 2017 rezulton 0.2% si pasojë e shumë faktorëve sidomos ato politik në vend të cilët dukshëm janë të pranishëm viteve të fundit.

Analiza teorike shpjegon se si funksionon ekonomia nacionale duke shfaqur kontributin e familjeve dhe bizneseve në rritjen ekonomike. Në bazë të kësaj familjet gjenerojnë të ardhura nga shumë burime si pensione, paga, të ardhura të natyrës sociale dhe të tjera nga të cilat ndajnë një pjesë për kursim dhe një pjesë për të përmbushur kërkesat e tyre. Kjo në aspekt ekonomik ka për qëllim të shfaqë relacionin në mes të ardhurave të disponueshme dhe nga ana tjetër konsumit dhe kursimit që d.m.th. këto komponenta janë të barabarta me njëra tjetrën. Poashtu në teorinë ekonomike sqarohet se outputi i cili përfaqëson njëkohësisht të ardhurën është i barabartë me kërkesën agregate, shpenzimet agregate dhe produktin nacional. Sipas Keynes kërkesa agregate i referohet asaj të ardhure të disponueshme e cila shfrytëzohet për investim dhe konsum personal, ndërkaq kërkesa agregate shprehet: $AD = Y = C + I + G$. Në këtë rast nga të ardhurat ne blejmë të mira (C), kursejmë (S) dhe paguajmë

taksa (T) nga ku del ekuacioni në vijim: $Y = C + S + T$. Bazuar në këtë mund të shprehim barazimin: $C + S + T = C + I + G$ apo $S + T = I + G$.

Duke analizuar këtë ekuacion mund të thuhet se kursimi dhe taksat që realizohen nga familjet dhe bizneset shfrytëzohen për financimin e investimeve dhe shpenzimet qeveritare.

Vështruar nga ky aspekt, duke parë që investimet janë një ndër komponentët kryesorë që ndikojnë në PBB, rritja e tyre do të stimulojë rritjen ekonomike.

Kur bëhet fjalë për investimet në sektorin privat, janë bizneset ato që kontribuojnë në rritjen e PBB-së nëpërmjet rritjes së inventareve dhe planifikimit për shitjen e tyre. Është e rëndësishme që ato të posedojnë sasi optimale të inventarit në mënyrë që të përmbushin kërkesat e konsumatorëve potencial, apo në raste tjera kur realizohen investime në objekte ndërtimore. Një rënie e inventareve zakonisht parasheh edhe rënien e kërkesës dhe bizneset do të zvogëlojnë prodhimin. Kjo automatikisht krijon probleme në zvogëlimin e numrit të të punësuarve. Sipas kësaj edhe investimet do të bien dhe PBB-ja zvogëlohet.

Investimet në sektorin publik kanë një rëndësi vitale mbi rritjen ekonomike nëpërmjet shumë indikatorëve që japin efekt pozitiv në zhvillimin e vendit. Ato mund të reduktojnë nivelin e varfërisë që është një fenomen i pranishëm veçanërisht në Maqedoni. Nga aspekte tjera investimet mundësojnë rritjen e të ardhurave në nivel kombëtar, përmirësimin e infrastrukturës, teknologjisë dhe të tjera. Të gjitha këto realizohen nga qeveria me qëllim që të arrihet mirëqenia sociale.

Është e rëndësishme të potencohet edhe pjesëmarrja e investimeve të huaja të cilat krijojnë një trend pozitiv në zhvillimin dhe zgjerimin e tregut në vend dhe njëkohësisht janë një lloj financimi për shtetet në zhvillim siç janë ato të Ballkanit Perëndimor. Përveç kësaj, ato mundësojnë sigurimin e teknologjisë, rritjen e numrit të të punësuarve dhe përmirësimin e kushteve të jetesës.

Të gjitha këto investime në përgjithësi bëhen pjesë e rritjes së normës së PBB-së i cili shërben si një katalizator që shpie në rritjen ekonomike. Në bazë të këtij aspekti teorik mund të themi se investimet janë në një relacion pozitiv me PBB-në e cila stimulon rritjen ekonomike. Por, shtrohet pyetja, a vlen ky pohim edhe në qoftë se analizojmë në mënyrë praktike raportin e investimeve me PBB-në në rastin e Maqedonisë?!

1.4 Efikasiteti i investimeve – treguesit e efikasitetit

Qëllimi esencial i çdo investimi që bëhet është krijimi i mundësive për rritjen e profitit apo të ardhurave në të ardhmen. Pra, këtu vlen të përmendet se kthehemi tek vlera në kohë e parasë e cila është e lidhur me investimin e bërë sot për të krijuar efekte pozitive në të ardhmen në aspekt financiar apo efekte tjera të cilat janë të dobishme për ekonominë nacionale.

Një ekonomi nacionale apo bizneset duhet të kenë parasysh gjithmonë planet strategjike për të realizuar një investim të suksesshëm, duhet të përcaktojnë qëllimet kryesore në bazë të të cilave do të mbështeten gjatë tërë procesit investiv në mënyrë që të rezultojë efikas. Gjithkund është e dukshme prania e resurseve të kufizuara, prandaj duhet të shqyrtohen këto qëllime dhe nëpërmjet shfrytëzimit optimal të resurseve të arrihet në një rezultat pozitiv i cili do të jetë efikas dhe do të stimulojë zhvillimin e mëtejshëm ekonomik. Nga ky këndvështrim vjen në shprehje se sa do të jenë efikase këto investime të realizuara që nënkupton mënyrën e shfrytëzimit të resurseve me të cilin do të arrihet niveli më i lartë i prodhimitarisë dhe shërbimeve. Një sistem do të rezultojë më efikas se tjetri në qoftë se me sasinë e njëjtë të inputit, në këtë rast investimeve, do të gjenerojë output më të lartë, që është PBB-ja. Për shembull, në rastin e Maqedonisë zvogëlimi i normës së papunësisë është qëllimi kryesor i qeverisë dhe në bazë të kësaj ajo krijon projekte të ndryshme investive nëpërmjet agjencisë së punësimit për stimulimin e vendeve të reja të punës dhe vetëdijësimin e individëve që të mos zgjedhin alternativën e emigrimit. Por, sa efikasë rezultojnë këto projekte investive dhe çështje të tjera që janë pjesë e planit strategjik të qeverisë, do ta shqyrtojmë më vonë në këtë studim!

Efektet e investimeve gjithmonë varen nga motivi i investitorit i cili krijon në vete disa alternativa për të zgjedhur atë e cila do të rezultojë më efikase dhe më e dobishme jo vetëm nga këndvështrimi i investitorit, por edhe nga aspekti makroekonomik. Atëherë, cilët janë ato kritere dhe tregues kryesor që matin efikasitetin e investimeve?

Ekzistojnë kritere të ndryshme të matjes së efikasitetit të investimeve, por, një nga më të rëndësishmet është ICOR (raporti i rritjes së kapitalit) i cili mat raportin në mes nivelit të investimeve të realizuara në një ekonomi nacionale dhe PBB-së. ICOR nënkupton sasinë e

nevojshme të kapitalit për të prodhuar një output i cili është shumë i dobishëm në analizën e planit ekonomik.

Treguesit e efikasitetit

Rritja ekonomike varet nga shumë faktorë ekonomik, social, politik e të tjerë, megjithatë pesha e investimeve si një nga faktorët ekonomik është shumë më e madhe pasi që ndikon në mënyrë direkte mbi rritjen ekonomike. Arsyeja pse e themi këtë është se çdo gjë lidhet me investimet si p.sh.: çdo përmirësim i prodhimtarisë dhe kapaciteteve, rritje e numrit të të punësuarve, përmirësim i teknologjisë, arsimit, kushteve sociale apo gjithçka tjetër që kërkon ndryshime me të vetmin qëllim – stimulimin e rritjes ekonomike.

Në bazë të kësaj, investimet dalin variabla më e rëndësishme e rritjes ekonomike, ndërsa kjo e fundit paraqitet si një funksion i madhësisë së investimeve. Për këtë shkak është e arsyeshme të kontrollojmë mënyrën si realizohen ato dhe deri në çfarë mase janë efikase për përmirësimin e PBB-së e me këtë edhe të rritjes ekonomike.

Për të shfaqur analizat e efikasitetit, duhet parë treguesit që e matin atë të cilët krijojnë lidhjen në mes kapitalit si input dhe prodhimtarisë si output gjithmonë në aspekt makroekonomik brenda një periudhe të caktuar. Ato janë:

1. Koeficienti mesatar i kapitalit
2. Koeficienti marginal i kapitalit
3. Koeficienti i rritjes (inkremental) së kapitalit

Koeficienti mesatar i kapitalit llogarit raportin në mes bruto investimeve totale dhe produktit të brendshëm bruto. Zakonisht në llogaritje merret parasysh vetëm kapitali fiks dhe kjo ndodh për arsye që të mos arrijë në një devijim të vlerës. Qëllimi i këtij koeficienti është të vlerësojë efikasitetin mesatar të një njësie kapitali dhe shprehet me formulën:

$$k = \frac{K}{P}^3$$

³ Shkëputur nga: Metodija Nestorovski: “Ekonomija na investiciite”, Ekonomski Fakultet, Skopje, 2005, fq. 330

Ku **K** nënkupton kapitalin fiks dhe **P** është vlera e PBB-së. Ky koeficient shpreh furnizimin e prodhimit me kapitalin fiks apo më saktë sa njësi kapital është investuar për krijimin e një njësie prodhimi. Nga ky këndvështrim, sa më i vogël të rezultojë koeficienti mesatar i kapitalit, efikasiteti i kapitalit të investuar është më i madh dhe anasjelltas, sa më i madh të jetë ky koeficient efikasiteti është më i vogël. Në bazë të kësaj analize duhet të merren parasysh të dhënat statistikore të sakta në mënyrë që rezultati përfundimtar të jep një vlerë e cila do të nxjerr në pah efektin e investimeve mbi rritjen ekonomike, si në aspekt të ekonomisë nacionale ashtu edhe në bazë të sektoreve apo strukturave tjera.

Koeficienti marginal i kapitalit

Koeficienti marginal i kapitalit për dallim nga ai mesatar, shpreh matjen e efikasitetit të rritjes së kapitalit – investimeve. Pra duke u nisur nga kjo, koeficienti marginal llogarit se sa njësi të investimeve në fonde fikse janë përdorur për të përfituar një njësi shtesë të prodhimit që zakonisht merret parasysh PBB-ja. Formula e llogaritjes së këtij koeficienti është:

$$k_m = \frac{\Delta K}{\Delta P} = \frac{K_1 - K_0}{P_1 - P_0} = \frac{I_{f1} - I_{f0}}{P_{t1} - P_{t0}} = \frac{I}{\Delta P}^4$$

Ku ΔK shpreh ndryshimin e vlerës së kapitalit dhe ΔP ndryshimin e vlerës së prodhimit - PBB brenda një periudhe të caktuar.

Njëjtë sikur koeficienti mesatar edhe ky koeficient mund të jep rezultate jo vetëm në nivel të ekonomisë nacionale, por edhe në nivel të sektoreve apo veprimtarive të ndryshme ekonomike, prandaj edhe njihet si koeficient në bazë të sektorit apo strukturës.

Koeficienti inkremental i kapitalit (ICOR)

ICOR (Incremental capital output ratio) është një matës që shpreh vlerën shtesë të kapitalit të investuar që nevojitet për të gjeneruar outputin (PBB). Veçoria e këtij matësi qëndron në raportin në mes rritjes së fondit të kapitalit (ΔK) dhe rritjes së PBB-së (ΔPBB). Nëse do të zëvendësojmë rritjen e fondit të kapitalit me investimet (I) atëherë, ICOR paraqet

⁴ Po aty, fq. 332

nevojën e investimeve për rritje të një njësie të PBB-së. Bazuar në këtë, ICOR paraqet investimet të ndara për rritjen e PBB-së.

$$ICOR \times \Delta PBB = I \gg \Delta PBB = I \times \frac{1}{ICOR}; \Delta PBB = I \times m \gg \frac{1}{ICOR} = m$$

Me fjalë të tjera, ICOR nënkupton raportin në mes vlerës së bruto investimeve në vitin paraprak dhe shtesës së PBB-së ($PBB_t - PBB_{t-1}$) dhe shprehet nëpërmjet kësaj formule:

$$ICOR = \frac{IB_{t-1}}{PBB_t - PBB_{t-1}} = \frac{IB_{t-1}}{\Delta PBB}^5$$

Periudha që analizohet është e përcaktuar nga ***t*** deri te ***t-1***. ***IB*** nënkupton vlerën e investimeve bruto dhe **ΔPBB** është ndryshimi i PBB-së. Një ICOR më e ulët shfaq se nevojitet një nivel i ulët i investimeve për të prodhuar rritjen ekonomike stabile dhe kjo është një situatë e favorshme për ekonominë e vendit duke pasur parasysh se kapitali që investohet është produktiv dhe më shumë efikas.

⁵ Mazllami, Jeton. “Ekonomia e investimeve”, Dispencë e FBE, SEEU, Tetovë, 2019.
Shënim: Formula e analizuar sipas interpretimit të Bankës Botërore

KREU 2 - Investimet dhe Prodhimi i Brendshëm Bruto në Republikën e Maqedonisë për periudhën (2006-2016)

Prodhimi i brendshëm bruto varet nga shumë faktorë siç e përmendëm më lartë duke filluar nga konsumi, investimet, shpenzimet qeveritare dhe neto eksporti. Ndërkaq, PBB-ja përfaqëson vlerën e të gjitha mallrave dhe shërbimeve që prodhon një ekonomi për një periudhë të caktuar kohore, dhe pjesë e saj janë edhe investimet. Këto të fundit (investimet) krijojnë mënyrën relevante se si kontribuon qeveria dhe bizneset në përmirësimin e ekonomisë nëpërmjet shfrytëzimit optimal të kapitalit të tyre. Andaj themi që pjesëmarrja e investimeve në PBB është e një rëndësie të madhe meqë aktivizon resurset të cilat janë të pashfrytëzuara, hap vende të reja pune, krijon kapacitete dhe teknologji të reja dhe së fundmi mundëson rritjen e produktivitetit, gjë që krijon një frymë pozitive në arritjen e zhvillimit të ekonomisë nacionale në të ardhmen. Bazuar në këtë aspekt, studimi do të nxjerr në pah rolin dhe impaktin e investimeve në rritjen ekonomike nëpërmjet disa analizave financiare të përpunuara.

Ekzistojnë mënyra të ndryshme për matjen e të dhënave në aspekt të gjetjes së një rezultati i cili do të jep një informacion të dobishëm për parashikimin e ndryshimeve në të ardhmen në kuptim të përmirësimit të gjendjes financiare dhe shmangies së faktorëve që ndikojnë negativisht në performancën ekonomike dhe financiare në vend.

Analiza të tilla në bazë të të cilave janë prezantuar rezultatet në vijim janë klasifikuar në: analiza strukturore dhe analiza dinamike⁶. Analiza strukturore ka të bëjë me evidencën e një tërësie operacionesh të raportuara brenda një periudhe të caktuar. Ato paraqiten si një pjesëmarrje (në përqindje) e elementeve të caktuara në një njësi ekonomike. Ndërsa, analiza dinamike mund të emërtohet si analizë e serive kohore duke pasur për qëllim të llogarit ndryshimet e elementeve të ndryshme (të shprehura në përqindje) nga një periudhë në një tjetër, për të nxjerrë në pah ndikimet e të kaluarës dhe për të bërë një parashikim mbi të ardhmen.

⁶ Halit Xhafa: "Drejtimi financiar", Tiranë, 2010, fq.73-74 .

Investimet janë të klasifikuara në bazë të strukturës duke paraqitur kategoritë më të rëndësishme që përfaqësojnë vlerën e realizuar si pjesë kryesore e përbërjes së PBB-së. Bazuar në këtë hulumtim, nëpërmjet analizës strukturore dhe dinamike, do të paraqesim llogaritjet dhe më pas gjetjet lidhur me këtë problem.

2.1 Analiza strukturore dhe dinamike e investimeve në mjetet themelore (IMTh)


Investimet në mjete themelore janë një ndër faktorët kryesor që stimulojnë rritjen ekonomike duke përfshirë blerjet e aseteve fikse dhe ndryshimet në inventar brenda një periudhe të caktuar. Një rritje e këtyre investimeve patjetër se do të zhvendos kërkesën agregate duke e rritur atë dhe njëkohësisht edhe kapacitetin e produktivitetit e cila shpie në drejtim të rritjes ekonomike. Maqedonia dhe vendet tjera të Ballkanit Perëndimor si vende në zhvillim i kushtojnë rëndësi zhvillimit të investimeve si një rritje neto në kapitalin fiks që ndikon në PBB duke përfshirë jo më tepër se 25% të saj. Duke marrë parasysh nivelin e këtyre investimeve, do të paraqesim lëvizjen e tyre duke filluar para krizës financiare, gjatë saj dhe periudhës pas ndikimit të saj në ekonominë e vendit.

Vendet e Ballkanit Perëndimor në një këndvështrim tjetër, zakonisht janë të lidhura me klimën e bizneseve nga jashtë dhe varen nga tregjet ndërkombëtare. Megjithatë, jofunksionimi i duhur i tyre ka ndikuar në situatën financiare duke pasur parasysh që kriza financiare mbizotëronte kudo në botë gjatë vitit 2008 e këndej. Mungesa e investimeve, keqmenaxhimi i tregjeve të kapitalit, ndryshimet në kursin devisor, rritja e normës së papunësisë dhe zvogëlimi i pagave dhe çështje tjera të natyrës makroekonomike ngadalësuan zhvillimin ekonomik. Përveç kësaj, kontributi i PBB-së nuk ishte në gjendje të krijojë mundësi për zhvillimin e mëtejshëm të rritjes ekonomike.

Maqedonia konsiderohet si një nga vendet me nivel më të ulët të investimeve në Ballkan. Nga ana tjetër, potenciali i saj është shumë i lartë dhe shumë sektorë si ai i infrastrukturës, shëndetësisë, aktiviteteve sociale, punësimit, arsimit e tjerë kanë nevojë për më tepër kontribut në investime, gjë që i detyron një pjesë të madhe të qytetarëve të gjejnë zgjidhje nëpërmjet emigrimit si pasojë e mungesës së investimeve në këto veprimtari. Përveç

kësaj, një problem tjetër poashtu i rëndësishëm që duhet të evitohet është edhe borxhi i lartë publik i cili pengon zhvillimin dhe stabilitetin e mëtijshëm ekonomik të vendeve. Andaj, edhe ky është një aktivitet që ndikon në mënyrë direkte në problemin e mungesës së investimeve optimale në ekonominë nacionale. Niveli i ulët i investimeve që është dukshëm i shprehur gjatë periudhës pas krizës financiare e shpreh këtë në mënyrë më detajore. Megjithatë rimëkëmbja ka filluar të vërehet pas vitit 2013 duke dhënë rezultate pozitive në të gjitha aspektet që e shpreh edhe paraqitja grafike në vijim.

Grafiku 2. Investimet në mjete themelore në Maqedoni (në mil. denarë)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave të RM, dizajnimi i autorit

Grafikoni më lartë shpreh nivelin e investimeve në mjete themelore nga viti 2006 deri në vitin 2017, duke ngjallur dyshime gjatë periudhës së krizës financiare në vitin 2008, gjë që pa marrë parasysh ndikimeve të mëdha ekonomike, investimet vazhdojnë të japin rezultate pozitive me një vlerë prej 106.873 milion denarë dhe duke u karakterizuar me një rritje prej 26.2% krahasuar me vitin paraprak që ishte 84.627 milion denarë, gjë që krijon hapa pozitiv drejtë përmirësimit të rritjes ekonomike. Megjithatë viti 2010 shënon një zvogëlim të investimeve në mjete themelore duke rënë në 100.851 milion denarë, por që nuk ka dhënë efekte negative. Ashtu siç e shpreh grafikoni, vitet në vazhdim kanë dhënë rezultate pozitive në drejtim të rritjes së vazhdueshme të vlerës së investimeve duke arritur maksimumin në

vitin 2016 me 145.040 milion denarë. Ndërsa viti 2017 shënon zvogëlim për 6.7% për dallim nga viti paraprak dhe patjetër që ky vit ka shënuar periudhën më të vështirë kohëve të fundit për ekonominë e Maqedonisë duke pasur parasysh se ndikimet politike ishin mjaft të pranishme në vend.

Investimet në mjete themelore janë të klasifikuara sipas disa kategorive, edhe atë në bazë të:

- strukturës teknike
- sektorëve institucional
- veprimtarive ekonomike etj.

2.1.1 Analiza strukture e investimeve në mjete themelore sipas strukturës teknike

Të dhënat në lidhje me investimet totale në mjete themelore përfshijnë shumë aspekte që fokusohen në kontributin e dhënë për zhvillimin ekonomik nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor nga viti 2006 deri më 2017. Duke pasur parasysh se këto janë vende në zhvillim, shprehet nevoja për realizimin e më tepër investimeve duke filluar nga sektori i infrastrukturës, punësimit, shëndetësisë e të tjera.

Kur shtrohet pyetja tek ndikimi i investimeve, është me rëndësi të potencohet se sektori i infrastrukturës ndikon në masë të madhe në pjesëmarrjen e PBB-së, por të mos harrojmë se pa makineritë dhe pajisjet e duhura nuk mund të arrihet një standard optimal për të stimuluar prodhimtarinë e cila poashtu është një nga shtytësit kryesor të rritjes ekonomike. Për t'u rimëkëmbur nga kjo gjendje e krizës, e vetmja zgjidhje për ekonominë e vendeve të BP ishte financimi nëpërmjet marrjes së kredive që dha kontribut në përmirësimin e ekonomive.

Për t'u kthyer në ekonominë e Maqedonisë në mënyrë më detajore si dhe për të parë nivelin e investimeve, do të fillojmë nga tabela në vijim e cila paraqet pjesëmarrjen e tri kategorive (objekte ndërtimore, pajisje dhe makineri dhe të ndryshme) të strukturës teknike në investimet totale në Republikën e Maqedonisë nga viti 2006 deri në 2017.

Punët ndërtimore janë një ndër kategoritë më me kontribut në PBB-në e Republikës së Maqedonisë. Të dhënat e marra nga Makstat verifikojnë këtë ku struktura e objekteve ndërtimore paraqitet me rritjen graduale të pjesëmarrjes prej 62% në vitin 2006 e deri në 2016. Duke pasur parasysh që edhe Maqedonia ishte një nga shtetet e prekura nga kriza financiare, vërehet një zvogëlim i investimeve në vitin 2009 në objektet ndërtimore duke u përfaqësuar me 63.186 milion denarë, por që më pas shprehet dukshëm rimëkëmbja çdo vit deri sa në 2016 ka arritur në 92.016 milion denarë dhe me një pjesëmarrje prej 63.4% të investimeve totale. Ajo që mbetet për t'u diskutuar është ulja e pjesëmarrjes së kësaj kategorie të investimeve në vitin 2017, duke pasur parasysh që ndikimet politike ishin të pranishme në vend.

Nga ana tjetër, investimet jo pak të rëndësishme në pajisje dhe makineri përbëjnë mesatarisht rreth 35% të investimeve totale gjatë periudhës së analizuar të cilat poashtu kanë pasur ndryshime të vogla në strukturë nga viti në vit, por që nuk kanë pësuar ndikime të forta në ekonominë e vendit dhe për të mos harruar një pjesë e vogël e përfaqësuar nga kategori të ndryshme që përfaqësohet mesatarisht me më pak se 10%.

Tabela 1. Analiza strukturore e IMTh sipas strukturës teknike (në mil. denarë)

Viti	Punë ndërtimore		Makineri dhe pajisje		Të tjera	
	RM 100%	MKD	%	MKD	%	MKD
2006		41.789	62,1	22.240	33,1	3.219
2007		49.259	58,2	31.739	37,5	3.630
2008		63.186	59,1	39.205	36,7	4.483
2009		61.366	60,3	34.531	33,9	5.923
2010		64.069	63,5	30.899	30,6	5.884
2011		71.048	65,1	32.945	30,2	5.226
2012		70.618	64,7	33.148	30,4	5.305
2013		74.592	62,7	37.531	31,5	6.880
2014		77.164	62,5	38.394	31,1	7.992
2015		85.481	64,1	40.195	30,2	7.578
2016		92.016	63,4	43.772	30,2	9.253
2017		82.536	61,0	43.368	32,0	9.414

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave, dizajnimi i autorit

2.1.2 Analiza dinamike e investimeve në mjete themelore sipas strukturës teknike

Tabela 2. Analiza dinamike e IMTh sipas strukturës teknike (në mil. denarë)

Viti	Punë ndërtimore	↑↓ në %	Makineri dhe pajisje	↑↓ në %	Të tjera	↑↓ në %
2006	41.789	14,8	22.240	16,5	3.219	-0,5
2007	49.259	17,9	31.739	42,7	3.630	12,8
2008	63.186	28,3	39.205	23,5	4.483	23,5
2009	61.366	-2,9	34.531	-11,9	5.923	32,1
2010	64.069	4,4	30.899	-10,5	5.884	-0,7
2011	71.048	10,9	32.945	6,6	5.226	-11,2
2012	70.618	-0,6	33.148	0,6	5.305	1,5
2013	74.592	5,6	37.531	13,2	6.880	29,7
2014	77.164	3,4	38.394	2,3	7.992	16,2
2015	85.481	10,8	40.195	4,7	7.578	-5,2
2016	92.016	7,6	43.772	8,9	9.253	22,1
2017	82.536	-10,3	43.368	-0,9	9.414	1,7

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave, dizajnimi i autorit


Në bazë të përpunimit të të dhënave zyrtare nga Makstat, tabela më lartë prezanton ndryshimet e këtyre kategorive sipas viteve ku më tepër spikat rritja e investimeve në objektet ndërtimore në vitin 2008 për 28.3% (63.186 mil. denarë) për dallim nga viti paraprak ku investimet ishin vetëm 49.259 milion denarë pavarësisht krizës financiare të asaj periudhe. Megjithatë vërehet një zvogëlim i kësaj kategorie në 2009 që njihet si periudha e pas krizës financiare me -2.9% për dallim nga viti paraprak ku njëkohësisht mund të themi se ky ishte viti i zgjerimit të efekteve të krizës. Ndërsa investimet në pajisje dhe makineri në vitin 2008 janë rritur, por me një përqindje më të vogël (23.5%) krahasuar me periudhën paraprake. Njëjtë si investimet në objekte ndërtimore poashtu edhe kjo kategori në vitin 2009 shoqërohet me një ulje prej -11.9%, i cili rezultat ka ndryshuar gradualisht duke treguar efekte pozitive në vitet në vijim dhe duke prekur vlerën prej 43.368 milion denarë në vitin 2017, por që nuk kanë krijuar ndonjë ndryshim të dukshëm në ekonominë e vendit. Nga ana tjetër, për të mos harruar kategoritë e tjera në të cilat investimet janë rritur gradualisht duke dhënë rezultate pozitive nga viti në vit derisa kanë arritur në 9.414 milion denarë në 2017.

Duke parë që ndikimet e mëdha kudo në botë nga kriza financiare kanë qenë me pasoja fatale, është e një rëndësie të veçantë për të analizuar se në çfarë shtate ka kaluar Maqedonia

për të shprehur nivelin e investimeve në mjete themelore sipas strukturës teknike mesatarisht në çdo katër vjet.

Grafikoni në vazhdim paraqet nivelin e lartë të sektorit të punëve ndërtimore si pjesëmarrës kryesor në PBB-në e vendit, që pa marrë parasysh krizës financiare ato shoqërohen me një trend rritës nga 53.900 milion denarë mesatarisht (periudha 2006-2009) në 70.082 milion denarë (periudha 2010-2013) që është për 30% më tepër se periudha paraprake. Ndërsa vlerat më kulminante janë arritur në vitet nga 2014 deri në 2017 me 84.299 milion denarë që është 20% më tepër se periudha paraprake.

Grafiku 3. IMTh sipas strukturës teknike para, gjatë dhe pas krizës financiare (në mil. denarë)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave, dizajnimi i autorit

2.1.3 Analiza strukturore e investimeve në mjete themelore sipas sektorëve institucional

Investimet në bazë të sektorëve institucional përfaqësojnë investimet totale në ekonominë nacionale ku pjesëmarrës janë institucionet financiare dhe jofinanciare, institucionet joprofitabile, qeveria (shteti) dhe familjet.

Bazuar në të dhënat zyrtare nga MakStat pjesa më e madhe e investimeve është realizuar nga institucione jofinanciare e pasuar nga familjet dhe qeveria. Duke parë në këtë aspekt, institucionet jofinanciare përbëjnë rreth 40% (26.814 mil. denarë) të investimeve totale në vitin 2006 duke vazhduar me këtë trend rritës ku në vitin 2016 shënon 51,4% me 73.712 milion denarë.

Gjatë periudhës nga viti 2006 deri 2016, investimet nga familjet vazhdimisht karakterizohen me pjesëmarrje pak më stabile në ekonominë e vendit, por që vlen të përmendet viti 2016 që përfaqësohet me një strukturë prej 23.6%, gjë që nuk shpreh një rezultat edhe aq pozitiv duke marrë parasysh vlerën më të lartë të investimeve totale. Dhe kjo vërehet nga të dhënat në tabelë ku në vitin 2006 janë përfaqësuar me 43.5% të investimeve totale duke ditur që në atë periudhë edhe investimet totale kanë qenë më të ulta ndërsa pjesëmarrja e kësaj kategorie ka rezultuar relativisht mirë. Edhe pse investimet në përgjithësi janë rritur, megjithatë në këtë sektor nuk ka pasur interesim për realizim të projekteve investive.

Ajo që ngelet për t'u diskutuar është niveli i ulët i investimeve nga qeveria mesatarisht 17% të investimeve totale gjatë gjithë kësaj periudhe. Kur bëhet fjalë për qeverinë kemi parasysh edhe nënsektoret që janë pjesë e saj: vetëqeverisja lokale, fondet e sigurimeve sociale dhe pushteti qendror. Në këtë aspekt krijimi i projekteve investive në këto sektore do të ishte më i rëndësishëm si për qytetarët ashtu edhe në dobi të shtetit për të dhënë rezultate pozitive në zhvillimin ekonomik. Ndërkaq një përqindje të vogël të investimeve përbëjnë institucionet financiare dhe ato joprofitabile.

Tabela 3. Analiza strukturore e IMTh sipas sektorëve institucional (në mil. denarë)

Viti	Ins. Jofin.		Ins. Fin.		Shteti		Familjet		Ins. Joprof.	
	MKD	%	MKD	%	MKD	%	MKD	%	MKD	%
2006	26.814	39,9	1.468	2,2	9.556	14,2	29.270	43,5	140	0,2
2007	38.875	45,9	1.620	1,9	11.373	13,4	32.621	38,5	138	0,2
2008	48.098	45,0	3.130	2,9	17.267	16,2	38.292	35,8	86	0,1
2009	49.218	48,3	2.287	2,2	15.896	15,6	34.307	33,7	113	0,1
2010	47.209	46,8	1.890	1,9	17.806	17,7	33.744	33,5	202	0,2
2011	55.043	50,4	1.549	1,4	19.794	18,1	32.672	29,9	161	0,1
2012	53.268	48,8	2.813	2,6	18.183	16,7	34.719	31,8	88	0,1
2013	59.712	50,2	2.602	2,2	20.869	17,5	35.689	30,0	131	0,1
2014	61.422	49,7	1.629	1,3	25.125	20,3	35.260	28,5	114	0,1
2015	68.247	51,2	1.666	1,3	26.739	20,1	36.299	27,2	303	0,2
2016	73.712	51,4	1.775	1,2	32.692	22,8	33.870	23,6	1.447	1,0

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave, dizajnimi i autorit

2.1.4 Analiza dinamike e investimeve ne mjete themelore sipas sektorëve institucional

Tabela në vijim prezanton analizën dinamike të investimeve sipas sektorëve institucional duke marrë parasysh trendin e ndryshimit gjatë viteve, nga 2006 deri në vitin 2016, me qëllim për të nxjerrë të pah nivelin e zhvillimit të tyre si institucione primare që japin efekt në rritjen ekonomike.

Tabela 4. Analiza dinamike e IMTh sipas sektorëve institucional (në mil. denarë)

Viti	Inst. Jofin.		Inst. Fin.		Shteti		Familjet		Inst. Joprofit.	
	MKD	↑↓ në %	MKD	↑↓ në %	MKD	↑↓ në %	MKD	↑↓ në %	MKD	↑↓ në %
2006	26.814	3,8	1.468	30,8	9.556	8,9	29.270	28,0	140	20,7
2007	38.875	45,0	1.620	10,4	11.373	19,0	32.621	11,4	138	-1,4
2008	48.098	23,7	3.130	93,2	17.267	51,8	38.292	17,4	86	-37,7
2009	49.218	2,3	2.287	-26,9	15.896	-7,9	34.307	-10,4	113	31,4
2010	47.209	-4,1	1.890	-17,4	17.806	12,0	33.744	-1,6	202	78,8
2011	55.043	16,6	1.549	-18,0	19.794	11,2	32.672	-3,2	161	-20,3
2012	53.268	-3,2	2.813	81,6	18.183	-8,1	34.719	6,3	88	-45,3
2013	59.712	12,1	2.602	-7,5	20.869	14,8	35.689	2,8	131	48,9
2014	61.422	2,9	1.629	-37,4	25.125	20,4	35.260	-1,2	114	-13,0
2015	68.247	11,1	1.666	2,3	26.739	6,4	36.299	2,9	303	166
2016	73.712	8,0	1.775	6,5	32.692	22,3	33.870	-6,7	1.447	377


Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave, dizajnimi i autorit

Në bazë të tabelës, vërehet që investimet nga institucionet jofinanciare në vitin 2007 janë shoqëruar me një rritje prej 45% për dallim nga viti paraprak, që duke marrë në vlerë absolute konsiderohet një përmirësim i gjendjes prej 11.049 mil. denarë pa marrë parasysh krizën financiare që ishte e pranishme atë periudhë dhe ka vazhduar me të njëjtin ritëm edhe në vitin 2008 duke u rritur me një përqindje më të ulët prej 23.7% (48.098 mil. denarë). Edhe pse në vitin 2009 vlera e investimeve totale është zvogëluar, megjithatë kjo vlerë nuk ka prekur në masë të madhe ekonominë e vendit dhe ashtu siç vërehet institucionet jofinanciare kanë rritur vlerën e përgjithshme të investimeve nga viti në vit.

Gjatë krizës financiare, në vitin 2007 vërehet përmirësim i investimeve në kategorinë e familjes, njëkohësisht edhe tek qeveria dhe institucionet financiare për dallim nga vitet paraprake. Megjithatë, ky fenomen ka filluar të tregojë rezultate negative gjatë periudhës së pas krizës financiare ku edhe është shfaqur në tabelë tek kategoria e familjeve që rezulton me një ulje prej -10.4% në vitin 2009 krahasuar me vitin paraprak. I njëjti rast është edhe me qeverinë që shoqërohet me një zvogëlim prej -7.9%. Në përgjithësi viti 2016 ka shënuar përmirësim të situatës duke dhënë rezultate pozitive në dobi të ekonomisë nacionale.

Vlerësimi ynë në mënyrë direkte paraqet pjesëmarrjen e sektorëve institucional duke filluar nga periudha para krizës financiare, gjatë dhe pas saj. Në këtë aspekt vërehet një nivel i lartë i pjesëmarrjes së institucioneve jofinanciare që përfaqësohen nga kompani private, institucione juridike, institucione të lojrave të fatit e të tjera duke dhënë kontributin më të madh pa marrë parasysh ndikimet e krizës financiare. Nga grafiku vërehet që edhe pas krizës këto investime vazhdojnë me një trend rritës. Përveç kësaj, familjet përfaqësojnë poashtu një pjesë të rëndësishme të investimeve, edhe pse vërehet që gjatë kësaj periudhe nuk kanë pësuar ndryshime të mëdha duke qëndruar në një nivel konstant. Nga ana tjetër, vërehet rritja e investimeve publike në çdo vit duke marrë vlerën 32.692 mil. denarë në periudhën mes vitit 2015 - 2016. Fatkeqësisht, ky nivel i investimeve nga shteti nuk shpreh kontributin e duhur për të rritur nivelin e rritjes ekonomike dhe kjo shkon në dëm edhe të qytetarëve e sidomos kur bëhet fjalë për krijimin e mundësive për vende pune.

Grafiku 4. IMTh sipas sektorëve institucional para, gjatë dhe pas krizës financiare (në mil. denarë)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave, dizajnimi i autorit

2.2 Analiza strukturore dhe dinamike e investimeve të huaja direkte (IHD)

Vendet në zhvillim siç është Maqedonia dhe vende tjera të Ballkanit, kanë nevojë për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe zgjerimin e tregut pasi që përballen me mungesën e resurseve të duhura. Nga ana tjetër edhe investitorët e huaj shfaqin interes për të zgjeruar bizneset e tyre në këto vende duke analizuar që ekzistojnë shumë avantazhe që shkojnë në dobi të tyre. Investimet e huaja direkte i referohen një investimi të një kompanie në një lokacion tjetër të një vendi të huaj duke krijuar një raport afatgjatë në mes dy shteteve si dhe duke investuar jo vetëm në kapital, por edhe në teknologji, kuadro dhe prodhimtari.

Investimet e huaja direkte janë një ndër faktorët më relevant që japin kontribut në ekonominë e një vendi. Roli i tyre është shumë i rëndësishëm në kuptim të hapjes së një perspektive të re për krijimin e industrive të ndryshme që kanë efekt pozitiv mbi rritjen ekonomike në vend në mënyrë të rritjes së eksportit, krijimit të teknologjisë më inovative, rritjen e prodhimtarisë, krijimin e vendeve të reja të punës apo zvogëlimin e normës së papunësisë, ndërsa Maqedonia shpreh më së tepërmi nevojën për zvogëlimin e kësaj norme.


Penetrimi i kompanive multinacionale në tregun e Maqedonisë do të ishte një mundësi e mirë për t'u avancuar në aspekt ekonomik dhe financiar.

2.2.1 Struktura e Investimeve të huaja direkte

Ekzistojnë klasifikime të ndryshme të IHD-ve, megjithatë është e rëndësishme të fokusohemi në investimet e tilla si portfolio investime (afatshkurtra) të cilat përfshijnë: investime në instrumente të borxhit, letra me vlerë etj., dhe investime afatgjata që përfshijnë: blerje ose bashkim, Greenfield, fitime të riinvestuara dhe huatë në mes kompanive.

Struktura e IHD-ve në Maqedoni përbëhet vetëm nga të a.q. investime “blerje ose bashkim” me një kompani ekzistuese në një vend të huaj (d.m.th. blerje e aksioneve të një kompanie rezidente) dhe investimet “Greenfield” të cilat i referohen krijimit të një veprimtarie krejtësisht të re në një shtet të huaj. Mbase investimet me blerje ose bashkim janë më të favorshme për shkak të rrezikut më të ulët në aspektin e blerjes së një kompanie në vend që të ndërtojnë objekte të reja për një veprimtari të re nga fillimi duke pasur parasysh edhe formimin e një kuadri të ri. I njëjti rast ndodh në vendin tonë ku investimet blerje ose bashkim përfaqësojnë një pjesëmarrje më të madhe krahasuar me ato Greenfield ashtu siç e prezanton grafiku në vijim ku duhet përmendur se këto investime janë më të favorizuara nga shoqëritë multinacionale.

Grafiku 5. Struktura e Investimeve të huaja direkte dhe portfolio investimeve (në mrd. euro)




Burimi: BQRM, dizajnimi i autorit

Duke parë rëndësinë e IHD-ve në ekonominë e vendit, vërehet një pjesëmarrje më e lartë e investimeve “blerje dhe bashkim” të cilat janë vazhdimisht në rritje duke filluar nga viti 2006 që kanë marrë pjesë me 1.158.747.766 euro e deri në vitin 2017 me 2.112.920.358 euro me një rritje kumulative prej 65%. Nga ana tjetër vërehet një pjesëmarrje më e ulët e investimeve Greenfield duke filluar nga viti 2006 me 791.090.467 euro e për të arritur në 1.330.235.439 euro në vitin 2017 që rezulton me një rritje kumulative nga viti në vit me 57%.

2.2.2 Investimet e huaja direkte dhe pjesëmarrja e tyre në PBB

Duke vlerësuar në këtë aspekt, përveç strukturës së IHD-ve në këtë pjesë është me rëndësi të fokusohemi në trendin e tyre duke paraqitur në mënyrë grafike se si kanë ndryshuar ato nga viti 2006 deri në vitin 2017 dhe pjesëmarrjen e tyre në PBB duke përfshirë vlerën totale në çdo vit.

Grafiku 6. IHD dhe pjesëmarrja e tyre në PBB



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave, dizajnimi i autorit

Duke marrë të dhënat nga BQRM, mund të konstatojmë se IHD shoqërohen me një ndryshim në aspekt pozitiv në vitin 2007 duke u rritur në 506.9 milion euro ku më pas kjo vlerë bie në 409.4 milion euro që si zakonisht ka qenë rezultat i krizës financiare, e cila vlerë ka vazhduar të shfaq rezultate negative pas krizës ku në vitin 2010 është zvogëluar në 156.9 milion euro. Pavarësisht kësaj, viti 2011 ka treguar rezultate të favorshme duke arritur në 344.6 milion euro që është për 120% më tepër se sa në vitin paraprak. Megjithatë kjo vlerë nuk do të thotë që këto investime kanë qenë të mjaftueshme pasi që interesimi i investitorëve të huaj ka qenë shumë i ulët e veçanërisht gjatë vitit 2013 ku çështjet politike dhe problemet ekonomike në Maqedoni ishin problem kryesor dhe temë diskutimi gjë që e pamundëson zhvillimin e klimës së biznes investimeve. Ashtu siç vërehet nga grafiku në vitin 2017 kjo vlerë ka rënë në 180 milion euro dhe gjatë tërë kësaj periudhe në përgjithësi nuk shfaqet një tendencë stabile.

Varësisht nivelit të investimeve të huaja direkte paraqitet edhe pjesëmarrja e tyre në PBB që karakterizohet me një trend rënës nga 8,4% në vitin 2007 në 4,5% në vitin 2011 që ishte periudha pas krizës financiare, e cila ishte e pashmangshme qoftë edhe nga kompanitë multinacionale. Megjithatë, në vitet e fundit IHD u përballuan me një ulje drastike ku edhe

pjesëmarrja e tyre në PBB në vitin 2017 përbënte vetëm 1,8% që është shumë larg nga niveli i vendeve tjera të Ballkanit Perëndimor.

Një sistem politik i qëndrueshëm vlerësohet shumë më tepër nga investorët e huaj pasi që nënkuptohet se pas kësaj krijohet edhe një sistem poashtu i qëndrueshëm financiar dhe ekonomik. Ndërsa një ndër çështjet më shqetësuese në Maqedoni janë pikërisht sistemi politik, marrëdhëniet me BE-në si dhe vendet fqinje, niveli i lartë i korrupsionit etj. Ndërmarrja e masave për përmirësimin e kësaj situate besoj që do të krijojë një frymë tjetër e cila do të mundësojë shmangien e këtyre aspekteve negative dhe mbajtjen në nivel të disa fenomeneve që investorët e huaj i vlerësojnë më tepër si: inflacioni, likuiditeti, stabiliteti i valutës kombëtare e të tjera.

2.3 Analiza e pjesëmarrjes së veprimtarive ekonomike në PBB

Klasifikimi i investimeve në bazë të veprimtarive ekonomike është realizuar në përputhje me ligjet dhe vendimet e qeverisë së Republikës së Maqedonisë me qëllim shfaqjen e të dhënave që do të japin një kuptim mbi nivelin e zhvillimit ekonomik. Përndryshe, ky klasifikim është bazuar nga Sistemi i Klasifikimit të Veprimtarive Ekonomike (Nace – Rev. 2) për qëllime të ndryshme të entiteteve ekonomike⁷.

Kjo mënyrë e integritit të të dhënave statistikore bëhet më e qartë qoftë për personat fizik apo ato juridik për të parë më saktë strukturën e komponentëve që ndikojnë në PBB apo në një mënyrë më të përshtatshme të nxjerr në pah se si janë të shpërndara ato dhe me sa përqind marrin pjesë në rritjen ekonomike gjë që krijon dobishmëri për pjesëmarrësit.

Duke analizuar veprimtaritë ekonomike të Maqedonisë, vërehet një strukturë e shpërndarë që marrin pjesë në PBB gjithmonë duke krijuar një vlerë të re shtesë të tyre që kontribuon në PBB. Pjesëmarrja e aktivitetit të bujqësisë ka rezultuar me 9% në vitin 2006 para krizës dhe më pas ka pësuar rritje në vitin 2008 me 11.4% duke vazhduar me këtë trend edhe viteve në vazhdim duke arritur në 9.2% në vitin 2016. Nga ana tjetër industria si një pjesë

⁷ Komisioni Evropian

<https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3859598/5902521/KS-RA-07-015-EN.PDF>

e rëndësishme që krijon produktivitet në një ekonomi nacionale, merr pjesë në PBB me vetëm 10.8% në vitin 2006 duke pësuar zvogëlim në 9.7% në vitin 2009 që ishte edhe periudha e efektit të krizës financiare. Megjithatë vërehet një ngritje e këtij niveli në 13.3% të PBB-së në vitin 2016, gjë që jep rezultatin më të mirë deri më tani krahasuar me tërë periudhën që kemi analizuar.

Duke analizuar një aktivitet tjetër, vërehet një pjesëmarrje e madhe e aktivitetit të shërbimeve duke potencuar tregtinë me shumicë dhe pakicë ku këtu përfshihen edhe riparimet e automjeteve, transporti dhe magazinimi, objekte për akomodim si dhe aktivitete tjera të shërbimeve dhe ushqimit. Prandaj edhe pjesëmarrja e tyre është më e lartë krahasuar me bujqësinë dhe industrinë si dy komponenta më kryesore që ndikojnë në PBB. Në këtë rast vërehet një pjesëmarrje prej 17.4% në vitin 2006 duke pësuar ekspansion gjatë viteve në vazhdim dhe për t'u ngjitur në 19% të PBB-së në vend në vitin 2016.

Rezultatet nga kjo tabelë shfaqin tre kategoritë më të rëndësishme që japin kontribut në rritjen ekonomike e duke filluar me tregtinë me shumicë dhe pakicë që kryeson. Pas saj rangohet industria dhe bujqësia. Këto tri kategori konsiderohen si më të rëndësishme të cilat japin një vlerësim pozitiv i cili shërben për përmirësimin e rritjes ekonomike në të ardhmen e ekonomisë së RM-së. Bazuar në këtë shpjegim rritja e nivelit të industrisë në PBB krijon një qasje se është arritur të bëhet pjesë e rëndësishme e zhvillimeve ekonomike të vendit duke lënë për tu kuptuar se investimet në këtë pjesë krijojnë një trend rritës, hapen fabrika të reja në prodhimtari, gjë që krijohen edhe vende të reja pune dhe perspektiva më të mira për standardin e jetesës. Përveç kësaj, duhet përmendur se Maqedonia si një vend në zhvillim ka mungesë të eksporteve, ndërkaj ajo importon një pjesë shumë të madhe të prodhimeve nga vendet tjera. Ndërkaj rritja e pjesëmarrjes së industrisë do të hapë edhe mundësi tjera të rritjes së eksporteve.

Tabela 5. Pjesëmarrja e veprimtarive ekonomike (si vlerë shtesë) si % në PBB

Veprimtari ⁸	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Bujqësia ¹	9,0	8,9	11,4	10,4	10,1	9,4	9,1	10	10,2	9,7	9,2
Industria ²	10,8	11	10,6	9,7	11,3	12,7	11,6	11,3	12,3	13,1	13,3
Ndërtimtari	6,9	5,9	5,6	5,6	5,6	5,2	5,7	7,1	6,9	7,1	6,9
Tregti me shumicë/pakicë	17	15,9	14,9	16,1	15,6	17,1	16,7	18,4	18,2	18,4	19
Info. dhe komunikim	3,7	3,8	3,8	3,6	3,7	3,4	3,5	3,2	3	2,9	3,1
Aktivitete financiare/sigurime	2,7	2,9	2,6	2,6	2,2	2,4	2,9	2,8	2,9	3	3
Aktivitete - pasuri të patundshme	13	14	13	12,6	12,9	12,2	12,8	12	11,4	11	10
Aktivitete profesionale ³	1,6	2,3	2,8	3	3,1	3,1	3,2	3,2	3,2	3,2	3,4
Adm. Publike ⁴	7,0	7,3	7,5	8,1	7,7	7,8	8	5,8	5,5	5,5	5,5
Edukim	3,5	3,1	3,3	3,7	3,7	3,7	3,8	3,6	3,3	3,3	3,2
Mbrojtje shëndetësore	3,8	4,2	3,4	3,6	3,5	2,8	3,0	3,5	3,6	3,6	3,7
Art, argëtim, rekreacion	3,5	3,4	3,7	3,9	2,7	2,5	2,3	2,4	2,7	2,7	2,7

Burimi: Makstat, dizajnimi i autorit

⁸ Sqarim:

1. Bujqësia: pylltaria dhe peshkataria

2. Industria: minierat dhe guroret (industria e rëndë) dhe industria e qeramikave të lëmuar, industria e qelqit, industria përpunimit të drurit e letrës, industria e kartonëve, shtypshkronjat, përpunimi i lëkurës, industria e këpucëve dhe tekstileve (industria e lehtë)

3. Aktivitete profesionale: aktivitete shkencore dhe teknike

4. Administrata publike: mbrojtja dhe sigurimi social i detyrueshëm

2.3.1 Analiza strukturore e IMTh sipas veprimtarive ekonomike

Kur vërejmë nga një klasifikim tjetër, në vijim do të shfaqim investimet e realizuara në bazë të veprimtarive ekonomike duke i paraqitur ato në vlera absolute dhe duke treguar pjesëmarrjen e tyre në investimet totale si kategoritë më esenciale në të cilat janë realizuar një pjesë e madhe e investimeve.

Tabela 6. Analiza strukturore e IMTh sipas veprimtarive ekonomike (në mil. denarë)⁹

Viti	Bujqësia ¹		Industria ²		Ndërtimtari		Tregtia me shumicë dhe pakicë ³		Adm. publike dhe mbrojtja ⁴		Të tjera ⁵	
100%	MKD	%	MKD	%	MKD	%	MKD	%	MKD	%	MKD	%
2006	2.004	3	13.806	21	25.230	37,5	10.554	15,7	7.734	11,5	6.655	9,9
2007	1.957	2	21.048	25	28.794	34	11.916	14,1	8.660	10,2	10.165	12
2008	2.454	2	27.315	26	34.614	32,4	12.353	11,6	13.557	12,7	11.098	10,4
2009	3.031	3	25.443	25	34.637	34	13.524	13,3	14.999	14,7	7.529	7,4
2010	2.352	2	25.142	25	33.988	33,7	14.043	13,9	17.466	17,3	6.577	6,5
2011	2.104	2	23.613	22	31.620	29	21.219	19,4	19.593	17,9	7.493	6,9
2012	2.293	2	28.229	26	31.266	28,	13.777	12,6	17.802	16,3	9.227	8,5
2013	3.034	3	29.661	25	32.840	27,6	16.890	14,2	18.369	15,4	10.318	8,7
2014	3.431	3	26.756	22	44.846	36,3	16.944	13,7	18.166	14,7	8.571	6,9
2015	3.852	2,9	30.741	23,1	43.865	32,9	20.209	15,2	20.101	15,1	8.248	6,2
2016	3.397	2,3	30.515	21,0	46.921	32,4	22.394	15,4	22.252	15,3	9.357	6,5%
2017	2.676	2	30.272	22,4	43.368	32	23.233	17,2	18.525	13,7	9.811	7,3%

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave, dizajnimi i autorit

Duke parë në këtë këndvështrim kategoria e investimeve në ndërtimtari është kategoria më e përfaqësuar ku në vitin 2007 ka arritur në 28.794 milion denarë me 34% të investimeve në mjete themelore, e cila vlerë është rritur gradualisht çdo vit ku në vitin 2017 ka arritur në 43.368 milion denarë dhe që përfaqësohet me 32% të investimeve.

⁹ Sqarim:

1. Bujqësia: pylltaria dhe peshkataria

2. Industria: industria e lehtë, industria e rëndë (miniera, xehe) furnizimi me energji elektrike, ujë, gaz dhe ajër të kondicionuar; largimi i ujrave të ndotur; menaxhimi i mbeturinave dhe aktivitete tjera.

3. Tregtia me shumicë dhe pakicë: riparim i automjeteve dhe motoçikletave; transport dhe magazinim; objekte për akomodim; aktivitete të shërbimit dhe ushqimit.

4. Administrata publike dhe mbrojtja: sigurimi i detyrueshëm social; arsimit; mbrojtja shëndetësore dhe sociale.

5. Të tjera: informacion dhe komunikim; aktivitete të sigurimit dhe financiare; aktivitete të pasurive të patundshme; aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike; art, argëtim dhe rekreacion.

Nga ana tjetër, pason kategoria e industrisë e cila përfshin kryesisht minierat dhe guroret ku në vitin 2007 shoqërohet me 21.048 milion denarë që është 24.9% e IMTH. Investimet në këtë kategori janë rritur vazhdimisht deri sa në vitin 2017 kanë arritur në 30.272 milion denarë duke përbërë 22.4%. Kjo kategori është ndjekur më pas nga investimet në administratë publike dhe mbrojtje, vlera e të cilës në vitin 2007 shënon 8.660 milion denarë dhe vazhdimisht është shoqëruar me rritje në vitin 2011 me 19.593 milion denarë ndërsa në vitin 2017 me 18.525 milion denarë që mesatarisht përfaqësohet me 16% të investimeve. Kjo pasqyrë shfaq edhe rritjen e shpejtë të investimeve në këtë sektor brenda një periudhe 10 vjeçare.

Supozohet që kategoritë e paraqitura më lartë të rezultojnë më të rëndësishme në aspekt të realizimit të investimeve, por çfarë ndodh me kategoritë tjera si arsimi apo çështjet sociale dhe shëndetësore të cilat krijojnë pengesa në zhvillimin e mëtejshëm ekonomik në qoftë se nuk jepet kontributi i duhur?!

Të dhënat zyrtare shfaqin një përqindje shumë të ulët në këto dy kategori, të cilat duhet të shqyrtohen më tepër nga ana e institucioneve publike që do të ishte në dobi të shumë qytetarëve në vend dhe sigurisht kjo dukuri do të stimulonte edhe më tepër nivelin e rritjes ekonomike dhe standardit jetësor.


2.3.1.1 Analiza e pjesëmarrjes së investimeve sipas veprimtarive ekonomike gjatë periudhës 2006 – 2017

Duke analizuar gjithë këtë periudhë për të mos harruar fillimi i krizës financiare gjatë viteve 2007-2008 e deri në vitet e fundit 2016-2017, Maqedonia ka kaluar nëpër shumë sfida të natyrës politike, ekonomike dhe sociale të cilat kanë ndikuar në mënyrë të përkeqësimit të situatës e cila vazhdon të jetë shqetësuese edhe aktualisht.

Megjithatë, qëllimi kryesor është të shfaqim pjesëmarrjen e të gjithë veprimtarive ekonomike në totalin e investimeve në mjete themelore gjatë kësaj periudhe duke u ndaluar tek kategoria e ndërtimtarisë si e tillë me okupimin e një përqindje të madhe të investimeve dhe potencialin më të madh për të krijuar mundësi më të favorshme në implementimin e projekteve të reja në të ardhmen e ekonomisë së vendit. Kur bëhet fjalë për ndërtimtarinë, kemi parasysh çdo aspekt të planifikimit, projektimit, mirëmbajtjes dhe operimit me infrastrukturën për të arritur një ambient më të mirë publik dhe shëndetësor në vend.

Spektori i ndërtimtarisë ashtu siç vërehet nga tabela e shprehur në grafikonin në vijim ka një peshë më të madhe në investimet e realizuara në Maqedoni me rreth 34% gjatë kësaj periudhe 12 vjeçare, i ndjekur nga kategoria e minierave dhe gurorëve me 25%, administrata publike dhe tregtia me shumicë dhe pakicë me nga 15% e të tjera. Edhe pse sektori i bujqësisë shihet si një kategori e rëndësishme dhe e zhvilluar, vërehet një pjesëmarrje shumë e ulët me 3%, ndërkaj Maqedonia është një ndër ato vende të Ballkanit Perëndimor përveç Shqipërisë dhe Kosovës që njihen në zhvillimin e këtij aktiviteti si më prioritar nga të tjerët. Është qeveria ajo që duhet të jep mbështetje në subvencionimin e këtyre aktiviteteve për të përmirësuar zhvillimin dhe avancimin e këtij sektori. Kjo do të rrisë edhe më tepër mundësinë për rritjen e tregtisë në vend dhe njëkohësisht niveli i investimeve do të përmirësohet në vitet në vazhdim.

Grafiku 7. Pjesëmarrja e investimeve si % sipas veprimtarive ekonomike (2006 - 2017)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave, dizajnimi i autorit

2.3.2 Analiza dinamike e IMTh sipas veprimtarive ekonomike

Rëndësia e veprimtarive ekonomike në ndikimin e rritjes ekonomike është e një niveli shumë të lartë kur bëhet fjalë për realizimin e investimeve në një ekonomi të vogël si Maqedonia. Prandaj në këtë pjesë objektivi kryesor është të fokusohemi në dinamikën e veprimtarive duke potencuar ato me një pjesëmarrje më të lartë. Kjo mënyrë tjetër e vlerësimit të investimeve është paraqitur në tabelën në vijim për tu ndalur tek ndryshimi i investimeve në veprimtaritë ekonomike gjatë viteve 2006 deri në 2017 duke lënë për t'u diskutuar rritja e të gjitha kategorive në vitin 2007 krahasuar me vitin paraprak. Përveç kësaj, në vitin 2012 vërehet një përkeqësim i investimeve në kategorinë e tregtisë me shumicë dhe pakicë për dallim nga viti 2011 me -35% gjë që ndikon në ekonominë e vendit duke pasur parasysh se është një ndër kategoritë më të rëndësishme nga e cila varet rritja ekonomike ku eksporti dhe importi janë pjesë kryesore e saj, rezultatet e të cilëve nuk kanë dhënë efektin e duhur. Megjithatë, viti 2013 ka shënuar vlera pozitive të cilat kanë vazhduar edhe në vitet pasuese.

Nga ana tjetër për të mos harruar kategorinë më frekuentuese – ndërtimin e cila është shfaqur me rezultate relativisht të favorshme nga viti në vit ku kulminacionin e zhvillimit e ka pasur në vitin 2014 që krahasuar me vitin paraprak, është përmirësuar me 36.6%. Analizuar në këtë këndvështrim në këtë kategori, viti 2011 është periudha kur zhvillohej projekti “Shkupi 2014” dhe sipas kësaj vlera e investimeve duhet të shfaq rezultate më pozitive në dobi të nivelit të rritjes ekonomike për dallim nga viti 2010. Përkundrazi, të dhënat tregojnë se investimet kanë pësuar ulje për 7%. Edhe pse këtu vlerat përfshijnë edhe sektorin publik edhe atë privat, por kontributi i institucioneve publike realisht duhet të jep shifra më të mëdha duke pasur parasysh rëndësinë e tyre në nivel makroekonomik.

Tabela 7. Analiza dinamike e IMTh sipas veprimtarive ekonomike (në mil. denarë)¹⁰

Viti	Bujqësi ¹		Industr ²		Ndërtimtari		Tregtia me shumicë pakicë ³		Adm. publike dhe mbrojtja ⁴		Të tjera ⁵	
	MKD	↑↓ në%	MKD	↑↓ në%	MKD	↑↓ në %	MKD	↑↓ në %	MKD	↑↓ në %	MKD	↑↓ në %
2006	2.004	26	13.806	12	25.230	24	10.554	16	7.734	-11	6.655	-2,4
2007	1.957	-2,3	21.048	52	28.794	14	11.916	13	8.660	12	10.165	52,7
2008	2.454	25	27.315	30	34.614	20	12.353	3,7	13.557	56	11.098	9,2
2009	3.031	23	25.443	-6,9	34.637	0,1	13.524	9,5	14.999	11	7.529	-32,2
2010	2.352	-22	25.142	-1,2	33.988	-1,9	14.043	3,8	17.466	16,4	6.577	-12,6
2011	2.104	-11	23.613	-6,1	31.620	-7	21.219	51	19.593	12	7.493	13,9
2012	2.293	9	28.229	19,5	31.266	-1	13.777	-35	17.802	-9,1	9.227	23,1
2013	3.034	32	29.661	5,1	32.840	5	16.890	22,6	18.369	3,2	10.318	11,8
2014	3.431	13	26.756	-9,8	44.846	36,6	16.944	0,3	18.166	-1,1	8.571	-16,9
2015	3.852	12	30.741	15	43.865	-2,2	20.209	19	20.101	10,7	8.248	-3,8
2016	3.397	-12	30.515	-0,7	46.921	7,0	22.394	10,8	22.252	10,7	9.357	13,4
2017	2.676	-21	30.272	-0,8	43.368	-7,6	23.233	3,7	18.525	-16,7	9.811	4,9

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave, dizajnimi i autorit

¹⁰ Sqarim:

1. Bujqësia: pylltaria dhe peshkataria

2. Industria: industria e lehtë, industria e rëndë (miniera, xehe) furnizimi me energji elektrike, ujë, gaz dhe ajër të kondicionuar; largimi i ujrave të ndotur; menaxhimi i mbeturinave dhe aktivitete tjera.

3. Tregtia me shumicë dhe pakicë: riparim i automjeteve dhe motoçikletave; transport dhe magazinim; objekte për akomodim; aktivitete të shërbimit dhe ushqimit.

4. Administrat publike dhe mbrojtja: sigurimi i detyrueshëm social; arsimi; mbrojtja shëndetësore dhe sociale.

5. Të tjera: informacion dhe komunikim; aktivitete të sigurimit dhe financiare; aktivitete të pasurive të patundshme; aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike; art, argëtim dhe rekreacion.


2.4 Analiza e investimeve bruto dhe pjesëmarrja e tyre në PBB

Bruto investimet janë një komponent shumë i rëndësishëm në krijimin e PBB-së duke determinuar gjendjen financiare të një vendi në aspekt makroekonomik apo në atë mikroekonomik kur bëhet fjalë për bilancin e bizneseve. Ato formohen nga burime të ndryshme duke përfshirë amortizimin e kapitalit fiks, produktin kombëtar si dhe të hyrat nga investimet e huaja. Veçoria e tyre qëndron në përfshirjen e shumës së amortizimit të kapitalit me investimet neto. Në qoftë se vlera e amortizimit nuk investohet, por, përkundrazi shpenzohet, atëherë ekziston një gjendje ku investimet arrijnë në zero që do të thotë se do të ndalohej tërësisht procesi i investimit dhe nuk do të kishte zëvendësim të fondeve të shpenzuara kapitale. Kjo gjendje do të detyronte ekonominë e vendit që të ngelet në një periudhë stagnacioni¹¹.

Në mënyrë që të shprehim nivelin e investimeve bruto në Maqedoni na shërben grafikoni në vazhdim duke marrë të dhënat nga Enti Shetëror i Statistikave dhe nga BQRM duke filluar prej vitit 2006 deri në 2017 që përfshin edhe të dhënat gjatë krizës financiare dhe pas saj deri në gjendjen aktuale ku shqetësimet politike dhe sociale kanë qenë pjesë e pashmangshme e ekonomisë nacionale dhe vazhdojnë akoma të reflektojnë në të. Krahës kësaj, do të shohim në qoftë se të dhënat zyrtare nxjerrin në pah vërtetësinë e situatës ekonomike dhe lidhjen me PBB-në. Teoretikisht raporti mes këtyre dy variablave është pozitiv që dm.th. në qoftë se investimet bruto rriten, sigurisht që edhe PBB-ja do të ketë një trend rritës.

¹¹ Shkëputur nga: Metodija Nestorovski: "Ekonomija na investiciite", Ekonomski Fakultet, Skopje, 2005, fq.34.

Grafiku 8. Relacioni në mes bruto investimeve dhe PBB



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave, dizajnimi i autorit


Duke parë në këtë aspekt, paraqitja grafike shpreh nivelin e investimeve bruto duke dhënë një trend rritës nga viti 2006 me 68.809 milion denarë, që shoqërohet me një rritje kumulative prej rreth 53% deri në vitin 2008 duke bërë një përjashtim në vitin 2009 për pasojë të krizës financiare. Por, në çdo vit ka dhënë rezultate pozitive duke arritur në 203.352 milion denarë në vitin 2017. Përpos kësaj, njëkohësisht vërehet rritja e vlerës së PBB-së gradualisht nga viti 2006 me 334.840 milion denarë duke pësuar rritje edhe pas krizës financiare me 437.296 milion denarë në vitin 2011. Ndërkaq, në vitin 2017 ka arritur në një situatë më të favorshme duke rritur vlerën në 616.600 milion denarë. Vërtetuar në këtë aspekt, rritja e investimeve bruto shpjen në rritjen e PBB-së që patjetër se krijojnë një bindje pozitive rreth rritjes ekonomike, pasi që PBB-ja është elementi kryesor që kontribuon në të nëpërmjet shumë faktorëve ekonomik, por edhe nëpërmjet investimeve si pjesë e atyre faktorëve.

Meqë përmendëm rëndësinë e investimeve në PBB, ekziston një mundësi për të parë se sa marrin pjesë këto investime në krijimin e PBB-së së vendit dhe këtë e prezanton paraqitja grafike në vijim nëpërmjet përpunimit të të dhënave të marra nga Enti shtetëror i statistikave dhe BQRM-së.

2.4.1 Pjesëmarrja e bruto investimeve në PBB

Bruto investimet si faktor i rëndësishëm në ekonominë e vendit, kontribuojnë në rritjen e PBB-së duke parashikuar një vlerësim se në çfarë drejtimi mund të shkojë rritja ekonomike qoftë në një aspekt pozitiv apo negativ.

Grafiku 9. Pjesëmarrja e bruto investimeve në PBB



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave, dizajnimi i autorit

Nga ky këndvështrim vërehet pjesëmarrja e investimeve në PBB-në e vendit duke arritur në vitin 2017 të ngjitet në 33% të saj që tregon një përqindje mjaft të favorshme përkundër zhvillimit ekonomik të vendit. Përveç kësaj, duke krahasuar me standardet evropiane, kjo gjendje jep një rezultat të mirë vlerësuar. Ajo që vlen të përmendet se në vitin 2006 ka qenë 20.5% dhe kjo tregon një përmirësim të dukshëm brenda kësaj periudhe nga viti 2006 në vitin 2017. Ndërsa vërehet që gjatë periudhës së krizës financiare PBB-ja nuk ka pësuar ndryshime të mëdha në kuptimin e ndikimit të investimeve dhe pa marrë parasysh këtë, gjatë vitit 2009 pjesëmarrja e tyre ka qenë 26% duke kaluar në një drejtim të rritjes.

KREU 3 - Efikasiteti i investimeve në Republikën e Maqedonisë dhe vendet e Ballkanit Perëndimor

3.1 Përcaktimi i variablave

Nevoja për investime të vazhdueshme në të ardhmen është një hap kryesor të cilin çdo qeveri e sheh nga një pikëpamje krejtësisht të ndryshme e cila mundëson avancim të ekonomisë nacionale. Megjithatë mungesa e resurseve është një problem i gjithëmbarshtëm për çdo ekonomi, ndërsa nga ana tjetër alokimi i duhur i tyre mund të kontribuojë në mënyrë pozitive duke vendosur disa kufizime me qëllim realizimin e investimeve optimale. Kjo është shumë me rëndësi në mënyrë të veçantë për vendet më të varfëra. Prandaj, në këtë hulumtim do të vendosim disa qasje të cilat për t'i kuptuar, është e nevojshme të kalojmë nëpër disa faza derisa të arrijmë në rezultatin përfundimtar.

Në bazë të analizave empirike të analizuar në kreun paraprak në lidhje me strukturën e investimeve dhe relacionin me PBB-në në Maqedoni, është e një rëndësie të veçantë të hulumtojmë nivelin e efikasitetit të tyre, por, duke bërë një krahasim me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor si: Shqipëria, Kosova, Serbia, Mali i Zi, Bosnia dhe Hercegovina dhe Kroacia. Përveç kësaj, kontributi më i madh në këtë hulumtim do të jetë pikërisht zbulimi i efikasitetit të investimeve në këto vende nëpërmjet variablave kryesor që do të hulumtohen të cilat janë bruto investimet dhe PBB-ja, duke marrë parasysh analizat dhe të dhënat gjatë periudhës 2006 – 2017. Më pas këto rezultate do të aplikohen në një prezantim përfundimtar si pjesë e studimit të realizuar me ndihmën e dy variablave kryesore që përmendëm.

Për të realizuar këtë hulumtim është i nevojshëm koeficienti kyç që mat efikasitetin e investimeve - koeficienti inkremental i kapitalit. Në mënyrë teorike ky koeficient ka për qëllim të shpreh nevojën e investimeve për të dhënë një produkt përfundimtar optimal (PBB) i cili do të krijojë një impakt pozitiv mbi rritjen ekonomike të një vendi dhe do të zbulojë nivelin e efikasitetit të investimeve. Për tu realizuar ky hulumtim, është e nevojshme që përmes dy variablave kryesor të krijojmë një rezultat të konstatuar sipas të dhënave në dispozicion i cili

do të pranojë apo hedh poshtë hipotezat e parashtruara në fillim të këtij studimi duke u bazuar në metodat sasiore dhe cilësore.

3.2 Burimet e të dhënave

Në këtë pjesë do të shtjellojmë variablat e përcaktuara në bazë të të dhënave të huazuara nga Banka Botërore për vendet fqinje si dhe nga Banka Qendrore e RM-së për të dhënat që kanë të bëjnë me faktorët ekonomikë lidhur me Maqedoninë. Përveç kësaj, të dhënat zyrtare do t'i marrim parasysh në valutën devizore – euro duke e parë të arsyeshme se do të jetë më e kapshme për palët e interesuara që të kenë një qasje më të thjeshtë rreth këtij studimi. Krahas kësaj, duhet të kemi parasysh që çdo variabël që analizohet i përket standardeve të vendeve në zhvillim, të cilat dallojnë nga vendet evropiane. Për këtë qëllim do të krijojmë një qasje më ndryshe e cila na lejon të realizojmë një analizë krahasimore me vendet më të përafërta për nga aspekti i zhvillimit ekonomik duke mos harruar që të gjitha kanë qenë pjesë e Ish Republikës Jugosllave.

Përmes gjetjeve dhe rezultateve që do të nxjerrim, do të na jepet një ndihmesë për të dhënë një performancë të suksesshme nga mbledhja dhe përpunimi i të dhënave. Nga ato gjetje do të jemi në gjendje të vërtetojmë hipotezat e paracaktuara të cilat njëherit krijojnë kuptimin e tërë këtij studimi.

3.3 ICOR për Republikën e Maqedonisë

Duke analizuar lidhjen që kanë investimet me rritjen ekonomike, është me rëndësi të potencojmë sa këto investime janë efikase ndaj produktit të brendshëm bruto, nëpërmjet të cilit vlerësojmë ndikimin që japin investimet në ekonominë e përgjithshme të vendit dhe aspekte të tjera që do të japin efekte për të ardhmen. Andaj, në vijim do të fokusohemi në treguesin kyç të efikasitetit të investimeve për Maqedoninë dhe vendet fqinje që janë pjesë e Ballkanit Perëndimor me qëllim që të arrijmë të krahasojmë rezultatet finale dhe të nxjerrim në pah se cili nga këto shtete karakterizohet me një zhvillim më të përshtatshëm ekonomik i cili rezulton nga efikasiteti i investimeve.

ICOR si një matës special i investimeve, ka për qëllim të shpjegojë nivelin e investimeve të nevojshme për të dhënë një produkt të brendshëm bruto efektiv. Prandaj, teoria e këtij matësi sqaron se efikasiteti arrihet në momentin kur ndodh që sa më pak investim të jetë i nevojshëm për një njësi outputi. Kjo do të thotë se një ICOR më e ulët do të jep rezultate më pozitive.

Bazuar në modelin e Harrod - Domar kursimet dhe investimet si dy komponentë ekonomike janë përcaktuesit kryesor të rritjes ekonomike. Sipas tij, kjo e fundit varet nga: niveli i kursimeve (S) dhe produktiviteti i investimeve kapitale të cilën e përcakton koeficienti inkremental i kapitalit (ICOR). Në qoftë se G (rritja ekonomike) = s (kursimet)/ k (ICOR), atëherë sa më e ulët të jetë k aq më e lartë rezulton G ¹². Këtu edhe shprehet vlerësimi i ICOR si një komponentë për marrjen e vendimeve në lidhje me investimet që të arrihet deri te një rritje ekonomike e shëndoshë.


Në shumë vende në zhvillim është vërtetuar se kjo normë e ulët e rritjes ekonomike shoqërohet me normë të ulët të kursimit. Nga kjo, konstatohet edhe niveli i ulët i investimeve, i prodhimit dhe kursimit. Prandaj, kjo e bën të veçantë këtë model duke paraqitur një cikël që ripërsëritet proces pas procesi duke filluar nga rritja e kursimeve e cila shpien në rritjen e

¹² Economics Help - Tejvan Pettinger

<https://www.economicshelp.org/blog/498/economics/harod-domar-model-of-growth-and-its-limitations/>

investimeve për të vazhduar nëpërmjet një rrethi vicioz deri sa të arrihet rritja ekonomike e favorshme për vendin.

Figura 1. Rrethi vicioz i modelit Harrod - Domar



Burimi: EconomicsHelp

Duke marrë të dhënat nga Banka Botërore për PBB-në dhe bruto investimet, kemi bërë përlllogaritjen e koeficientit inkremental të kapitalit i cili do të shfaq efikasitetin e investimeve në rritjen ekonomike në Maqedoni. Nga këto gjetje dhe përlllogaritje do të konstatojmë nivelin e efikasitetit në vend dhe si kjo do të ndikojë në nivelin e rritjes ekonomike.

Tabela 8. ICOR për Maqedoninë

Viti	PBB (euro)	Δ PBB	IB (euro)	ICOR
2006	5.469.361.631	436.695.625	1.170.888.334	2,33
2007	6.090.947.717	621.586.086	1.444.311.010	1,88
2008	6.765.000.961	674.053.245	1.889.647.765	2,10
2009	6.767.770.605	2.769.644	1.742.192.232	-300,96
2010	7.102.835.693	335.065.088	1.737.944.816	4,71
2011	7.549.366.505	446.530.813	2.031.754.857	3,94
2012	7.584.670.480	35.303.974	2.194.014.756	47,68
2013	8.147.457.257	562.786.777	2.347.107.161	3,84
2014	8.564.097.268	416.640.012	2.594.512.559	5,62
2015	9.063.168.948	499.071.679	2.759.051.765	5,29
2016	9.714.567.918	651.398.970	3.165.956.307	4,19
2017	10.061.153.961	346.586.043	3.182.701.031	9,21

Burimi: Banka Botërore, kalkulimet e autorit

Ashtu siç e kemi përmendur më herët efikasiteti më i madh ndodh kur ICOR rezulton më i ulët. Bazuar në të dhënat nga periudha 2006 deri 2017 vërehet që pozita më e favorshme është në vitin 2006 me koeficientin prej 2.33 që do të thotë kjo ka qenë periudha ku ekonomia e Maqedonisë ka arritur në një nivel optimal të rritjes ekonomike dhe investimet në përgjithësi kanë rezultuar efikase duke marrë në konsideratë periudhën para krizës.

Edhe pse viti 2007 ishte periudha e fillimit të krizës financiare, megjithatë në vendet e Ballkanit akoma nuk kishte filluar të ndjehet ky fenomen dhe këtë e shpreh edhe rezultati i ICOR me 1.88. Duhet cekur edhe viti 2009 që rezulton me ICOR prej -300,96, rast i cili nuk duhet të ndodh e aq më pak ku edhe efektet e krizës ishin më të mëdhaja. Por, viti 2012 shënon gjendjen jashtëzakonisht më të vështirë ekonomike në vend ashtu siç e shfaq edhe matja e ICOR, e cila rezulton me 47.68.

Periudha nga viti 2006 deri në 2017 është shfrytëzuar për të gjetur nivelin mesatar të këtij koeficienti dhe në fakt kjo shpreh se sa njësi të outputit (PBB) është prodhuar nga një njësi e kapitalit. Në rastin aktual ICOR gjatë kësaj periudhe mesatarisht rezulton -17.49 që nuk shfaq një shifër të favorshme dhe konstaton se investimet nuk janë mjaftueshëm efikase në rritjen ekonomike pasi që kjo lë të kuptohet se efikasiteti realizohet kur një njësi outputi fitohet nga më pak se një njësi kapitali, gjë që krijon absurditet. Ndërkaq, ky nivel negativ i ICOR ndodh për shkak të diferencës negative ndërmjet PBB së vitit paraprak dhe atij aktual dhe supozon se më pak se një njësi e kapitalit është shfrytëzuar për të dhënë një njësi të PBB-së optimale.

3.4 Niveli i borxhit publik dhe investimet bruto në Republikën e Maqedonisë

Maqedonia është një nga vendet në Ballkan që karakterizohet me një ekonomi të varfër në zhvillim dhe autoritetet shtetërore janë ato që duhet të ndërmarrin përgjegjësi të cilat do t'i shmangin faktorët negativ që mbizotërojnë në vend. Në këtë mënyrë edhe e cenojnë ekonominë e cila shfaqet tek niveli i lartë i borxhit publik që është gati 50% e PBB-së.

Megjithëse qeveria merr borxh për të financuar shpenzime të ndryshme dhe për të stimuluar rritjen ekonomike, nga ana tjetër në një afat të gjatë kjo e pengon zhvillimin e ekonomisë nga fakti se një nivel i lartë i borxhit ul besueshmërinë e investitorëve privat. Nga një pikëpamje tjetër, investimet publike realizohen nga financimi i borxhit në mënyrë që të krijohen mundësi për përmirësimin e situatës makroekonomike dhe standardit jetësor. Prandaj, duke parë nga këto aspekte, qëllimi ynë është të shprehim këtë raport në mes investimeve bruto dhe borxhit në Maqedoni për të arritur në një vlerësim të saktë.

Lidhur me këtë, tabela në vijim shpreh një raport pozitiv në mes borxhit dhe investimeve bruto në milion denarë nga viti 2006 deri në vitin 2017. Kjo shfaq dukurinë e rritjes së vazhdueshme të të dy faktorëve kryesor ekonomik. Kjo mënyrë e vlerësimit jep një paraqitje të investimeve bruto të cilat vazhdimisht kanë pësuar rritje duke filluar nga periudha para krizës financiare e deri në vitin 2017, ndërsa nga ana tjetër borxhi është rritur njëkohësisht me rritjen e investimeve bruto duke arritur në 47.7% të PBB-së. Por, duhet të cekim se fenomeni i rritjes së borxhit ndikon në mënyrë negative në rritjen ekonomike në afat të gjatë, ndërsa rritja e investimeve bruto jep një sinjal pozitiv mbi të. Në këtë rast, përballemi me dy faktorë të cilët analizohen në dy aspekte të ndryshme, por që japin efekt të madh në rritjen ekonomike nëpërmjet të cilës vlerësohet e tërë ekonomia e vendit.

Tabela 9. Borxhi publik dhe investimet bruto (në mil. denarë)

Viti	Borxhi publik	% e PBB	Investimet bruto	% e PBB
2006	111.232	33,2%	68.809	20,5%
2007	96.076	25,8%	89.928	24,1%
2008	95.696	23,1%	110.405	26,6%
2009	108.416	26,1%	107.600	26,0%
2010	119.091	27,2%	108.218	24,7%
2011	148.526	32,0%	120.548	26,0%
2012	178.894	38,3%	134.962	28,9%
2013	201.846	40,2%	144.584	28,8%
2014	241.090	45,7%	159.847	30,3%
2015	260.374	46,6%	169.942	30,4%
2016	289.666	48,7%	193.366	32,5%
2017	294.347	47,7%	203.352	33,0%

Burimi: Ministria e financave dhe BQRM, dizajnimi i autorit

Meqenëse qëllimi kryesor në këtë pjesë është analiza e trendit të investimeve bruto si rezultat i rritjes së borxhit publik, tabela në vijim paraqet këtë lëvizje duke përfshirë periudhën para dhe pas krizës financiare.

Tabela 10. Trendi i investimeve bruto si rezultat i rritjes së borxhit publik në RM (në mil. denarë)

Viti	Borxhi publik		Investimet bruto	
	MKD	↑↓ në %	MKD	↑↓ në %
2006	111.232	-8.7	68.809	9.4
2007	96.076	13.6	89.928	30.7
2008	95.696	-0.4	110.405	22.8
2009	108.416	13.3	107.600	-2.5
2010	119.091	9.8	108.218	0.6
2011	148.526	24.7	120.548	11.4
2012	178.894	20.4	134.962	12
2013	201.846	12.8	144.584	7.1
2014	241.090	19.4	159.847	10.6
2015	260.374	8	169.942	6.3
2016	289.666	11.2	193.366	13.8
2017	294.347	1.6	203.352	5.2

Burimi: Ministria e financave dhe BQRM, dizajnimi i autorit

Duke marrë parasysh të dhënat nga Ministria e Financave dhe BQRM, vërehet një rritje e vazhdueshme e borxhit publik. Si rezultat i kësaj, në vitin 2006 është arritur borxhi të zvogëlohet për 8.7% që jep një vlerësim relativisht pozitiv. Përkundër kësaj, në vitin 2011 borxhi është rritur për 24.7% për dallim nga viti paraprak dhe si pasojë e krizës financiare nuk ka arritur të menaxhohet në atë mënyrë që të zvogëlojë vlerën e mjeteve të huazuara duke shënuar edhe rritjen maksimale që ka ndodhur gjatë këtyre viteve. Nga ana tjetër në po të njëjtin vit vërehet edhe rritja e investimeve për 11.4%. Kjo krijon mendimin se një pjesë e borxhit është marrë për të financuar investimet të cilat kanë pësuar rritje.

Derisa borxhi në mënyrë graduale është rritur ku në vitin 2017 ka marrë vlerën 294.3 miliard denarë, investimet poashtu janë rritur në një nivel prej 203.3 miliard denarë. Megjithatë ajo që vlen të përmendet është një përqindje shumë e vogël e rritjes së borxhit prej 1.6% krahasuar me vitin ku vlen të përmendet se është arritur një pozitë e mirë dhe njëkohësisht investimet janë rritur por vetëm për 5.2%. Kjo jep një lajm të mirë për borxhin në aspektin makroekonomik të vendit, por nuk mund të themi të njëjtën gjë edhe për investimet bruto.

3.5 ICOR dhe vlerësimi i ekonomisë së vendeve të Ballkanit Perëndimor

Duke vlerësuar nivelin e efikasitetit në Maqedoni dhe në mënyrë që të bëjmë krahasimin me vendet e Ballkanit Perëndimor, është e një rëndësie esenciale të nxjerrim në pah efektin e investimeve në krijimin e PBB-së duke pasur parasysh se të gjithë këto vende karakterizohen me një ekonomi më të “varfër” në Evropë. Njëkohësisht ato ballafaqohen me sfida të shumta pothuajse në të njëjtat sfera të ekonomisë, politikës dhe çështjeve sociale.

Meqë investimet janë një nga burimet kryesore nga të cilët varet në masë të madhe ekonomia e vendit, është e arsyeshme të bëjmë analizën e nivelit të efikasitetit të tyre. Prandaj, nëpërmjet metodës krahasimore me vendet fqinje të pjesës perëndimore, do të arrijmë në një konkluzë në bazë të fakteve me anë të ICOR me të njëjtën mënyrë siç kemi arritur të japim një vlerësim për ekonominë e Maqedonisë. Në bazë të kësaj, mund të konstatojmë edhe njëherë nga hipotezat e paracaktuara për këtë studim.

Para se të ndalemi tek efikasiteti i investimeve në Ballkanin Perëndimor, le të ndjekim zhvillimin ekonomik si dhe veprimtaritë tjera ekonomike të tyre për të arritur në një qasje më të saktë se në çfarë situatash ekonomike dhe financiare kanë kaluar duke pasur parasysh efektet e krizës financiare. Prandaj, është me rëndësi të kuptojmë fenomenet ekonomike të cilët kanë ndikuar në masë të madhe në ndalimin e zhvillimit ekonomik të këtyre vendeve, veçanërisht pas krizës financiare, pasi që edhe këto janë pjesë e shteteve në zhvillim njëjtë sikurse Maqedonia dhe sigurisht që kapaciteti i mundshëm ekonomik që ato posedojnë nuk krijon nivelin e duhur të zhvillimit ekonomik.

3.5.1 Kosova

Për të vlerësuar një ekonomi në Ballkanin Perëndimor, duhet identifikuar paralelisht zhvillimin ekonomik me vendet tjera që janë pjesë e tij. Megjithatë, fokusi do të qëndrojë në njohjen e fenomeneve të sferave të ndryshme makroekonomike që kanë dhënë efektin e tyre në zhytjen apo forcimin e PBB-së e me këtë edhe në rritjen ekonomike.

Si pjesë e një ekonomie të vogël dhe një nga vendet më të varfëra në botë, Kosova ka qenë e ndikuar nga kriza financiare si çdo shtet tjetër kudo në botë, por duhet cekur se kriza nuk filloi së pari në Ballkan, prandaj edhe ndikimet e saj filluan në vitet e mëvonshme. Ajo karakterizohet relativisht me të ardhura kombëtare të ulta.

Në vitin 2006, Kosova ka shënuar një rritje vjetore të PBB-së prej 4.5%, gjë që jep një rezultat relativisht të mirë duke arritur deri në 7% në vitin 2007. Meqenëse nga viti 2008 filluan gjurmët e para të krizës financiare, PBB-ja arriti në vetëm 2% rritje vjetore që krijon një vlerësim më të dobët krahasuar me vitin 2007. Nga kjo periudhë, ekonomia e këtij vendi filloi të dobësohej deri sa gradualisht në vitin 2011 u vu re rimëkëmbja, edhe pse deri në vitet aktuale nuk është arritur as edhe 4% rritje vjetore.

Sektori i shërbimeve është një ndër sektorët më të frekuentuara që marrin pjesë në PBB me rreth 50% të saj, ndërsa industria paraqet vetëm 16.8% të PBB-së nga ku prodhimi merr 10%.

Investimet janë viktima kryesore që pëson në qoftë se një shtet nuk mundëson stabilitet të duhur ekonomik dhe sigurisht që kjo varet edhe nga ekonomitë tjera të jashtme. Në vitin 2007, Kosova ka arritur në një nivel të investimeve prej 28% të PBB-së dhe pa marrë parasysh ndikimeve të krizës financiare, ajo ka vazhduar të jep rezultate pozitive në dobi të rritjes ekonomike duke arritur në 31% të PBB-së në vitin 2009. Në këtë mënyrë aspektet që përfshijnë investimet kanë krijuar një frymë mjaft të suksesshme në zhvillimin e ekonomisë së vendit duke mos lejuar që kjo pjesëmarrje në PBB të bjerë nën 26%. Kjo strategji e institucioneve shtetërore është planifikuar në një mënyrë që do të krijonte efikasitet në sistemin ekonomik.

Meqë edhe investimet e huaja direkte janë pjesë e investimeve bruto në një vend, duhet diskutuar çështjen e trendit rënës të tyre. Ekziston një interes shumë i ulët i investorëve të huaj, gjë që duke analizuar periudhën para dhe pas krizës financiare pjesëmarrja e tyre në PBB është e një niveli shumë të dobët. Kjo shfaqet nga fakti se IHD në vitin 2007 kanë marrë pjesë në PBB me 12.9% ndërsa gradualisht janë zvogëlar në 7% në vitin 2009 – periudha pas krizës. Ndërkaq investorët e huaj janë një ndër shtytësit kryesor të zvogëlimit të normës së papunësisë dhe mungesa e tyre vërehet në nivelin e lartë të kësaj norme duke filluar nga viti 2006 me 75.5% megjithëse është zvogëluar në 55% në 2012, por gjithsesi kjo jep një absurditet pasi që është një normë tejet e lartë për një vend me një numër të vogël banorësh dhe për një ekonomi të vogël. Megjithatë, jo vetëm IHD ndikojnë në krijimin e vendeve të reja të punës, por është qeveria ajo që duhet të stimulojë forcën punëtore të jetë aktive nëpërmjet projekteve të ndryshme të punësimeve.

Duke krahasur me vendet e rajonit, një vlerësim pozitiv jep niveli i borxhit publik në Kosovë që në vitin 2010 ka rezultuar me 4.1% të PBB-së ndërsa në vitet në vijim nuk ka ndryshuar në masë të madhe deri sa aktualisht është ngjitur në 16.6% të PBB-së.

Në përgjithësi, pritet një nivel më i lartë i rritjes ekonomike në vitet e ardhshme dhe indikatorët kryesorë të rritjes së këtij niveli supozohet të jenë konsumi privat dhe ai publik. Por, nga ana tjetër investimet ngelen me një interes të ulët dhe të pa afta për të ndikuar në zhvillimin e duhur ekonomik. Në këtë aspekt nevojitet një implementim i strategjive ekonomike efikase për të stimuluar investimet e sidomos formulimin e projekteve për të tërhequr investorë të huaj. Megjithatë, rritja reale e PBB-së parashikohet që do të pësojë rezultate pozitive në të ardhmen dhe do të përmirësojë nivelin e rritjes ekonomike.¹³

Nga pikëpamja e këtyre vlerësimeve, në vijim paraqesim PBB-në dhe investimet bruto si dy elemente kyçe për të dhënë nivelin e efikasitetit – ajo që është edhe qëllimi ynë kryesor duke filluar pikërisht me Kosovën e më tej.

¹³ Shënim: Sipas vlerësimit të të dhënave statistikore nga Banka Botërore

Tabela 11. ICOR në Kosovë

Viti	PBB (euro)	ΔPBB	IB (euro)	ICOR
2006	3.250.867.204	246.192.472	812.741.802	3,5
2007	3.531.583.675	280.716.471	908.747.263	2,9
2008	3.882.706.013	351.122.337	1.208.658.738	2,6
2009	4.069.843.113	187.137.100	1.267.494.714	6,5
2010	4.401.862.347	332.019.234	1.450.669.459	3,8
2011	4.810.099.099	408.236.752	1.632.297.890	3,6
2012	5.059.060.999	248.961.900	1.465.088.705	6,6
2013	5.327.409.990	268.348.991	1.470.819.932	5,5
2014	5.567.728.994	240.319.004	1.434.859.014	6,1
2015	5.806.635.962	238.906.969	1.601.227.189	6,0
2016	6.071.035.042	264.399.080	1.650.063.883	6,1
2017	6.325.978.614	254.943.572	1.826.793.824	6,5

Burimi: Banka Botërore, kalkulimet e autorit

Duke u bazuar në të dhënat e shprehura në valutën euro nga Banka Botërore, mund të japim një vlerësim të realizimit të investimeve duke filluar nga periudha para krizës financiare duke vërejtur një koeficient stabil të ICOR me 2.9 në vitin 2007. Megjithatë situatën jo aq të favorshme për ekonominë e Kosovës ka shënuar viti 2012 pas krizës financiare me një koeficient prej 6.6. Ndërkaq, nga ajo periudhë e deri në vitin 2017 nuk ka dhënë rezultate përkeqësuese dhe lëkundëse, gjë që jep një vlerësim pozitiv mbi efikasitetin e investimeve. Përveç kësaj, duhet të kemi parasysh se Kosova është vendi me një popullsi më të vogël për dallim nga vendet tjera dhe PBB-ja së bashku me bruto investimet kapin një vlerë më të ulët në përgjithësi.

3.5.2 Shqipëria

Ekonomia e Shqipërisë i përket një sistemi më fleksibil i cili krijon mundësi për një treg konkurrues dhe të hapur. Strategjitë e politikave të ndryshme janë në një zhvillim e sipër për të krijuar një ekonomi funksionale dhe të suksesshme duke shmangur ndikimet politike.

Shqipëria është vlerësuar me një rritje mjaft të favorshme të PBB-së prej 7.5% në vitin 2008 e cila ka përjetuar një degradim për shkak të krizës financiare duke rënë në 3.35% një vit pas (në 2009). Vazhdimi i kësaj situatë deri në vitet e fundit nuk ka dhënë rezultate të mira për ekonominë e vendit ku në vitin 2013 kishte rritje vetëm prej 1%. Ndërsa viti 2017 shënon

një pozitë më të mirë në qoftë se krahasojmë me periudhën nga kriza e këndeje duke shënuar 3.8% rritje. Ekzistojnë faktorët të shumtë që kanë stimuluar këtë rritje duke mos harruar zhvillimin e turizmit dhe prodhimin e energjisë.

Evolucioni i investimeve ka rrjedhur me një ritëm në aspekt negativ gjatë periudhës nga 2006 deri në 2017. Të dhënat nga Banka Botërore e shprehin këtë duke filluar nga 38.7% të pjesëmarrjes në PBB në vitin 2007, për të pësuar rënie në 35.4% në vitin 2009 dhe vazhdimisht shënon zvogëlim duke arritur në 24.8% në vitin 2017. Megjithatë, kjo nuk krijon bindjen se investimet nuk japin kontributin e duhur, pasi që vërehet një rezultat relativisht i mirë dhe ekziston potencial për një rritje të mëtutjeshme. Ndërkaq, në fushën e investimeve të huaja direkte duhet të potencojmë se pa marrë parasysh ndikimet e krizës financiare ato kanë shfaqur rritje pikërisht në vitin 2008 nga 9.7% të PBB-së deri në 11.16% në vitin 2009. Por, ky interesim i investitorëve të huaj është zbehur në vitin 2010 duke rënë në 9.14% të PBB-së në vend duke arritur nivelin më të lartë deri më tani në 9.8% të PBB-së. Në këtë mënyrë ka vazhduar ky trend gjatë tërë periudhës deri në vitin 2017 duke zbritur në 7.8%, gjë që mund të themi se ka pasur një qëndrueshmëri pozitive nga këndvështrimi i ekonomisë së Shqipërisë, pasi që vende të tilla me ekonomi të vogël kanë nevojë për investime të tilla meqë ato janë një faktorë shumë i rëndësishëm që stimulojnë rritjen ekonomike dhe ofrojnë vende të reja pune. Sipas këtij vlerësimi tregu i Shqipërisë ofron mundësi të favorshme për zhvillimin e zonave industriale në lidhje me IHD.

Nga një këndvështrim tjetër, niveli i papunësisë ka kaluar në faza të ndryshme gradualisht duke filluar nga viti 2007 që arriti në 13.5% , duke arritur nivelin më të lartë në vitin 2014 me 17.4%. Që nga ky vit është arritur të menaxhohet kjo normë deri sa viti 2017 shënon një përmirësim në këtë aspekt me 13.8%. Kjo jep një vlerësim pozitiv duke pasur parasysh se kohëve të fundit fenomeni i punësimeve ka qenë problem kryesor jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Ballkan.

Problemi kryesor me të cilin përballlet Shqipëria është keqmenaxhimi i politikave fiskale dhe në këtë rast duhet përmendur niveli i lartë i borxhit publik si përqindje e PBB-së që shkon vazhdimisht duke u rritur krahasuar me vitet para krizës financiare. Kjo normë e lartë prej 69.9% e vlerësuar në vitin 2017 shfaq edhe çështje tjera financiare që krijojnë pengesa në rritjen ekonomike e ku në vend të parë dalin pamundësitë e krijimit të investimeve publike optimale. Këtu vlen të përmendet se qeveria duhet të menaxhojë këto politika duke

shmangur projekte investive joproductive për të stimuluar ato që janë të dobishme për zhvillimin e ekonomisë nacionale.

Duke parë këto të dhëna , projeksionet për të ardhmen vlerësojnë një rritje të investimeve si dhe një kontribut më të madh në rritjen ekonomike. Përveç kësaj, qeveria duhet të krijojë mundësi për përmirësimin e mirëqenies sociale duke ditur që është i pranishëm fenomeni i varfërisë, njëkohësisht të menaxhojë zvogëlimin e borxhit publik që është në një nivel relativisht të lartë.¹⁴

Bazuar në këto vlerësime ekonomike, kthehemi në llogaritjen e efikasitetit të investimeve në veçanti, me situatën aktuale të ekonomisë së Shqipërisë duke u karakterizuar me një koeficient të ICOR prej 4.3 në vitin 2007 dhe duke zbritur në -25.4 në vitin 2009.

Ajo që e vlerëson nivelin e efikasitetit të investimeve në një gjendje aspak të favorshme është periudha e pas krizës financiare në vitin 2013 me një koeficient prej 79.5, gjë që gati se në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kjo periudhë ka shënuar rezultate negative që kanë ndikuar në zhvillimin ekonomik në të ardhmen. Kjo do të thotë se është nevojitur të investohet një sasi më e madhe e kapitalit për të dhënë një PBB optimale. Kjo nga ana tjetër krijon shpenzime shtesë të cilat shpijnë në rritjen e borxhit publik. Nga ana tjetër, niveli më efikas gjatë kësaj periudhe është shënuar në vitin 2008 me ICOR prej 3.1.

Tabela 12. ICOR në Shqipëri

Viti	PBB (euro)	ΔPBB	IB (euro)	ICOR
2006	7.168.403.915	607.951.720	2.794.219.934	4,0
2007	7.818.565.930	650.162.016	3.022.308.259	4,3
2008	8.793.777.446	975.211.516	3.146.275.350	3,1
2009	8.669.942.349	- 123.835.097	2.996.140.753	- 25,4
2010	9.005.386.423	335.444.074	2.729.413.729	8,9
2011	9.273.110.018	267.723.595	2.913.015.834	10,2
2012	9.588.414.581	315.304.563	2.716.258.789	9,2
2013	9.622.568.397	34.153.816	2.729.842.448	79,5
2014	9.970.537.848	347.969.450	2.450.294.595	7,8
2015	10.267.129.260	296.591.413	2.506.561.740	8,3
2016	10.743.264.611	476.135.351	2.662.041.166	5,3
2017	11.571.082.507	827.817.896	2.918.694.084	3,2

Burimi: Banka Botërore, kalkulimet e autorit

¹⁴ Shënim: Sipas vlerësimit të të dhënave statistikore nga Banka Botërore

3.5.3 Sërbia

Sërbia konsiderohet një shtet i cili ka arritur të rimëkëmb ekonominë e tij duke krijuar kushte për t'iu bashkangjitur vendeve të Bashkimit Evropian. Ajo njihet për nga tregu i lirë dhe që nga shpërbërja e Jugosllavisë ka krijuar strategji të suksesshme për të mirëmbajtur shëndetin ekonomik, politik e social dhe vazhdon të bëjë reforma në këtë aspekt për të rritur nivelin e rritjes ekonomike.

Rasti i rritjes reale të PBB-së pothuajse ka shkuar në një drejtim të njëjtë sikurse Kosova. Në vitin 2007 ka qenë 5.8% , derisa viti 2009 si pasojë e krizës financiare ka ndikuar në një përkeqësim të rritjes së PBB-së duke rënë deri në -3.1%. Që nga kjo periudhë ka arritur në 1.4% në vitin 2011 duke vazhduar me këtë ritëm. Në këtë mënyrë në vitin 2014 ka pësuar rënie në -1.8%, ndërsa gradualisht është ngjitur në 1.8% në vitin 2017. Vlerësuar në këtë aspekt, kriza financiare ka prekur në masë të madhe ekonominë e këtij vendi, gjë që e ka bërë pak më të vështirë rimëkëmbjen në aspekt ekonomik.

Në fushën e investimeve vërehet një nivel i lartë para periudhës së krizës financiare ku në vitin 2008 janë përfaqësuar me 30% të PBB-së, gjë që krijon një pikëpamje mjaft pozitive, megjithëse viti pasardhës pësoi rënie për gati 10% krahasuar me rastin e vitit 2008. Këtu vërehet se në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, periudha nga 2009 e këndeje si rezultat i krizës financiare ka dhënë efektet e saj në aspekt negativ dhe vështirësitë e mëdha për të krijuar strategjitë e duhura kanë qenë pengesë për ngadalësimin e zhvillimit ekonomik. Këtë e themi meqë niveli më i lartë i investimeve që është arritur pas krizës ka qenë 21.1% e PBB-së edhe atë në vitin 2012. Ndërsa të dhënat nga viti 2017 japin një pjesëmarrje prej 19% që krahasuar me vendet tjera fqinje konsiderohet me një nivel më të ulët në rajon.

Për t'u ndalur tek investimet, një faktor tjetër ekonomik që jep një kontribut domethënës në rritjen ekonomike janë investimet e huaja direkte. Viti 2006 ka dhënë një përqindje prej 23.9% të PBB-së e cila ka ndryshuar në vitin 2009 në aspekt negativ me 6.8%, gjë që nuk krijon suksesin e mjaftueshëm të zhvillimit të biznes klimës. Në këtë ritëm IHD kanë vazhduar nga viti në vit duke prekur normën prej 4% të pjesëmarrjes në PBB në vitin 2010 dhe që nga kjo periudhë niveli më i lartë i IHD-ve ka arritur në jo më tepër se 10.6% në vitin 2011. Ndërkaq në vitin 2017 është vlerësuar me 6.9% dhe kjo nuk krijon mënyrën e duhur të funksionimit të ekonomisë në zhvillimin e bizneseve pasi që ekzistojnë kapacitete më të

mëdha për tërheqjen e investitorëve të huaj. Një nga arsyet më të shpeshta pas krizës financiare mund të konsiderohet edhe prania e korrupsionit dhe çështjet politike në vend.

Niveli i normës së papunësisë si një pjesë e ndikimit në zhvillimin ekonomik që krijon forcën punëtore të duhur ka marrë pjesë me 18% në vitin 2007 dhe gjatë gjithë kësaj periudhe që analizojmë mund të thuhet se gjendet në një pozitë jo aq të favorshme. Kjo ndodh meqë niveli më i ulët ka arritur në 18.06% në vitin 2017 ndërsa niveli më i lartë shënohet në vitin 2012 më 24%. Megjithatë, ky rezultat krijon bindjen e një fryme pozitive në ekonomi pasi Serbia ka arritur të zvogëlojë këtë normë çdo vit e më tepër duke përmirësuar mirëqenien ekonomike.

Borxhi publik është i vetmi fenomen ekonomik që vazhdimisht ka pësuar rritje në aspekt negativ edhe atë duke filluar nga viti 2006 me 36% të PBB-së gradualisht duke prekur nivelin e 74.7% në 2015 që krijon një shifër marramendëse edhe pse ka arritur ta menaxhojë në 61.5% në vitin 2017, por kjo nuk krijon mundësitë e duhura për të përmirësuar gjendjen financiare dhe fiskale në vend.

Në përgjithësi, duke vlerësuar ndikimet e shumta ekonomike në Serbi, vërehet se ekziston një mundësi për përmirësim të rritjes së PBB-së në të ardhmen, njëkohësisht edhe borxhi publik planifikohet të zvogëlohet deri në një nivel ku do të ofrojë stabilitet ekonomik të duhur. Nga ana tjetër një rritje e nivelit të investimeve dhe punësimeve patjetër që do të ofronte një kontribut të dukshëm në përmirësimin e standardit jetësor, rritjen e produktivitetit dhe zgjerimin e ekonomisë nacionale.¹⁵

Për të ndjekur strukturën e njëjtë të efikasitetit të investimeve, kalojmë në vlerësimin e ICOR. Analizuar në këtë këndvështrim, të dhënat nxjerrin në pah nivelin e lartë të efikasitetit në vitin 2007 me një koeficient 1.2 që jep një rezultat pozitiv duke marrë parasysh se një nivel i ulët i ICOR mund të jep një PBB po aq optimale për të ndikuar në ekonominë nacionale të Serbisë. Kjo nënkupton që një njësi e PBB-së fitohet nga prodhimi i më pak sasive të kapitalit. Dhe ky koeficient ka arritur në -6.7 në vitin 2010 pas krizës financiare dhe për dallim nga Shqipëria është në një nivel kryesisht të favorshëm, megjithëse në vitin 2015 ka arritur në një

¹⁵ Shënim: Sipas vlerësimit të të dhënave statistikore nga Banka Botërore

shifër prej 31.9 të ICOR-it. Por, kjo më pas ka shënuar rezultate pozitive në vitin 2017 me koeficientin prej 3.1.

Tabela 13. ICOR në Sërbë

Viti	PBB (euro)	ΔPBB	IB (euro)	ICOR
2006	24.398.885.241	3.289.120.705	6.105.399.292	1,6
2007	29.437.081.096	5.038.195.855	8.565.773.247	1,2
2008	33.628.246.948	4.191.165.852	10.198.070.598	2,0
2009	30.677.299.561	- 2.950.947.387	5.956.179.268	- 3,5
2010	29.794.345.803	- 882.953.759	5.502.745.393	- 6,7
2011	33.426.073.600	3.631.727.797	6.719.538.320	1,5
2012	31.709.498.424	- 1.716.575.176	6.662.299.724	-3,9
2013	34.283.534.761	2.574.036.337	6.050.955.443	2,6
2014	33.323.055.293	- 960.479.468	5.829.511.661	- 6,3
2015	33.505.948.210	182.892.917	6.316.516.914	31,9
2016	34.624.409.133	1.118.460.923	6.605.878.673	5,6
2017	36.766.320.851	2.141.911.718	7.720.389.064	3,1

Burimi: Banka Botërore, kalkulimet e autorit

3.5.4 Mali i Zi

Arritja e qëllimeve për një zhvillim të një ekonomie të një vendi në Ballkan është një sfidë që kërkon shumë planifikim dhe implementim të strategjive të ndryshme për stabilitet ekonomik. I tillë është rasti me Malin e Zi që përveç turizmit që është një nga sektorët dhe stimuluesit kryesor të rritjes së PBB-së, njihet edhe si një shtet në të cilin mbizotëron privatizimi i shumë institucioneve publike, gjë që nuk është vërejtur në vendet tjera të rajonit.

Ekonomia e këtij vendi karakterizohet me një rritje vjetore të PBB-së prej 8.6% para krizës financiare në vitin 2006, por si çdo vend tjetër në Ballkan, Mali i Zi ka pësuar një situatë shumë të vështirë njëjtë si Kroacia duke u përfaqësuar me -5.8% zvogëlim të PBB-së. Kjo e shpreh edhe atë periudhën nga e cila është dashur të rimëkëmbet një vit pas dhe sigurisht që ka arritur në një mënyrë të kalojë në një rritje vjetore prej 2.7% që është një sukses i mjaftueshëm për të vazhduar më tutje. Ndërsa në vitin 2017 rritja vjetore e PBB-së ka qenë 4.7%.

Në përgjithësi, ajo që bie në shikim të parë në vlerësimin e ekonomisë së një vendi është niveli i investimeve nga viti 2006 me 34.77% të PBB-së që është rritur në 41% në vitin 2008. Këto të dhëna nga Banka Botërore japin një rezultat të favorshëm në këtë aspekt, megjithëse

viti pasardhës krijoi pasiguri duke rënë në 26.9% dhe duke vazhduar me këtë ritëm deri sa arriti përsëri kulmin në vitin 2017 me 29% të PBB-së. Duke krahasuar me vendet tjera të rajonit, Mali i Zi rangohet në një pozitë më të mirë sa i përket realizimit të investimeve gjatë kësaj periudhe. Kjo më pas pasqyrohet edhe tek interesimi i investitorëve të huaj.

Përfitimet e realizuara nga IHD, stabiliteti ekonomik dhe politik së bashku me politikat fiskale avancuese kanë mundësuar që ekonomia e këtij vendi të shndërrohet në një treg konkurrues dhe tërheqës për investitorët e huaj. Përkundër pranisë së krizës financiare, investitorët e huaj kanë shfaqur një interesim mjaft domethënës për rritjen ekonomike të vendit dhe kjo vërehet nga pjesëmarrja e madhe e tyre në PBB në vitin 2009 me 37.2%. Megjithatë, kjo normë ka ndryshuar në aspekt negativ në vitet në vijim duke arritur nivelin më të lartë të mundshëm në vitin 2015 me 17.2% ndërsa viti 2017 shënon 11.5% të pjesëmarrjes së IHD-ve në PBB.

Forca punëtore është resursi më vital që një ekonomi të funksionojë në mënyrë të duhur. Mali i Zi shënoi një normë të lartë papunësisë në vitin 2006 me 24.8%, por që është arritur nga viti në vit të zvogëlohet dhe viti 2017 ka regjistruar normën prej 16.1% dhe krahasuar me një periudhë prej 10 vitesh më parë mund të themi se është arritur targeti i shmangies së fenomenit të personave të papunë, megjithëse ende është i pranishëm problemi i të papunëve që prek moshat më të reja.

Duke ditur problemin kryesor që mbizotëron në çdo vend të Ballkanit Perëndimor, është e paarsyeshme t'i shmangemi ndikimit të borxhit publik. Borxhi publik edhe pse konsiderohet si financues kryesor, por duhet të arrihet në një nivel të menaxhuar në mënyrë të duhur për të mos eskaluar gjendjen aq sa të arrijë në një vlerë të papërballueshme për ekonominë e vendit. Mali i Zi shënon 38% borxh publik si pjesëmarrje e PBB-së duke vazhduar me një rritje deri në 56.8% në vitin 2012, por duke mos tejkaluar nivelin mbi 66% që është regjistruar në vitin 2016. Sipas kësaj, krahasuar me vendet tjera fqinje, Mali i Zi konsiderohet në një pozitë më të mirë të menaxhimit me politikat lidhur me borxhin.

Duke u bazuar në këto vlerësime, vërehet një perspektivë e rritjes ekonomike në të ardhmen e Malit të Zi dhe kjo është një avantazh që duhet shfrytëzuar. Nga ana tjetër, investimet do të mundësojnë edhe më tepër zhvillimin ekonomik e veçanërisht në sektorin e

turizmit. Ndërsa, ajo që më tepër duhet të ketë fokusin kryesor është ulja e nivelit të borxhit publik edhe pse do të krijojë vështirësi. Kjo do të shfaq nevojën për hulumtime shtesë gjatë menaxhimit të të ardhurave dhe shpenzimeve kombëtare.¹⁶

Pas këtij vlerësimi, qëllimi ynë ashtu siç e kemi parashtruar që në fillim të këtij hulumtimi është vlerësimi i efikasitetit të investimeve në veçanti dhe të dhënat do të na japin një qasje të re mbi këtë.

Tabela 14. ICOR në Mali të Zi

Viti	PBB (euro)	ΔPBB	IB (euro)	ICOR
2006	2.169.741.598	354.702.455	519.175.703	0,9
2007	2.689.266.867	519.525.269	934.712.614	1,0
2008	3.103.218.358	413.951.491	1.277.800.206	2,3
2009	2.994.064.851	- 109.153.507	806.695.188	- 11,7
2010	3.125.276.264	131.211.412	680.370.549	6,1
2011	3.264.575.781	139.299.517	631.005.527	4,9
2012	3.181.451.474	- 83.124.307	654.922.951	- 7,6
2013	3.362.298.965	180.847.492	659.226.113	3,6
2014	3.458.062.226	95.763.260	699.266.760	6,9
2015	3.654.345.831	196.283.605	734.346.608	3,6
2016	3.954.367.095	300.021.264	1.031.906.951	2,4
2017	4.236.509.678	282.142.583	1.241.695.802	3,7

Burimi: Banka Botërore, kalkulimet e autorit

Duke u bazuar në të dhënat e Bankës Botërore, Mali i Zi rezulton të jetë në një nivel të përafërt me Kosovën sa i përket vlerësimit të këtyre faktorëve ekonomik: PBB dhe bruto investimeve. Një nivel optimal të efikasitetit të investimeve do të jepte viti 2006 me ICOR prej 0,9 meqë gjendet në një nivel më të ulët në kuptim pozitiv, por prodhon një efikasitet të lartë të investimeve edhe atë duhet potencuar se ky vlerësim i referohet periudhës para krizës financiare, ndërsa do të ndikonte në mënyrë negative niveli i ICOR në vitin 2009 që jep vlerën nën zero me -11.7. Ndërkaq, niveli më i ulët i efikasitetit gjatë kësaj periudhe është shënuar në vitin 2014 me një ICOR prej 6.9.

¹⁶ Shënim: Sipas vlerësimit të të dhënave statistikore nga Banka Botërore

Në përgjithësi ekonomia e investimeve të Malit të Zi gjatë kësaj periudhe nga viti 2006 deri në 2017 jep një vlerësim mjaft stabil në qoftë se krahasojmë me vendet tjera pa marrë parasysh se ekzistojnë situata të padëshiruara që ndikojnë në rritjen ekonomike.

3.5.5 Bosnia dhe Hercegovina

Ekonomia e Bosnes dhe Hercegovinës vlerësohet me një treg më pak kompetitiv dhe të kufizuar krahasuar me vendet tjera të BP. Që nga kriza financiare e këndej zhvillimi ekonomik është ngadalësuar në të gjitha aspektet dhe nevojitet stimulimi i aktiviteteve dhe përcaktimi i targeteve ekonomike për të përmirësuar standardin jetësor.

PBB-ja e këtij vendi para krizës ka shënuar një rritje prej 5.8% në vitin 2007, ndërsa më vonë është lëshuar në -3% në vitin 2009. Ndërsa niveli më i lartë që është arritur pas kësaj periudhe është gjatë vitit 2017 me 3.1% rritje vjetore. Por, krahasuar me vendet tjera të rajonit, Bosnia dhe Hercegovina nuk jep forcimin e duhur për ngjitjen më lartë të nivelit të rritjes ekonomike dhe arsyet janë të shumta: mbizotërimi i konsumit më tepër se prodhimit, eksporti i dobët, prania e korrupsionit e të tjerë.

Niveli i investimeve është zvogëluar që nga viti 2007 që rezultonte me 27% të PBB-së duke arritur në 16.3% në vitin 2010. Kjo shfaq një keqmenaxhim të politikave ekonomike dhe aktiviteteve të qeverisë për të krijuar inovacione në kuptimin që do të jepnin përfitime për zhvillimin ekonomik në vend. Megjithatë, vërehet që gradualisht nga viti 2015 e këndej është rritur ky nivel i investimeve duke prekur shifrën e 21% të PBB-së në vitin 2017. Ndërsa, zhvillimi i IHD-ve ka arritur nivelin më të lartë në vitin 2007 me 11.6% të PBB-së, por që kjo pjesëmarrje është shuar në vitin 2009 në 0.7% si pasojë e krizës financiare si në çdo shtet tjetër në Ballkan. Vështirësitë për të krijuar kushte për tërheqjen e investitorëve të huaj kanë qenë të shumta si rezultat e një tregu të segmentuar, jocompetitiv dhe ende të varur nga Ish Jugosllavia. Prandaj, mosinteresimi i investitorëve të huaj ka bërë që kjo pjesëmarrje e IHD-ve në PBB të jetë jo më shumë se 2.5% që është shënuar në vitin 2017.

Vlerësimi ynë sipas të dhënave nga Banka Botërore shfaq një nivel shumë të lartë të papunësisë ku në vitin 2007 ka qenë 28.9% ndërsa pas një periudhe dhjetë vjeçare – viti 2017

ka arritur të zvogëlohet vetëm 4%, gjë që duke marrë parasysh se ka kaluar një kohë e gjatë, nuk është bërë ndonjë ndryshim apo investim në kuptim të stimulimit të forcës punëtore për ta aktivizuar atë në projekte të ndryshme.

Rezultatet e nivelit të borxhit publik shprehin rritjen e tij nga viti në vit duke arritur në 33.3% të PBB-së në vitin 2016, gjë që deri më tani jep një vlerësim pozitiv në menaxhimin e politikave fiskale të konsoliduara.

Në përgjithësi, vërehet një mungesë e implementimit të politikave të ndryshme nga qeveria, gjë që mund të krijojë rreziqe të mëdha në ekonomi. Qëllimi kryesor të cilin qeveria duhet ta ketë parasysh është gjetja e një zgjidhje të duhur për zvogëlimin e normës së papunësisë dhe stimulimi i investimeve të reja në të ardhmen e cila do të krijojë mundësi për një rritje dhe stabilitet ekonomik dhe social në vend.¹⁷

Duke marrë në konsideratë këto vlerësime, le të kthehemi tek gjetjet dhe llogaritjet lidhur me ICOR për këtë shtet për të vërtetuar ndikimin e investimeve në rritjen ekonomike.

Meqë kemi llogaritur periudhën e njëjtë të analizuar tek të gjitha vendet, niveli i efikasitetit karakterizohet me diferenca të mëdha nga njëra tjetra. Duke marrë parasysh rezultatet nga kalkulimet e realizuara, Bosnia dhe Hercegovina ka dhënë një koeficient marramendës në aspekt negativ në vitin 2012 me -543.8. Arsyet mund të jenë të natyrave të ndryshme, por patjetër që edhe kriza financiare ka dhënë efektet e saj. Ndërsa ICOR më efikas rezulton viti pasardhës me 9.1, gjë që krahasuar me atë paraprak, ekziston një përmirësim i prodhimit të kapitalit për të dhënë një PBB optimale që të jep rezultate pozitive në rritjen ekonomike. Nga ana tjetër, mund të thuhet se nivelin më efikas të investimeve ka shënuar në vitin 2017 me një koeficient prej 3.6 duke konstatuar se përdorimi optimal i kapitalit ka krijuar PBB të favorshme në vend.

¹⁷ Shënim: Sipas vlerësimit të të dhënave statistikore nga Banka Botërore

Tabela 15. ICOR në Bosne dhe Hercegovinë

Viti	PBB (euro)	ΔPBB	IB (euro)	ICOR
2006	10.256.434.540	1.230.076.332	2.218.745.929	2,0
2007	11.526.853.909	1.270.419.369	2.924.382.941	1,7
2008	13.047.789.550	1.520.935.641	3.532.501.072	1,9
2009	12.679.196.699	- 368.592.852	2.508.213.914	- 9,6
2010	12.969.242.864	290.046.166	2.118.581.006	8,6
2011	13.412.175.333	442.932.469	2.513.444.470	4,8
2012	13.407.553.447	- 4.621.886	2.576.629.667	- 543,8
2013	13.691.303.770	283.750.323	2.487.174.283	9,1
2014	13.987.998.811	296.695.041	2.673.842.061	8,4
2015	14.615.624.474	627.625.663	2.726.653.629	4,3
2016	15.288.215.597	672.591.123	3.000.299.455	4,1
2017	16.122.743.012	834.527.415	3.301.623.997	3,6

Burimi: Banka Botërore, kalkulimet e autorit

3.5.6 Kroacia¹⁸

Zhvillimi i ekonomisë së Kroacisë është një nga avantazhet më të mëdha jo vetëm brenda Ballkanit Perëndimor, por edhe në Evropë duke u konsideruar me një treg mjaft të fortë e sidomos pesha më e madhe tanimë qëndron në atë që është anëtarja më e re e Bashkimit Evropian që nga viti 2013 duke u konsideruar si pjesë e tij.

Rritja vjetore e PBB-së në vitin 2006 arriti në 5.2% e cila pas krizës financiare u përkeqësua në një nivel degradues sa që arriti deri në -7.2%. Megjithatë, rimëkëmbja e kësaj ekonomie u realizua në vitet në vazhdim për të dhënë një rezultat relativisht të mirë prej 2.9% rritje vjetore në 2017 si rezultat i eksporteve të të mirave, konsumit privat, investimeve e tjerë.

Në fakt, në qoftë se bëjmë një paralelizëm me të gjitha vendet tjera të BP, vërehet një trend i ngjashëm i shumë aktiviteteve ekonomike si pasojë e krizës financiare dhe viti 2009 ka shënuar periudhën më të vështirë ekonomike, politike dhe sociale. Njëjtë ndodh edhe në rastin e Kroacisë e cila në këtë rast me investimet ka kaluar në një trend rënës nga viti 2008 me 31.4% pjesëmarrje në PBB në 21.4% pas krizës që është viti 2010. Është dashur një kohë

¹⁸ Sqarim: Kroacia ishte vendi i 28 që iu bashkua vendeve të Unionit Evropian që nga 1 Korrik të vitit 2013

e gjatë që të arrihet rimëkëmbja në këtë aspekt duke dhënë rezultate pozitive në vitin 2017 me pjesëmarrje 20.9% të PBB-së, por që është arritur të mbahet një balancë deri diku efektive dhe një kontribut pozitiv në rritjen ekonomike. Duhet përmendur se investimet kryesore janë edhe projektues kryesor të zhvillimit të turizmit i cili është zhvilluar në një nivel shumë të avancuar.

Duke krahasuar të dhënat lidhur me IHD me vendet tjera fqinje, vërehet një trend jo aq i qëndrueshëm i tyre, por që kanë kontribuar në mënyrë solide në ekonominë e këtij vendi. Kjo vërehet nga fakti se ekziston një dallim që para krizës financiare shënonte 7.6% të PBB-së në vitin 2007 ndërsa një rënie drastike ndodhi në vitin 2010 deri në 2.38% të PBB-së. Gjatë kësaj periudhe IHD kanë dhënë kontributin e tyre duke u përfaqësuar me 6.8% të PBB-së në vitin 2014, ndërsa viti 2017 merr pjesë me 3.6%. Vet fakti që Kroacia është pjesë e BE-së, por jo vetëm kaq, një buxhet i mirë menaxhuar, turizmi, kualiteti i infrastrukturës, inflacioni i ulët, trajtim i barabartë për çdo rezident të huaj, taksa administrative të ulta e shumë aspekte tjera kanë bërë që të hapë portën për investitorët e huaj.

Nga këndvështrimi i investimit në forcën punëtore, në përgjithësi Kroacia vlerësohet me një nivel të ulët të papunësisë sipas të dhënave të regjistruara nga Banka Botërore. Kjo i jep një avantazh jo vetëm si pjesë e BP, por edhe sipas vlerësimit të vendeve evropiane. Me këtë, ajo ka arritur që të mbajë stabile normën e papunësisë deri në 9% në vitin 2017 dhe kjo normë vazhdon të zvogëlohet edhe në vitet në vijim.

Evolucioni i borxhit publik në vite ka kaluar në faza të ndryshme që nga viti 2006 që shënonte 50.3% të PBB-së e deri në vitet e fundit duke prekur 84%. Një nivel kaq i lartë krijon një keq menaxhim të politikave makroekonomike dhe mungesën e funksionimit të financave publike si rezultat i deficitit buxhetor të cilin e kanë krijuar subjekte të ndryshme në pronësi publike.

Në kuptim të PBB-së vërehet një rritje e dobët dhe qeveria duhet të formulojë strategji të cilat do të stimulojnë rritjen ekonomike dhe do të përmirësojë mirëqenien sociale. Nga ana tjetër, borxhi publik duhet të menaxhohet në mënyrë optimale për të zvogëluar nivelin aktual dhe nëpërmjet këtyre dhe aktiviteteve tjera duke përfshirë jo vetëm institucionet publike por,

edhe ato private do të mund të arrihet një zgjerim i aktiviteteve ekonomike dhe sociale si çështje primare.¹⁹

Marrë në konsideratë të dhënat për investimet bruto dhe PBB-në, le t'i kthehemi matësit të efikasitetit të tyre në këtë vend, ku fokusi kryesor do të qëndrojë në efektin e ICOR duke pasur parasysh se ky vend arrin një PBB me një vlerë shumë më të madhe se shtetet fqinje të përmendura më lartë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se niveli i efikasitetit është më i favorshëm se vendet tjera. Këtë e shfaq tabela në vijim duke dhënë nivelin më të ulët të efikasitetit të investimeve që ka ndodhur gjatë kësaj periudhe, jo vetëm në vend, por në të gjithë Ballkanin Perëndimor në vitin 2010 me një vlerësim të ICOR tre shifror prej 300.6. Sipas këtij rezultati, Kroacisë i është nevojitur të prodhojë shumë kapital për të dhënë një PBB optimale, gjë që ka krijuar edhe shpenzime shtesë me vlerë të madhe. Por, nga ky vit e deri në vitin 2017, situata ekonomike është përmirësuar duke arritur në një nivel efikasiteti stabil me koeficientin prej 4.1 që është shumë herë më i favorshëm se rezultati nga vitet pas krizës financiare.

Tabela 16. ICOR në Kroaci

Viti	PBB (euro)	ΔPBB	IB (euro)	ICOR
2006	40.218.615.540	3.698.413.341	11.988.245.338	2,8
2007	43.906.392.054	3.687.776.514	13.041.499.857	3,3
2008	48.115.924.868	4.209.532.815	15.124.893.743	3,1
2009	45.136.418.608	- 2.979.506.260	11.301.616.708	- 5,1
2010	45.174.020.996	37.602.388	9.656.823.591	300,6
2011	44.869.800.095	- 304.220.900	9.261.130.913	- 31,7
2012	44.024.570.014	- 845.230.082	8.452.818.137	- 11,0
2013	43.747.885.233	- 276.684.780	8.452.623.796	- 30,6
2014	43.437.154.839	- 310.730.394	8.184.792.872	- 27,2
2015	44.564.959.177	1.127.804.338	8.917.072.302	7,3
2016	46.411.823.296	1.846.864.118	9.353.619.925	4,8
2017	48.672.997.988	2.261.174.692	9.987.306.545	4,1

Burimi: Banka Botërore, kalkulimet e autorit

¹⁹ Sipas vlerësimit të të dhënave statistikore nga Banka Botërore

3.5.7 Analiza komparative e ICOR të Maqedonisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor

Duke marrë parasysh se ekonomia e një vendi në të ardhmen varet nga investimet e realizuara në aspekt makroekonomik, ICOR e shpreh në mënyrën më të mirë të mundshme duke nxjerrë në pah efikasitetin e tyre në rritjen ekonomike. Prandaj, në tabelën e paraqitur në vijim kemi prezantuar një analizë krahasimore të ICOR për Maqedoninë dhe të gjitha vendet tjera të Ballkanit Perëndimor për të konstatuar se cili nga këto vende shfrytëzon investimet në mënyrë optimale për të arritur që të “prodhojë” një PBB të dëshiruar që do të jep efekte pozitive në të ardhmen në shumë nivele të makroekonomisë.

Përmes kësaj analize, do të na lejohet të krijojmë një qasje të drejtë rreth rëndësisë së investimeve dhe raportin e saj me PBB-në për të krijuar nivelin e duhur të rritjes ekonomike, ku investimet bruto janë stimuluesit kryesor të saj (rritjes ekonomike).

Tabela 17. Krahasimi i ICOR në Maqedoni dhe vendet e Ballkanit Perëndimor

ICOR për të gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor							
Viti	Maqedonia	Kosova	Shqipëria	Sërbia	Mali i Zi	Bosnia dhe Hercegovina	Kroacia
2006	2,33	3,46	3,99	1,59	0,91	2,00	2,76
2007	1,88	2,90	4,30	1,21	1,00	1,75	3,25
2008	2,10	2,59	3,10	2,04	2,26	1,92	3,10
2009	-300,96	6,46	-25,41	-3,46	-11,71	-9,58	-5,08
2010	4,71	3,82	8,93	-6,75	6,15	8,65	300,56
2011	3,94	3,55	10,19	1,52	4,88	4,78	-31,74
2012	47,68	6,56	9,24	-3,91	-7,59	-543,81	-10,96
2013	3,84	5,46	79,53	2,59	3,62	9,08	-30,55
2014	5,62	6,12	7,85	-6,30	6,88	8,38	-27,20
2015	5,29	6,01	8,26	31,87	3,56	4,26	7,26
2016	4,19	6,06	5,26	5,65	2,45	4,05	4,83
2017	9,21	6,47	3,22	3,08	3,66	3,60	4,14
Min	-300,96	2,59	-25,41	-6,75	-11,71	-543,81	-31,74
Max	47,68	6,56	79,53	31,87	6,88	9,08	300,56
Mean	-17,51	4,95	9,87	2,43	1,34	-42,08	18,36
St. Dev.	90,15	1,55	23,90	10,07	5,51	158,08	90,07

Burimi: Banka Botërore, kalkulimet e autorit

Gjatë vlerësimit të ICOR i referohemi periudhës 2006 - 2017 dhe duke u bazuar në tabelën më lartë, vërehet një rezultat që krijon shumë konfuzitet tek disa nga këto shtete duke marrë përsipër nivelin e zhvillimit ekonomik. Por, duke llogaritur periudhën para ndikimit të krizës financiare në Ballkan, vërehet një nivel mjaft efikas i ICOR në vitin 2007 përfshirë të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor duke lëvizur nga koeficienti 1 që është matur për Malin e Zi e deri në 4.30 që është shifra maksimale gjatë asaj periudhe dhe që përfaqësohet nga Shqipëria. Viti 2009 ka regjistruar një kolaps në ekonominë e të gjitha vendeve të BP si pasojë e krizës financiare duke filluar nga Maqedonia me një ICOR prej - 300,96. Absurditeti i kësaj gjendjeje tregon një dështim në shfrytëzimin e kapitalit i cili jep një efekt negativ mbi zhvillimin e një procesi ekonomik. Në këtë rast marim parasysh investimet që sipas këtij rezultati është e pakuptimtë ndikimi i tyre në rritjen ekonomike. Ky vend ka pësuar më së shumti efektin e krizës në investimet bruto dhe PBB-në për të ofruar një “produkt përfundimtar” joefikas; e ndjekur nga Shqipëria me -25.41, Mali i Zi me -11.71, Bosnia dhe Hercegovina me -9.58, Kroacia me -5.08 dhe Serbia me -3.46. Ajo që vlen të përmendet është një nivel relativisht i favorshëm i ICOR në Kosovë që ka shprehur efikasitetin e investimeve me koeficientin 6.46, që sipas llogaritjeve ky vend ka arritur të menaxhojë kapitalin në dispozicion duke prodhuar një PBB produktive krahasuar me vendet tjera të BP.

Përkundër shkaqeve të krizës financiare, në vitin 2010 vërehet një rimëkëmbje nga ajo gjendje paraprake duke krijuar mundësi për të shfrytëzuar në mënyrë optimale kapitalin me qëllim arritjen e PBB-së produktive për ekonominë nacionale të BP. Këtë e pasqyron edhe llogaritja e ICOR nga tabela më lartë ku spikat Maqedonia e cila ka menaxhuar efikasitetin e investimeve me koeficientin 4.71 për dallim nga viti paraprak. Por, ekstremi tjetër ndodh me Kroacinë që përfaqëson një gjendje të padëshiruar duke ditur që është një nga vendet me ekonomi më të zhvilluar nga të gjitha aspektet. Rezultati shfaq nivelin e ulët të efikasitetit të investimeve, gjë që e cenon rritjen ekonomike duke “konsumuar” më tepër kapital për të dhënë një PBB të dobishme dhe njëkohësisht është vendi i vlerësuar me ICOR më të lartë gjatë vitit 2010 krahasuar me shtetet fqinje. Prandaj, deri në vitin 2014, nuk mund të themi se Kroacia ka ICOR më efikas krahasuar me vendet tjera, pasi që vërehet një lëkundje me vlera pozitive shumë të larta apo negative nën zero, gjë që asnjëra nga këto raste nuk është e dëshirueshme për një ekonomi të zhvilluar siç është Kroacia. Ndërkaq, mund të pohojmë se

gjatë kësaj periudhe që nga viti 2006 e deri në 2017, situata më e favorshme vlerësohet për Kosovën me një ICOR të llogaritur jo më tepër se 6.56 në vit edhe atë kjo shifër është regjistruar në vitin 2012. Në po të njëjtin vit vërehet ekstremi tjetër negativ në Bosne dhe Hercegovinë ku ICOR ka rezultuar -543.81 dhe sigurisht që pasojë e këtij rezultati është vlera e PBB-së që ka dhënë efektin e saj duke krijuar diferencë negative nga viti paraprak në atë aktual, ndërsa Maqedonia me 47.68.

Matja e efikasitetit të investimeve nëpërmjet ICOR shfaq një avancim në kuptim të rritjes ekonomike për të gjitha shtetet e BP në përgjithësi gjatë vitit 2017. Këtë e vërteton edhe rezultati nga tabela e lartëshënuar që krahasuar me vitet paraprake mund të themi se është arritur një siguri dhe strategji se si të realizohet shfrytëzimi optimal i kapitalit për të dhënë efekte pozitive mbi rritjen ekonomike. Rasti i tillë ndodh me Sërbinë e cila llogaritet me ICOR prej 3,08 nga ku pason Shqipëria, Bosnia dhe Hercegovina, Mali i Zi e kështu me rradhë. I vetmi shtet që konsiderohet me një ICOR më të lartë gjatë këtij viti është Maqedonia me 9.21, gjë që bazuar nga të dhënat për investimet bruto dhe PBB-në nuk ofron efikasitetin e duhur për të ndikuar në rritjen ekonomike dhe sidomos në kohën kur ka përjetuar edhe probleme të tjera të aspektit politik dhe social të cilat ishin të pashmagshme dhe akoma vazhdojnë të japin efektin e tyre.

Duke marrë vlerësimin e efikasitetit të investimeve, nëpërmjet të dhënave statistikore vërehet që vlera më negative e ICOR gjatë kësaj periudhe është regjistruar në Bosnie dhe Hercegovinë me një koeficient prej -543,81 edhe atë në vitin 2012. Ndërkaq vlera më e lartë përfaqësohet nga Kroacia me 300.56 në vitin 2010. Pra, shohim që situatat më negative kanë ndodhur pas krizës financiare gjë që vërehet qartë ndikimi i saj duke krijuar pasoja të mëvonshme.

Risku më i lartë në efikasitetin e investimeve vërehet tek ekonomia e Bosnies dhe Hercegovinës duke marrë një vlerë të devjimit standard prej 158.08 që është niveli më i lartë krahasuar me vendet tjera të rajonit. Ndërsa vendi me risk më të ulët prezantohet nga Kosova me një devijim standard prej 1.5. Por, duhet potencuar se edhe Mali i Zi vlerësohet me një risk po të ulët si Kosova me devijim standard prej 5,51.

3.6 Analiza dhe interpretimi i rezultateve

Në këtë pjesë, fokusi do të qëndrojë në analizën dhe interpretimin e rezultateve duke dhënë përgjigje hipotezave të parashtruara. Për të arritur deri tek kjo fazë, të rikujtojmë qëllimet dhe objektivat kryesore të këtij studimi.

Qëllimi i këtij studimi ishte të vërtetojmë nivelin e efikasitetit të investimeve në Maqedoni, duke bërë një krahasim edhe me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor për të arritur në një qasje që do të kontribuojë në rezultatin përfundimtar. Nëpërmjet huazimit të të dhënave nga burime të autorizuara si Banka Botërore, Eurostat, Banka Qendrore e Republikës së Maqedonisë si dhe Enti shtetëror i statistikave të RM-së kemi arritur në një fazë ku mund të bëjmë interpretimin e shumë problemeve të natyrës ekonomike dhe financiare të vendeve.

Problem më specifik ka qenë vlerësimi i investimeve i cili njëherit është edhe stimuluesi kryesor i rritjes ekonomike, për të vazhduar tek efikasiteti i tyre në PBB si pasojë e krizës financiare të pas viteve 2007-2008 e deri tek ndryshimet që mund të bëjë qeveria e Maqedonsë për të dhënë rezultate pozitive duke shmangur çështjet politike, sociale dhe ekonomike. Përveç kësaj, realizimi i një analize krahasimore me vendet e Ballkanit Perëndimor do të na jep një ndihmesë të madhe për të arritur deri tek procesi i konkluzioneve duke vërtetuar hipotezat e mëposhtme në mënyrë detajore.

Hipoteza nr. 1:

H_0 : Rritja e efikasitetit të investimeve ndikon në rritjen e vazhdueshme ekonomike.

H_1 : Rritja e efikasitetit të investimeve nuk ndikon në rritjen e vazhdueshme ekonomike.

Meqë efikasitetin e investimeve e kemi llogaritur nëpërmjet ICOR dhe rritjen ekonomike nëpërmjet PBB-së, atëherë për të vërtetuar këtë hipotezë do t'i referohemi analizës së mëposhtme statistikore.

Tabela 18. Rritja reale e PBB-së dhe ICOR në Maqedoni

Viti	Rritja reale e PBB (%)	ICOR
2006	5,1	2,33
2007	6,5	1,88
2008	5,5	2,10
2009	-0,4	-300,96
2010	3,4	4,71
2011	2,3	3,94
2012	-0,5	47,68
2013	2,9	3,84
2014	3,6	5,62
2015	3,9	5,29
2016	2,8	4,19
2017	0,2	9,21
Kovarianca	70,09	
Korrelacioni	0,37	

Burimi: BQRM, kalkulimet e autorit

Thënë në mënyrë teorike rritja e efikasitetit të investimeve patjetër se do të stimulojë rritjen ekonomike meqë investimet janë një ndër faktorët kryesor që e rrisin PBB-në në një vend duke përmirësuar edhe shumë aktivitete tjera ekonomike. Duke parë në këtë mënyrë në vitin 2007 vërehet një rritje e koeficientit të ICOR mjaft efikas prej 1.88 i cili rezulton në anën tjetër me një rritje të PBB-së prej 6.5%. Poashtu të njëjtin rezultat e jep edhe viti 2009, por në aspekt negativ ku ICOR ka dhënë një koeficient prej -300.96 dhe PBB-ja rezulton negative (-0.4%). Kjo shfaq një relacion të drejtë në mes tyre ashtu siç e mat edhe kovarianca që rezulton pozitive sipas të cilës është i pranishëm raporti i drejtë i tyre. Sipas asaj një ICOR më e ulët e cila shpjen në një efikasitet të lartë, do të rezultojë në një rritje të PBB-së e cila është shtytës kryesor i nivelit të rritjes ekonomike. Dhe e kundërta, një koeficient i ICOR më i lartë shpjen në një PBB më të ulët.

Në përgjithësi shohim që ky raport në mes ICOR dhe PBB-së është pozitiv edhe në qoftë se bëhet fjalë për një rritje ekonomike me përqindje më të ulët, por, kjo vjen si rezultat i efikasitetit të ulët të investimeve. Prandaj edhe rezultati nga llogaritja e koeficientit të korrelacionit është 0.37 – pozitiv që do të thotë arrin në një pikë më afër 0 (zeros) duke shprehur një lidhje funksionale, megjithatë të dobët.

Duke analizuar nga ky këndvështrim, mund të konstatojmë hipotezën e parashtruar duke pranuar atë H_0 dhe duke e hedhur poshtë H_1 ku rritja e efikasitetit të investimeve në përgjithësi ndikon në rritjen e vazhdueshme ekonomike në Republikën e Maqedonisë meqë korrelacioni në mes tyre është pozitiv dhe në të shumtën e rasteve gjatë kësaj periudhe nga viti 2006 deri në 2017 ICOR arrin të pasqyrojë një raport funksional me PBB-në.

Hipoteza nr. 2:

H_0 : Investimet në sektorin e industrisë (prodhimit) determinojnë rritjen ekonomike.

H_1 : Investimet në sektorin e industrisë (prodhimit) nuk e determinojnë rritjen ekonomike.


Duke marrë parasysh se sektori i industrisë është një ndër sektoret më efikas që shpijnë në rritjen e PBB-së në vend, është e rëndësishme të ndalemi në analizën e evolucionit të këtij sektori gjatë viteve.

Të dhënat e marra nga Enti shtetëror i statistikave në tabelën nr. 5 flasin për një pjesëmarrje të sektorit të industrisë që konsiderohet si i dyti me rradhë pas atij të tregtisë me shumicë dhe pakicë i cili kryeson me pjesëmarrje në PBB. Nivelin më të lartë e ka arritur në vitin 2016 me 13.3% të PBB-së (si vlerë e re shtesë) duke krahasuar me rezultatet nga vitet e mëparshme. Kjo jep një bindje se ky sektor ka filluar të bëhet pjesë e rëndësishme e ekonomisë së vendit duke dhënë një trend rritës. Vazhdimi i këtij trendi edhe në vitet në vijim, sigurisht që do të jep mundësi të reja në kapacitetin e prodhimit, por edhe në zvogëlimin e normës së papunësisë.

Bazuar në këtë këndvështrim, këto dy sektore kanë arritur të fitojnë një peshë më të rëndësishme në rritjen ekonomike, ku sektori i tregtisë arrin të merr pjesë me 19% të PBB-së në vitin 2016, ndërsa ai i industrisë pason me 13,3%. Kjo e bën të nënkuptohet se edhe investimet në sektorin e industrisë e sidomos në atë të prodhimit kanë filluar të rrisin kontributin e tyre për të nxitur rritjen ekonomike. Duhet cekur se industria përfshin dy nënveprimtari që janë pjesë e PBB-së dhe klasifikohen si industri e lehtë (përpunimi i drurit e

letrës, industria e kartonëve, shtypshkronjat, përpunimi i lëkurës, industria e këpucëve dhe tekstileve etj.) dhe industria e rëndë (minierat dhe guroret, xehet etj.).

Grafiku 10. Industria dhe PBB-ja në mil. denarë, gjatë viteve 2006 – 2016



Burimi: Enti shtetëror i statistikave, dizajnimi i autorit

Në këtë aspekt edhe pse vërehet një nivel i ulët i pjesëmarrjes së industrisë në PBB, megjithatë ajo shfaqet në një trend rritës dhe kjo situatë e bën të rëndësishme ndikimin e tij si sektori i dytë me peshë më të lartë në PBB pas tregtisë me shumicë dhe pakicë. Si rezultat i kësaj mund të thuhet se H_0 pranohet dhe H_1 hudhet poshtë pasi që konsiderohen si veprimtari kyçe me zotërim më të lartë të rritjes ekonomike të Maqedonisë që hap perspektiva më inovative e sidomos në zhvillimin e prodhimtarisë në vend.

Hipoteza nr. 3:

H_0 : Trendi i investimeve është në proporcion të drejtë me rritjen e borxhit me PBB.

H_1 : Trendi i investimeve është në proporcion të zhdrejtë me rritjen e borxhit me PBB.


Trendi i investimeve në Maqedoni është në proporcion të drejtë me rritjen e borxhit dhe kjo hipotezë pranohet. Variablat kryesorë të paraqitur në tabelën nr. 9 - bruto investimet dhe borxhi krijojnë bindjen se përdërisa investimet vazhdimisht pësojnë rritje çdo vit në aspekt pozitiv, nga ana tjetër tendenca e borxhit vazhdon të rritet. Ky pohim i referohet të dhënave në tabelën nr. 19. Një mënyrë tjetër statistikore e matjes së raportit mes tyre e shpreh po të njëjtin pohim: ekziston një raport i drejtë në mes tyre duke kalkuluar korrelacionin e dy variablave në Excel. Duke ditur që korrelacioni mund të merr vlerat: -1 (negative) ose 1 (pozitive), vërtetuar se në rastin aktual ai rezulton me 0.956 që është më afër vlerës 1 dhe lidhja e tyre është pozitive ashtu siç vërehet nga grafikoni më vijim. Sipas kësaj teorie pranohet H_0 ndërsa hudhet poshtë H_1 .

Tabela 19. Borxhi publik dhe investimet bruto në mil. denarë

Viti	Borxhi publik	Investimet bruto
2006	111.232	68.809
2007	96.076	89.928
2008	95.696	110.405
2009	108.416	107.600
2010	119.091	108.218
2011	148.526	120.548
2012	178.894	134.962
2013	201.846	144.584
2014	241.090	159.847
2015	260.374	169.942
2016	289.666	193.366
2017	294.347	203.352
Korelacioni	0.956	

Burimi: Ministria e financave dhe BQRM, dizajnimi i autorit

Grafiku 11. Raporti në mes investimeve bruto dhe borxhit në Republikën e Maqedonisë (në mil. denarë)



Burimi: MInistria e Financave dhe BQRM, dizajnimi i autorit

Hipoteza nr. 4:

H_0 : ICOR në Republikën e Maqedonisë është më i ulët krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor.

H_1 : ICOR në Republikën e Maqedonisë nuk është më i ulët krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor.

Duke marrë në konsideratë të dhënat që kemi marrë nga Banka Botërore në lidhje me investimet bruto dhe PBB-në për Maqedoninë dhe vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, mund të japim një rezultat përfundimtar që të vërtetojmë hipotezën e parashtruar. Prandaj, në këtë rast themi që ICOR në Maqedoni gjatë periudhës 2006 – 2017 nuk është më i ulët krahasuar me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor duke hudhur hipotezën H_0 dhe pranuar hipotezën H_1 . Në vazhdim rrjedh arsyetimi i vendimit të marrë.

Tabela 20. Vlerësimi i ICOR për BP

Vlerësimi i ICOR (nga 1 deri në 7) për vendet e Ballkanit Perëndimor							
Viti	MNE	SRB	BiH	KS	MK	AL	HR
2006	7	6	5	2	4	1	3
2007	7	6	5	3	4	1	2
2008	4	6	7	3	5	1	1
2009	3	6	4	7	1	2	5
2010	5	2	4	7	6	3	1
2011	3	7	4	6	5	2	1
2012	4	5	1	7	2	6	3
2013	6	7	3	4	5	1	2
2014	5	2	3	6	7	4	1
2015	7	1	6	4	5	2	3
2016	7	2	6	1	5	3	4
2017	4	7	5	2	1	6	3
Pikët e fituara nga vlerësimi	62	57	53	52	50	32	29

Burimi: Kalkulimi dhe dizajnimi i autorit

Studimi i tillë duke marrë për bazë tabelën nr. 17 shfaq më saktë kalkulimet dhe gjetjet lidhur me këtë hipotezë duke krijuar një mënyrë vlerësimi në tabelën e shtuar më lartë nga 1 (si vlerësim më negativ) deri në 7 pikë (si vlerësim më pozitiv) për të parë se cili nga këto vende ka mbledhur më shumë pikë e cili më pak, respektivisht cili nga vendet rezulton me ICOR më të ulët e cili me ICOR më të lartë gjatë periudhës së analizuar. Duke marrë për bazë ICOR të çdo vendi, konstatojmë pikët përfundimtare për të analizuar edhe hipotezën e parashtruar.

Duke analizuar këtë lloj vlerësimi mund të konstatohet se Mali i Zi në këtë rast zë vendin e parë me 62 pikë të fituara, me ICOR më të ulët apo thënë ndryshe me një efikasitet më të lartë të investimeve. Pas saj radhitet Serbia me 57 pikë, Bosnia dhe Hercegovina me 53 pikë, Kosova me 52 pikë, Maqedonia me 50 pikë, Shqipëria me 32 dhe Kroacia me më pak pikë të fituara - 29 pikë. Sipas këtij rezultati, Maqedonia gjendet në një situatë mesatarisht të mirë e renditur në vendin e 5 (nga gjithsej 7) duke konstatuar se H_0 hudhet poshtë dhe pranohet H_1 nga fakti që ky vend nuk rezulton me ICOR më të ulët gjatë kësaj periudhe, gjë që nuk e bën vendin me efikasitet më të lartë të investimeve. Por, duke analizuar me Kroacinë si një vend më i zhvilluar që rezulton me pikët minimale të fituara, vendi ynë mund të konsiderohet në një pozitë mesatarisht më të favorshme.

Megjithatë, akoma është e nevojshme që në të ardhmen të arrihet një menaxhim më efikas i mënyrës së shfrytëzimit të kapitalit e cila reflekton tek projektimi i investimeve për të ofruar një PBB të qëndrueshme dhe më këtë edhe një rritje ekonomike stabile. Kjo do të rritë edhe mundësitë për investime të suksesshme që do të reflektojë në zhvillimin ekonomik të Maqedonisë.

Përfundim

Investimet përbëjnë mjetin kryesor nga i cili varen shumë procese ekonomike në një shtet. E themi këtë pasi çdo indikator ekonomik qoftë punësimi, teknologjia, industria e prodhimit, infrastruktura dhe shumë aspekte tjera formohen gradualisht nëpërmjet investimeve. Këto të fundit janë të lidhura ngushtë me rritjen ekonomike duke dhënë efekt pozitiv mbi të dhe në këtë mënyrë krijon hapësirë për një situatë stabile ekonomike në vend.

Është shumë e rëndësishme funksionimi i mirë i rritjes ekonomike dhe investimeve, pasi që kapitali është ai që vepron në mënyrë të duhur dhe shfrytëzimi efikas i tij prodhon një rritje ekonomike të shëndoshë e cila krijon dobi për të gjithë. Pa praninë e kapitalit, zhvillimi ekonomik i një vendi është i padobishëm dhe shëndrohet në një mjet të paaftë për të dhënë rezultate të dëshiruara. Nga ana tjetër, jo vetëm institucionet publike, por edhe ato private kanë përfitime nga investimet dhe këtë duhet ta shqyrtojnë në mënyrën më të mirë të mundshme për të krijuar një ambient më të fortë konkurrues dhe për të marrë një kthim të arsyeshëm nga ato.

Në hulumtimin e bërë në krerët e mëparshëm jemi fokusuar në rolin dhe rëndësinë e investimeve, ndikimin e tyre në rritjen ekonomike dhe efikasitetin që krijojnë për një zhvillim ekonomik të avancuar. Në bazë të kësaj, kemi parashtruar dhe analizuar hipotezat dhe rezultatet kanë dhënë një konkluzion që mund të na krijojë një qasje më të lehtë për të kuptuar rëndësinë e investimeve dhe ndikimin e tyre në PBB.

Investimet në përgjithësi në Maqedoni kanë pësuar një rritje të vazhdueshme (në aspekt absolut) që nga periudha e krizës financiare e deri më tani. Megjithatë kjo nuk krijon mjaftueshmëri për të ndikuar në rritjen ekonomike e sidomos viti 2017 që shënon përkeqësim të situatës jo vetëm në realizimin e investimeve, por, edhe në çdo aspekt tjetër politik e social që prek zhvillimin e ekonomisë nacionale.

Investimet në mjete themelore janë pjesë e investimeve bruto dhe rezultatet e tyre kanë nxjerrë në pah sa efikase kanë rezultuar ato për të krijuar një PBB optimale. Si konkluzion shtesë në këtë rast duhet përmendur që sipas strukturës teknike mbizotërimi i infrastrukturës ku përfshihen punët ndërtimore, kanë dhënë një rezultat dominues mbi të gjitha. Në këtë

mënyrë janë shoqëruar vazhdimisht me një trend rritës duke marrë parasysh periudhën nga kriza financiare e këndej, megjithatë viti 2017 nuk ka dhënë suksesin e duhur në PBB-në e vendit. Nga ana tjetër, investimet nga institucionet jofinanciare poashtu kanë dhënë rezultate pozitive duke mos harruar të cekim që pjesë e këtyre institucioneve janë jo vetëm shoqëri private apo juridike, por edhe ato të lojrave të fatit të cilat kohëve të fundit kanë rritur pjesëmarrjen në PBB duke mos i ndjerë problemet ekonomike dhe sociale në vend.

Vlen të konstatohet se rritja ekonomike varet edhe nga “produktiviteti” i investimeve të huaja të cilat krijojnë interesin e tyre duke tërhequr në aspekt pozitiv edhe shumë indikatorë tjerë ekonomikë. Në rastin e Maqedonisë ky interesim i investitorëve të huaj ka filluar të zbehet që pas krizës financiare duke marrë pjesë në PBB me vetëm 1.8% në vitin 2017 përderisa ekziston një diferencë e madhe që nga viti 2006 që rezultonte me 8.4% të PBB-së. Nga një këndvështrim tjetër, kur analizojmë veprimtaritë ekonomike si një vlerë e krijuar shtesë, duhet marrë parasysh pjesëmarrjen e vogël të sektorit të industrisë në PBB, por që gradualisht ka arritur të ngjitet në një nivel më të lartë me 13.3% në vitin 2016 duke lënë pas vitet e kaluara, gjë që krijon një parashikim të suksesshëm për vitet e ardhshme që do të thotë industria e lehtë dhe ajo e rëndë e veçanërisht prodhimi, kanë arritur të bëhen pjesë e rëndësishme e rritjes ekonomike në Maqedoni. Përveç kësaj, përpjekjet nga sektori publik për një ekonomi më të shëndoshë kanë filluar tashmë nëpërmjet implementimit të programeve të ndryshme në fushën e ekonomisë së investimeve, por për të mos harruar sektorin privat i cili krijon mundësi për një ekonomi më të mirë duke rritur prodhimtarinë si dhe duke dhënë një perspektivë drejt së ardhmes forcës së re punëtore. Është shumë e rëndësishme zhvillimi i kësaj veprimtarie pasi që krijon një efekt pozitiv edhe mbi eksportin e në këtë mënyrë edhe në reduktimin e deficitit buxhetor. Ndërkaq, sektori më i frekuentuar para industrisë rezultoi ai i shërbimeve që përfshin tregtinë me shumicë dhe pakicë duke arritur deri në 19% të PBB-së. Për të vazhduar me këtë qasje, investimet më të mëdha, si pjesë e PBB-së, janë realizuar në sektorin e ndërtimtarisë me rreth 32% nga të gjitha investimet në mjete themelore, që janë të ndjekura nga sektori i industrisë kryesisht në miniera dhe gurore me 23% mesatarisht gjatë periudhës 2006 - 2017 dhe atë të shërbimeve me mbi 16% të investimeve në mjete themelore në RM.

Kategoria më primare që përfshin të gjitha janë investimet bruto që krijojnë kapitalin kryesor i cili “prodhohet” për të nxjerrë një produkt përfundimtar efikas. Një aspekt pozitiv është që Maqedonia ka arritur të krijojë një trend rritës të bruto investimeve që nga periudha para krizës financiare e deri në vitin 2017 duke rritur njëkohësisht edhe pjesëmarrjen në PBB që përfaqëson maksimalisht 33% të saj. Ky sinjal pozitiv krijon qasjen e një efikasiteti relativisht të mirë në ekonomi, megjithatë matja e koeficientit inkremental të kapitalit nuk e shpreh rezultatin më të favorshëm krahasuar me vendet fqinje të BP. Në atë aspekt hipotezat e analizuara e vëretojnë që Maqedonia përballlet me një efikasitet mesatar duke u renditur në vendin e 5 (nga gjithsej 7) në raport me vendet tjera të BP, por që nuk ka qenë i vetmi shtet i cili është ballafaquar me shfrytëzimin joefikas të kapitalit për të dhënë PBB produktive dhe rritje ekonomike stabile.

Për t’u ndalur në këtë pjesë, në këtë studim konstatuam se ekziston një lidhje në mes ICOR dhe PBB-së reale, duke vërtetuar raportin pozitiv në mes tyre dhe këtë e shpreh Hipoteza-1 duke paraqitur një lidhje funksionale, por të dobët për shkak të rezultatit të koeficientit të korrelacionit. Megjithatë, objektiv kryesor në këtë hipotezë është sfida e efikasitetit të investimeve për të ndikuar në mënyrë pozitive në PBB qoftë edhe me një përqindje më të vogël, gjë që në të shumtën e rasteve arrihet të tejkalohet. Përveç kësaj, fokusi kryesor ishte në zhvillimin e investimeve e sidomos të atyre në industri si një sektor esencial që ndikon në rritjen e prodhimtarisë, për të nxjerrë në pah aftësinë tij për të ndikuar në rritjen ekonomike gradualisht duke krijuar një trend rritës krahasuar me vitet e mëparshme para zgjerimit të krizës financiare, edhe pse nuk konsiderohet sektori më primar që merr pjesë në PBB. Këtë e pasqyron analiza e Hipotezës-2. Për të vazhduar me Hipotezën -3, arritëm të realizojmë një analizë në mes investimeve bruto dhe borxhit publik që dëshmon lidhjen pozitive të tyre, por që rritja e vazhdueshme e borxhit jep efekte negative në zhvillimin e ekonomisë nacionale edhe pse në anën tjetër përballemi me një rritje të investimeve bruto. Por, të mos harrojmë se nëpërmjet financimit me borxh arrihen të realizohen këto investime, në veçanti ato publike. Megjithatë, ekziston një mungesë e menaxhimit të duhur me borxhin gjë që ka çuar në rritjen e tij vazhdimisht nga viti në vit.

Objektivi final i hulumtimit, arrihet me gjetjet rreth efikasitetit të investimeve në rritjen ekonomike. Sipas kësaj, Maqedonia nuk konsiderohet si një shtet me efikasitet ekonomik më optimal për dallim nga vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, por mund të themi se ka arritur në një pikë mesatare duke pasur parasysh se Kroacia rezulton me një nivel më të ulët të efikasitetit të investimeve. Ndërkaq, Mali i Zi rezultoi me një efikasitet më të lartë nga të gjithë vendet e analizuara. Duke parë në këtë pikëpamje, është më se e rëndësishme menaxhimi i duhur me kapitalin investues në BP me theks të veçantë në RM pasi në të kundërtën mund të paraqitet një rrezik duke e “mbyllur” ekonominë e vendeve në një gjendje e cila do të vazhdojë të lëviz në një ritëm duke krijuar rritje ekonomike të ngadalshme.

Në përgjithësi, ajo që vërehet nga ky studim është se ekonomia e vendit ka arritur të jetë më produktive para fillimit të krizës financiare dhe jo vetëm në Maqedoni, por edhe në të gjitha shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor duke u fokusuar tek investimet. Nuk mund të themi se periudha pas krizës financiare nuk ka dhënë rezultate të sukseshme, por ndikimi i shumë faktorëve ekonomik, politik dhe social ka rezultuar në një rritje ekonomike më të vonuar me një përfitim më të ngadalshëm. Fakti që rezultatet shprehin një aktivitet ekonomik më të zbehtë të vendeve të Ballkanit Perëndimor që nga viti 2009 e deri më tani, ka çuar në një fazë kryesisht të ngadalshme të evoluimit të ekonomisë. Kjo sigurisht që përbën një çështje komplekse në cenimin e rritjes ekonomike, por, prek edhe sfera tjera të ekonomisë si: niveli i lartë i papunësisë dhe borxhit si dhe çështje tjera sociale që hapin një zbrazëti në zhvillimin e ekonomisë nacionale.

Aktivitetet ekonomike kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të ndikuara nga jostabilitetet politike, gjë që e ngadalëson edhe më tepër zhvillimin ekonomik. Megjithatë, duke analizuar në këtë këndvështrim, ekziston një anë pozitive e që lidhet me investimet private të cilat janë në një përqindje më të lartë se ato publike dhe kjo shpreh interesin e tyre për të kontribuar në rritjen e PBB-së nëpërmjet financimit nga fondet e ndryshme të huaja. Si pjesë e kësaj edhe efikasiteti i investimeve do të rritet ashtu siç është bërë në vitin 2016 në Maqedoni krahasuar me vitet tjera. Ndonëse ky shtet ka edhe shumë hapësira tjera që duhet shfrytëzuar për të nxitur investitorët e huaj të bëhen pjesë e rritjes ekonomike pasi që vendet e Ballkanit Perëndimor në përgjithësi konsiderohen si shtete me një lokacion kompetitiv për zhvillimin e investimeve të huaja. Në këtë mënyrë do të arrihet një rritje e qëndrueshme ekonomike duke

implementuar strategji adekuate meqë e dimë se një pjesë e madhe e investimeve financohen nga borxhi, ndërsa ky i fundit vazhdimisht rritet dhe nevojitet një koordinim në mes këtyre faktorëve për një ekonomi të shëndoshë për të arritur rrugëtimin në drejtim të integritimeve evropiane.

Rekomandime

Duke marrë në konsideratë një ekonomi të vogël të hapur si Maqedonia është fakt se mungesa e kapitalit investues do të jetë problem kryesor me të cilin do të ballafaqohet ajo. Zhvillimi i financave duhet të përpilojë mundësi më të qëndrueshme në përdorimin e duhur të investimeve për të krijuar një produkt përfundimtar të suksesshëm që i referohet PBB-së. Në këtë rast duhet të ofrojë kushte edhe në klimën e biznesit në veçanti për zhvillimin e mëtejshëm të investimeve të huaja direkte të cilat aktualisht nuk japin përpjekjen e duhur.

Reformat ekonomike proaktive dhe produktive duhet të planifikohen dhe realizohen në kohë nëpërmjet shfrytëzimit efikas të shpenzimeve kapitale në nivel shteti me qëllim të rritjes së PBB-së. Përkrahja dhe stimulimi i ndërmarrësve privat për të investuar në sektorin e prodhimtarisë, do të mundësojnë njëkohësisht rritjen e vendeve të lira të punës duke rritur edhe PBB-në. Këto investime do të rrisin edhe nivelin e eksporteve që aktualisht krijon një zbrazëti në ekonominë e vendit në aspekt të këmbimit tregtar me jashtë. Këto reforma do të shpijnë në zvogëlimin e deficitit tregtar si dhe të borxhit publik në llogari të rritjes së fondeve kapitale dhe PBB-së në vend.

Reduktimi i varfërisë kërkon përkrahje shumë proaktive nga ana e qeverisë duke ofruar mbështetje financiare qytetarëve të interesuar për hapje të bizneseve dhe të vetëpunësimit. Investimet në këtë sferë sociale kanë ekzistuar, por janë në një përqindje shumë të vogël dhe nuk e arrijnë efektin e duhur në ekonomi. Shpesh herë këto masa qeveritare edhe politizohen dhe nuk e arrijnë objektivin ekonomik.

Duke u ndalur tek rritja e investimeve në sektorin e shëndetësisë dhe edukimit si dy çështje vitale për përmirësimin e kushteve të jetesës, vijnë në shprehje investimet publike ku mundësia më e arsyeshme është që ato të orientohen në projekte që do të krijojnë

dobishmëri dhe efikasitet për të gjithë qytetarët e vendit në mënyrë që të mos rrezikohet ekonomia e vendit nëpërmjet huazimit të vazhdueshëm të borxhit i cili ka arritur në një nivel shumë të lartë vetëm për të financuar projekte investive që shkaktojnë dëm në buxhetin e shtetit dhe përkeqësimin e standardit jetësor.

Realizimi i një politike proaktive të Zonat zhvillimore teknologjike industriale në mbarë vendin dhe jo e koncentruar vetëm në pjesën qendrore dhe lindore të RM, tërhehja e investorëve të huaj dhe rishpërndarja e balancuar e tyre në të gjitha zonat regjionale të RM do kontribuonte edhe në zhvillimin e ekuilibruar regjional në vend.

Realizimi i reformave ekonomike dhe juridike të përcjella me integrimin e mundshëm në NATO dhe hapja e bisedimeve në UE do të rezultojë me një mundësi reale të tërheqjes së IHD-ve dhe me këtë edhe të rritjes ekonomike më të shpejtë.

Bibliografia

- Abdylmenaf Bexheti, Jeton Mazllami. (n.d.). *Makroekonomia - Ligjerata të autorizuar*. Tetovë.
- About Montenegro: Investing in Montenegro*. (n.d.). Retrieved from Chamber of Economy of Montenegro: <http://www.privrednakomora.me/en/investing-montenegro>
- Agim Mamuti, M. G. (2016). The effect of FDI on the GDP of Macedonia. *Research Gate*, 109-119.
- (2016). *Albania 2016 Report*. Brussels: European Commission .
- Amara Akram Khan, M.-h. A. (n.d.). *The impact of public debt on private investment and economic growth: Empirical evidence from Pakistan*. Retrieved from Academia.edu: [https://www.academia.edu/28100330/THE_IMPACT_OF_PUBLIC_DEBT_ON_PRIVAT E_INVESTMENT_AND_ECONOMIC_GROWTH_EMPIRICAL_AVIDENCE_FROM_PAKIST AN](https://www.academia.edu/28100330/THE_IMPACT_OF_PUBLIC_DEBT_ON_PRIVAT_E_INVESTMENT_AND_ECONOMIC_GROWTH_EMPIRICAL_AVIDENCE_FROM_PAKISTAN)
- (2017). *Anual Report 2016*. Zagreb: Croatian National Bank.
- Autonomous Investment, AmosWEB Encyclonomic WEB*pedia*. (n.d.). Retrieved from Amos WEB LLC: http://www.amosweb.com/cgi-bin/awb_nav.pl?s=wpd&c=dsp&k=autonomous+investment
- Balukoska, D. (2012). *Влијанието на странските директни инвестиции врз економскиот раст и невработеноста на земјите во транзиција, со осврт на Македонија*. Skopje. Retrieved from http://www.academia.edu/7443022/Daniela_Balukoska_28_3_2012.
- Bodie, Z. (1998). *Essentials of investments*. Boston, Mass. : Irwin/McGraw Hill.
- Borxhi publik i Shqipërisë 2007 – 2017 dhe struktura e tij*. (2007-2017). Retrieved from Open Data Albania: <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/2357/Borxhi-publik-i-Shqiperise-2007---2017-dhe-struktura-e-tij>
- Brumbulli, S. (2002). *Investimet*. Tirane: Gervis.
- Chapter V, Domestic Investment*. (1957). Retrieved from Bank of Israel - Annual Report: https://www.boi.org.il/en/NewsAndPublications/RegularPublications/Research%20Department%20Publications/BankIsraelAnnualReport/Annual%20Report%201957/pe_5.pdf
- Claude Berthomieu, M. C. (n.d.). *Investment Needs and Debt in the Western Balkans*. Retrieved from Institute EIB: <https://institute.eib.org/wp-content/uploads/2016/04/Berthomieu-Cingolani-Ri-2015-Bilbao-1-Investment-Needs-and-Debt-in-the-Western-Balkans.pdf>

(, November 6, 2007. SEC (2007)). *Commission of the European Communities, "The Former Yugoslav Republic of Macedonia Progress Report 2007"*. Brussels.

Data: Central government debt, total (% of GDP). (2005-2016). Retrieved from World Bank: <https://data.worldbank.org/indicator/GC.DOD.TOTL.GD.ZS?end=2016&locations=AL-BA-HR-XK&start=2005&view=chart>

Data: Foreign direct investment, net inflows (% of GDP). (2005-2017). Retrieved from World Bank: <https://data.worldbank.org/indicator/BX.KLT.DINV.WD.GD.ZS?end=2017&locations=AL-BA-HR-XK-MK-ME-RS&start=2005&view=chart>

Data: GDP growth (annual %). (2005-2017). Retrieved from World Bank: <https://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.MKTP.KD.ZG?end=2017&locations=AL-BA-HR-XK-MK-ME-RS&start=2005>

Data: Gross capital formation (% of GDP). (2005-2017). Retrieved from World Bank: <https://data.worldbank.org/indicator/NE.GDI.TOTL.ZS?end=2017&locations=AL-BA-HR-XK-MK-ME-RS&start=2005&view=chart>

Data: Unemployment, total (% of total labor force). (2005-2018). Retrieved from World Bank: <https://data.worldbank.org/indicator/SL.UEM.TOTL.ZS?end=2018&locations=AL-BA-HR-XK-MK-ME-RS&start=2005&view=chart>

Edward E. Buffie, A. B.-F. (2012). *Public Investment, Growth, and Debt Sustainability: Putting Together the Pieces*. Retrieved from International Monetary Fund: <https://www.imf.org/external/pubs/ft/wp/2012/wp12144.pdf>

Ekaterina Vostroknutova, M. H. (2018). *Western Balkans Regular Economic Report No. 13 - Vulnerabilities Slow Growth*. World Bank.

Ilievski, B. (2011, Oktomvri 28). *Investicii vo osnovni sredstva vo 2010 godina*. Retrieved from Stat.gov.mk: <http://www.stat.gov.mk/pdf/2011/3.1.11.07.pdf>

Investicii vo osnovni sredstva, 2009 godina. (2010, Dekemvri). Retrieved from State Statistical Office of Republic Of Macedonia: <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/3.4.10.03.pdf>

Investivcii vo osnovni sredstva, 2008 godina. (2004-2008). Retrieved from Stat.gov.mk: <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/3.4.9.05.pdf>

Jafar, A. R. (2015). *Impact of public investment on economic growth*.

Jun, Z. (2003). Investment, investmet efficiency and economic growth in China. *Jornal of Asian Economics*, 713-734.

Kothe, S. K. (2013). Incremental Capital Output Ratio and Growth in India's Services Sector. *Research Gate*.

- Lindita Muaremi, R. K. (2015). Foreign Direct Investment in Macedonia. *European Scientific Journal*, 55-70. Retrieved from <https://eujournal.org/index.php/esj/article/viewFile/5141/5030>
- Macedonia GDP. (n.d.). Retrieved from Trading Economics: <https://tradingeconomics.com/macedonia/gdp>
- Macedonia, N. B. (2015). *Annual Report from 2014*. Skopje.
- Mankiw, N. (2009). *Principles of Economics, 5th Edition*. Cengage Learning; 5th edition.
- Mills, Z., Kyobe, A. J., Brumby, J., Papageorgiou, C., & Dabla-Norris, E. (2011, February 1). *IMF*. Retrieved from <https://www.imf.org/en/Publications/WP/Issues/2016/12/31/Investing-in-Public-Investment-An-Index-of-Public-Investment-Efficiency-24651>
- Ministry of Finance. (2011). Retrieved from Public Investment Programme of the epublic of Macedonia 2011-2013: <https://www.finance.gov.mk/files/u1/PIP-2011novo.pdf>
- (2013-2015). *Montenegro Country Report* . Bertelsmann Stiftung, BTI 2016 .
- Montenegro: National debt in relation to gross domestic product (GDP) from 2012 to 2022. (n.d.). Retrieved from The Statistics Portal: <https://www.statista.com/statistics/528685/national-debt-of-montenegro-in-relation-to-gross-domestic-product-gdp/>
- NACE Rev.2 Statistical classification of economic activities in the European Community. (n.d.). Retrieved from Eurostat - European Commission: <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3859598/5902521/KS-RA-07-015-EN.PDF>
- Nestorovski, M. (2005). *Ekonomija na investiciite* . Skopje: Ekonomski fakultet.
- Ognjen Eric, G. P. (2018, October). *Economic development of the Western Balkans and European Union Investments*. Retrieved from ResearchGate.net: Economic development of the Western Balkans and European Union
- Peter Sanfey, J. M. (2016). *How the Western Balkans can catch up*. European Bank for Reconstruction and Development.
- Pettinger, T. (2017, August 7). *Harrod-Domar Model of Growth and its Limitations*. Retrieved from Economics Help: <https://www.economicshelp.org/blog/498/economics/harod-domar-model-of-growth-and-its-limitations/>
- Programi i borxhit shtetëror 2014-2017. (2013, Dhjetor). Retrieved from Ministria e Financave të Republikës së Kosovës: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1D7457ED-ECC6-429D-B305-B54A4BA64338.pdf>
- Raporti i zhvillimeve makroekonomike . (2014, Shtator). Retrieved from Banka Qendrore e Republikës së Kosovës: <https://bqk->

kos.org/repository/docs/2014/BQK_2014_Raporti%20i%20Zhvillimeve%20Makroekonomike.pdf

Sicic, J. (2016). *Investicije i gospodarski rast Republike Hrvatske od 2004. do 2014.* Split.

Retrieved from World Bank:

<http://www1.worldbank.org/publicsector/pe/oecdpehandbook.pdf>

Soubbotina, T. P. (2004). *Beyond economic growth : an introduction to sustainable development.* Washington : World Bank Publications.

Statistics: Direct Investment - Stocks. (n.d.). Retrieved from National Bank of Republic of North Macedonia: <http://www.nbrm.mk/ns-newsarticle-direktni-investicii---sostojben.nsp>

The Western Balkans in Transition. (2009, May). Retrieved from European Commission: http://ec.europa.eu/economy_finance/publications/pages/publication15155_en.pdf

Tosti, D. (1972). *An analysis of Capital Output Ratios with special reference to South Africa.*

Retrieved from OpenUCT :

https://open.uct.ac.za/bitstream/handle/11427/18290/thesis_com_1972_tosti_david.pdf?sequence=1

Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2016. (2016). Retrieved from Agjencia e Statistikave të Kosovës: http://ask.rks-gov.net/media/1304/vjetari_statistikor-2016-shqip.pdf

Western Balkans Regular Economic Report No.12 - Job Creation Picks Up. (2017). Retrieved from World Bank:

<http://documents.worldbank.org/curated/en/477511510774559876/pdf/121417-WP-PUBLIC.pdf>

Western Balkans Regular Economic Report No.14 - Higher But Fragile Growth. (2018).

Retrieved from World Bank:

<http://pubdocs.worldbank.org/en/194301538650996304/rev2-WBRER14-WQ-web-ENG.pdf>

Western Balkans: Regional Economic Integration Issues Notes. (2017, June). Retrieved from

World Bank: <http://pubdocs.worldbank.org/en/471351498823233178/1-WB6-Regional-Economic-Integration-Issues-Notes-29-June-2017-final.pdf>

Xhafa, H. (2010). *Drejtimi financiar.* Tiranë.

Zoto, O. (2012). *Investimet e huaja direkte në Shqipëri. Analiz e efekteve, politikave dhe lidhja me rritjen ekonomike.* Retrieved from Universiteti i Tiranës:

<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2012/09/Oltjana-Zoto-Fakulteti-i-Ekonomise.pdf>

Извештај за финансиската стабилност во Република Македонија во 2016 година.

(2017, Juli). Retrieved from Narodna Banka na Republika Makedonija:

http://nbrm.mk/content/Regulativa/FSR_2016_MKD.pdf

МакСтат база на податоци: Бруто-домашен производ и инвестиции . (n.d.).

Retrieved from Makstat:

http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__BDP__BDPInvesGodisni__BDPsporedESS2010/575_NacSma_Mk_INVEST_KPD_mk.px/table/tableViewLayout2/?rxid=150f56f1-d812-4e5d-8edc-b24cf1bcc62b

Марта, П. (2016). *Статистички перформанси за влијанието на странски директни инвестиции на пазарот на капитал со посебен осврт на Република Македонија.*

Retrieved from Ekonomski fakultet - Prilep:

http://www.eccfp.uklo.edu.mk/files/PostgraduateUpload/Popovska_Marta.pdf

Сашо, Н. (2007). *Инвестициона политика - случајот со Република Македонија.*

Retrieved from National Bank of Republic of Macedonia:

<http://www.nbrm.mk/WBStorage/Files/3ta-nagrada-investiciona-politika-slucajot-so-RM0.pdf>